

# alb ISLAM

revistë e përmuajshme fetare kulturore shkencore

## "Imani" në Vjenë, ndërsa "kufri dhe mosbesimi" në Medinë

**Identiteti musliman  
I shqiptarëve  
dhe Evropa**

■ Fatmir 18

**A duhet të ngrihen  
duart gjatë  
tekbireve në namaz**

■ Fatmir 37

**Televizioni,  
kompiuteri  
dhe fëmija**

■ Fatmir 51

ISSN 1409-6250



9 177 1409 6250 02

Kryeredaktor:  
Omer BERISHA

Redaksia:  
Bekir HALIMI, Talha KURTISHI,  
Muhamed DËRMAKU, Agim BEKIRI,  
Alaudin ABAZI, Ali SHABANI,  
Lulzim SUSURI, Enver AZIZI,  
Ulvi FEJZULLAHU

Bashkëpunëtorë:  
Ekrem AVDIU, Ismail BARDHOSHI,  
Enis RAMA, Ahmed KALAJA, Fadiil MUSLIU

Redaktor gjuhësor:  
Fatmir Baçi  
Redaktor teknik & faqosës:  
Halil BERISHA  
Redaktor artistik & disenji:  
Azem ZAIMI

Botues:  
Metush MEMEDI

Adresa:  
rr: 110 nr: 5, Çarshia e vjetër  
Shkup 1000  
e-mail: albislam@gmail.com  
sms: +389 75 436 718  
tel & fax: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar  
pranë Agjencisë për Informata  
të Maqedonisë nr. 02-124/2  
ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2300

ABONIMI NJËVJEÇAR  
Për Maqedoni: 600 den, Evropë: 20 €,  
Kanada dhe Amerikë: 40 €  
(në çmim janë të përfshira edhe  
harxhimet postare)

NUN-R DOEL  
Xhironlogaria: 300000001759616  
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (denar)  
Xhironlogaria: 0270100209184  
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (euro)  
Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4  
S.W.I.F.T. : KOBSMK2X  
IBAN MK07300701002091869  
Numri tatimor: 4030003487017

**alb**  
**ISLAM**  
DEL NË FILLIM TË MUAJIT

**FOCUS**  
*print*  
E-mail: fokusprint@mt.net.mk

TEL.: 02 2600 400; 2601 638; FAX 02 2601 639  
MOB. 075 275 939; 075 451 813

## Bëjmë shtypjen dhe përpunimin e:

- Vizitë-kartelave
- Kalendarëve
- Ftesave
- Pllakateve
- Flaerave
- Materialeve të ndryshme
- Katalogëve
- Librave

**Risi: Shtypim edhe me kopertina të forta**

# Pushimet verore

3

Ndonëse nocioni "pushime verore" mbart në vetvete një kuptim të gjerë, sërish vërejmë se jo pak njerëz e përkufizojnë brenda një botëkuptimi tejet të ngushtë dhe sipërfaqësorë. Në ditët tona, të tillë njerëz ndihen më tepër të kompleksuar për ta kaluar kohën atje ku shkojnë të gjithë, duke krijuar kështu një "mburrje false" para të tjerëve, kur bie fjala për pushimet, se sa e vrasin mendjen në vërtetë të pushojnë.

Kështu, për shembull, shpesh vërejmë një vërshim të dendur të popullatës drejt detit, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe faturën e tërë këtij "pushimi". Tërë kjo të lë të kuptosh se ke të bësh me njerëz që janë të kompleksuar deri në atë masë, sa që, edhe pse ndihen të lodhur, mundohen ta bindin veten se janë duke pushuar.

Do të ishte më pak tragjike sikur gjithçka të përfundonte këtu, por, fatkeqësisht, kjo po merr përmasa të rrezikshme, aq sa po shndërrohet në një sistem të caktuar të të menduarit, që do të thotë se, për shkak të tekave dhe qejfeve të "shumicës", jemi në gjendje të harrojmë interesat dhe dabilitë tona personale.

Sidoqoftë, secili ka të drejtë të zgjedhë metodën dhe vendin ku dhe si do t'i kalojë pushimet dhe këtë të drejtë nuk ia vëmë në pikëpyetje askujt. Qëllimi ynë është t'i kthehet kuptimi real të pushimit, larg komplekseve dhe shfrenimeve të pamasa.

Islami nuk e pengon njeriun që t'ia kushtojë një kohë pushimit, me qëllim të një rifreskimi për të vazhduar angazhimet dhe obligimet jetësore, ku shpeshherë ky pushim ka mundësi të jetë edhe në punë, çka mund të tingëllojë, ndoshta, si e pakuptueshme për shumicën e njerëzve.

Një dijetar e kishte traditë që tërë genien e tij t'ia kushtojë kontributit për fenë dhe siç thotë edhe vetë: "Sa herë më lodheshin sytë nga leximi dhe dora nga të shkruarit, shtrihesha për të pushuar, duke e vënë në punë mendjen, duke menduar se çfarë mund të bëja pas pushimit."

Andaj, nuk është diç e pazakonitë të pushojmë, madje, ndonjëherë mund të jetë edhe i domosdoshëm, por ajo çka kërkohet nga ne si muslimanë është që ky pushim mos të na bëjë të harrojmë se ndjenja e mbikëqyrjes së Zotit duhet të njohë pushim.

Besimtari siç duhet ta planifikojë jetën në përgjithësi, duhet që edhe pushimin e tij ta plan-

ifikojë, duke e shfrytëzuar për një lidhje më të fortë familjare, për një afërsi më të madhe bashkëshortore dhe prindërore, prej të cilëve mund të ndodhë që ta kenë penguar angazhimet dhe preokupimet e punëve të përditshme.

Ai nuk e kupton pushimin si një shkëputje mes tij dhe Zotit, por, përkundrazi, mundohet që, përmes një programi të vendosur paraprakisht, t'i avancojë këto raporte dhe të rrahë përmes këtij pushimi për një seri të re të përpjekjeve dhe angazhimeve, me qëllim sigurimin e një vendi më të lartë në xhenetin e amshueshëm.

Tani edhe ai që, bie fjala, nuk di të lexojë Kur'anin, i jepet mundësia ta mësojë një gjë të tillë, apo edhe ai që është ankuar vazhdimisht për pamundësinë e dëgjimit të ligjëratave dhe avancimit në aspektin e diturisë fetare, i ofrohet mundësia që në agjendën e pushimeve të tij të figurojë edhe një angazhim i këtij lloji.

Tërë kjo që u cek nuk është e thënë të bëhet në ndonjë ambient të caktuar, por ai mund ta bëjë këtë në ndonjë vend ku, krahas pushimit të shpirtit, i pushon edhe trupi.

Besoje se një pushim i tillë do të rigjeneronte tek muslimani qeliza të reja të besimit, të cilat do ta kthejnë atë në arenën e përditshmërisë më të kalitur dhe më të fortë se sa ishte para këtij pushimi, çka i garanton jo vetëm atij, por tërë shoqërisë një kualitet më të lartë të punës dhe angazhim më të madh sesa ishte para këtij pushimi.

Kështu duhet t'i kuptojmë pushimet dhe ky duhet të jetë roli i tyre në jetën tonë, pa rrahur që, në vend të pushimit, t'i ngarkojmë vetes tonë brenga të reja të natyrave të ndryshme, ku vetëm njëra prej tyre mjafton për t'i nxirë jetën dikujt e jo vetëm pushimin e tij.

Shfrenimi është i ndaluar dhe, si i tillë, ai sjell vetëm dëme, ku në mesin e tyre mjafton ai që shkakton hidhërimin dhe dënimin e Zotit dhe që për njeriun e mençur është brengë dhe element që duhet të llogarisë gjatë planifikimit se ku dhe si do t'i kalojë pushimet.

E këtu shfrytëzojmë rastin të lusim Zotin e Madhëruar që, me përmirësimin e qasjes tonë ndaj pushimeve, të fillojë edhe përmirësimi i shumë qasjeve tona ndaj gjërave të ndryshme në jetën tonë.

Në emër të redaksisë: Enis RAMA

# alb ISLAM

**Faqe 5** "Imani" në Vjenë, ndërsa  
"kufri dhe mosbesimi" në Medinë



**Faqe 9** IZRAELI DHE ATENTATET...  
Vrojtim i mjeteve dhe qëllimeve



**Faqe 15** Si ta dimë se vërtetë e duam Muhamedin  
paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të



**Faqe 18** Identiteti musliman i shqiptarëve  
dhe Evropa



**Faqe 23** Ligjet e pandryshueshme në gjithësi



**Faqe 28** Kujdesi i pejgamberëve për  
udhëzimin e njerëzve



**Faqe 31** Kujto këto gjëra gjatë marrjes së pagës

**Faqe 32** Konflikti ideologjik mes të vërtetës  
dhe të pavërtetës (3/3)

**Faqe 37** A duhet të ngrihen duart gjatë  
tekbireve në namaz



**Faqe 42** Jeta në këtë botë është vetëm  
kënaqësi e rreme



**Faqe 47** Çfarë vendosa të bëj para 18 viteve

**Faqe 49** Më dëgjoni edhe pse jam i vogël




**Faqe 51** Televizioni,  
kompjuteri dhe fëmija

**Faqe 56** Rregullat e emërimit të fëmijës

**Faqe 59** Besimi në kader 2/2

**Faqe 63** Prezantim i librit "Kushtet e fesë"





# "Imani" në Vjenë, ndërsa "kufri dhe mosbesimi" në Medinë

**Talha KURTISHI**

**P**rej atje larg, nga Vjena, Nexhad Ballkani, i njohur si Ebu Muhamed, njeri pa shkollim as formal, as tradicional fetar, me deklaratat e tij krijon huti në mesin e myslimanëve. Personi në fjalë e ka ndërprerë shkollimin e tij në Medinë sepse kishte kuptuar se atje, në qytetin e të Dërguarit, në qytetin nga i cili nuk ka dalë asnjë bidat, nuk po mësohet besimi (imani), përkundrazi mësohet mosbesimi (kufri). Në një prononcim së paku skandaloz ai thotë:

"Edhe pse isha në Medinë, atje nuk e

mësova islamin. Këtë që po ua them nuk e kam mësuar në fakultet. Në të kundërt, këtë që po u tregoj mundet (prej meje) vetë profesori i fakultetit ta mësojë, me lejen e Allahut, sepse ai vetë nuk e di..."

Si duket ky gjeni në Vjenë e gjeti atë që nuk pati mundësi ta gjejë në Medinë.

Ai dyshon edhe në haxhin që e kishte kryer gjatë kohës derisa qëndronte në Medinë:

"E falënderoj Allahun që më dha mundësinë të korrigjohem. Këtë ua thashë dhe disa vëllezërve para ca ditësh

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

në mesxhid. Pasha Allahun, mendoj se duhet ta përsëris Haxhin. E kam bërë tre herë, por mendoj se nuk e kam bërë në Islamin e drejtë (e kundërta e islamit të drejtë është të jesh mosbesimtar) edhe pse isha në Medinë."

### QËNDRIMI I TU NDAJ DUETARËVE:

Për dijetarët e Ummetit, pishtarët e dijes, të cilët në rrugën e përhapjes së Kur'anit dhe Sunetit e kanë investuar kohën, pasurinë e jetën, prapëseprapë njerëzsi Ebu Muhamedi marrin guxim të flasin. Ata janë plakur duke i shërbyer Sunetit të Dërguarit të

Allahut, salallahu alejhi ue selem, duke qartësuar hadithet e vërtetë nga ato të trilluarat!

Nasirudin el-Albani!? - i ushqyer me infuzione, dy ditë para se të ndërronte jetë kërkoi që të dërgohet në Mesxhidul Haram që deri në çastin e fundit të shpjegonte Kuranin dhe Sunetin e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem!

Shejh Muhamed ibën el Uthejmini!? - iu shter zëri nga të folurit e ligjërimet, komentimet e librave të akides, fikhut dhe haditheve.

E ngjashme ishte edhe jeta i Ibën Bazit, Abdullah ibën Xhibrinit dhe ulemave të tjerë. Për këto dijetarë ai thotë:

"...por më analizoj mua dhe thotë se nuk jam vëllai i tij, thotë kështu sepse kam thënë për dikë se është xhahil, është kështu apo ashtu, ndërsa Fehdin, i cili është qafir dhe tagut, nuk dëshiron ta

U lodh duke folur për tagutin dhe qeverinë e tagutëve, ndërsa vet aq vjet jeton në Perëndim në zemër të krishterëve me vizë qëndrimi Që të fitojë atë vizë ai natyrisht është dashur të nënshkruaj se do të respektoj ligjin e tyre, jeton nga ndihma sociale e tyre... Të tjerët i fton në xhihad ndërsa vogëlsia e tij jeton dhe kënaqet nga të mirat e kësaj bote.

analizojë. Nuk dëshiron sepse i pëlqejnë dijetarët e Fehdit, të cilët e harxhuan gjithë jetën duke e mbrojtur atë. Gjithë jetën!"

Për Abdur Rahman Abdul Halikun thotë: "...Njeri në parlament, është qafir sepse vendos ligje krahas ligjit të Allahut, subhanehu ve teala."

Edhe pse Ebu Muhamed thotë për vete se njerëzit padrejtësisht e akuzojnë për tekfir (anatemoje nga Islami), ai me deklarata vërteton të kundërtën. Për çështjen e zgjedhjeve dhe votimeve ai pohon se qafir është secili që nuk pajtohet

me të (haram është dalja në votime), edhe sikur të ishte dijetari më i madh i të gjithë myslimanëve. Ky rregull vlen për të gjithë, prandaj i përfshinë edhe dijetarët më me peshë të kohës sonë si: Ibën Bazi, Ibn Uthejmini, Nasirudin el-Albani, Abdulla Xhibrini, Selman ibën Fehd el Aude, Nasir el-Umeri, Abdurrahman el-Ber-rak, Sulejman el Eshkari, qendrat rajonale dhe botërore për fetva siç janë: Qendra për fetva në Evropë, Komisioni i përhershëm për fetva dhe të tjerë të cilët u lejuan myslimanëve të votojnë dhe të marrin pjesë në zgjedhje, angazhimin politik, votimin për shkak të situatës specifike në të cilën ndodhen. Nëse ai thotë se nuk i bën tekfir institucionet dhe dijetarët e lartpërmendur, atëherë duhet të përmbahet nga tekfiri i thirrësve dhe qytetarët e thjeshtë, të cilët pasojnë këta dijetarë,

por nëse thotë se të gjithë janë jobesimtarë, atëherë ky qëndrim i tij nuk është larg besimit të havarixhëve të cilët i bëjnë tekfir dijetarët më të mëdhenj të këtij Umeti...

### I SHPALL PËR QAFIRA EDHE THIRRËSIT BOSHNJAK

Ky meskin nuk ngurron të thotë: "Semir Imamoviç është qafir, Abdusamed Bushatliç është qafir, dhe çdo kush që lejon dhe thërret në votime", thotë Nexhad Ballkan. Këto fjalë që po i thotë Nexhad Ballkan pa asnjë pikë frike e turpi, ngrijnë gjakun në zemrat e besimtarëve të sinqertë. Ata as që duhen komentuar. Ah, sikur asnjëherë të mos ishin thënë.

### MISIONARI I MAKDISIUT

Është e pamundur që dijetarët më të mëdhenj të cilët studiojnë fenë nga 60-70 vjet me metodën e gjeneratave të para, të mos kuptojnë ajetet të cilat flasin për tagutin, për gjykimin e Allahut, subhanehu ve teala, ndërsa i kupton Ebu Muhamedi i cili diturinë e merr nga librat. Është ironike që Nexhad Ballkani thirrësve u thotë se verbërisht i pasojnë dijetarët më të mëdhenj të kohës sonë në pyetjet më të vështira, siç është pyetja në lidhje më tekfirin, ndërsa ai fshihet prapa pretendimit se ai pason vetëm Kuranin dhe Sunetin, e në të vërtetë e pason Ebu Muhamed el- Makdisiun dhe të tjerë të ngjashëm, sepse ai nuk ka pas një qën-

"...por më analizon mua dhe thotë se nuk jam vëllai i tij, thotë kështu sepse kam thënë për dikë se është xhahil, është kështu apo ashtu, ndërsa Fehdin, i cili është qafir dhe tagut, nuk dëshiron ta analizojë. Nuk dëshiron sepse i pëlqejnë dijetarët e Fehdit, të cilët e harxhuan gjithë jetën duke e mbrojtur atë. Gjithë jetën!"

drim të këtyllë derisa nuk u njoh me librat e Makdisiut dhe derisa nuk i dëgjoji ligjëratat e tij. Teoritë të cilat i thotë Ballkani shumica janë të marra nga ato libra dhe duhet të bëhet i sinqertë e ta pranojë këtë.

Ajo me të cilën Ebu Muhamedi arriti të tërheq vëmendjen e dëgjuesve të cilët (Allahu e di më së miri) shumica janë të sinqertë dhe duan ta dinë të vërtetën ndërsa shumica tjetër janë të ri në fe, është thënia e tij: argument janë Kurani dhe Suneti e jo deklaratat e njeriut. Administratori i dhomës së

Paltalk, ku ligjëron ai është shembulli më i mirë për këtë. Ai verbërisht duke kuptuar këtë, në fjalën e vet thotë: " Në këtë dhomë nuk ka vend për fjalët Ebu filanit apo ibën filanit, para gjithëve është Kurani dhe Suneti, pastaj të tjerët." Njeriu në dëgjim të parë do të thotë:

Ajo me të cilën Ebu Muhamedi arriti të tërheq vëmendjen e dëgjuesve të cilët (Allahu e di më së miri) shumica janë të sinqertë dhe duan ta dinë të vërtetën ndërsa shumica tjetër janë të ri në fe, është thënia e tij: argument janë Kurani dhe Suneti e jo deklaratat e njeriut.

Administratori i dhomës së Paltalk, ku ligjëron ai është shembulli më i mirë për këtë.

"shih ky për çdo gjë që thotë ka argument të qartë në Kuran dhe Sunet, ndërsa thirrësit e tjerë bazohen në dijetarë dhe fshihen prapa tyre, nuk kanë as gjysmën e argumentit për atë që thonë", por kjo s'është asgjë tjetër përpos një mashtrimi klasik. Si duket dijetarët (larg asaj qofshin), nuk argumentojnë me Kuran dhe Sunet, ndërsa Ebu Muhamedi për gjithçka që flet ka argument! A nuk është kjo një vetëmashtrim dhe mangësi!? Sipas kësaj logjike ne nuk paskemi nevojë as për as'habët, tabi'inët, tabitabi'inët, as për gjeneratat e ulemave pas tyre, as për librat e sqarimet e tyre sepse mundemi direkt të kuptojmë Kuranin dhe Sunetin, nuk na duhet ndërmjetësues për sqarim. Duke u bazuar në këtë atëherë nuk duhet të ndjekim as dijetarët e sotit por vetëm Kuranin dhe Sunetin, pa sqarime të dijetarëve.

### **PSE E THONI ATË QË NUK E PUNONI:**

Ky përbuzës i punës dhe veprave të dijetarëve, që me lehtësi të madhe i nënçmon myslimanët, si duket fjalët e tij nuk ka nevojë t'i vërteton me vepra. U lodh duke folur për tagutin dhe qeverinë e tagutëve, ndërsa vet aq vjet jeton në Perëndim në zemër të krishterëve me vizë qëndrimi Që të fitojë atë vizë ai natyrisht është dashur të nënshkruaj se do të respektoj ligjin e tyre, jeton nga ndihma sociale e tyre...Të tjerët i fton

në xhihad ndërsa vogëlsia e tij jeton dhe kënaqet nga të mirat e kësaj bote. A nuk ka thënë Allahu në Kuran: O ju që besuat pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni!(Saf 2-3)

Për muxhahidët e Bosnjës dhe luftën e tyre të drejtë ai e jep këtë koment: "...po mburren me xhihadin dhe luftën e tyre e quajnë xhihad. Xhihad për shtet shekullar dhe Bosnje demokratike!? Luftës në radhët e ushtrisë së tagutit, me synime mushrike, po i thonë xhihad?! Dhe njerëzit që aty luftuan- nuk po flas për individë- i quajnë myslimanë dhe luftëtarë në rrugën e Allahut. Them: Falënderoju Allahut që nuk ke vdekur në atë luftë dhe Të ka dhënë shans të përmirësohesh..."

### **NË KËSHILLË:**

Ajo me të cilën Ebu Muhamedi arriti të tërheq vëmendjen e dëgjuesve, për të cilët shpresojmë, e Allahu e di më së miri, se janë të sinqertë dhe e kërkojnë të vërtetën, por janë të ri në fe, është parulla "Vetëm Kur'an dhe Sunet". Dëgjuesit e këtij njeriu i thërrasim të largohen

para se të bëhet vonë, para se muslimani të shndërrohet në armik i muslimanit, para se të vijmë në një situatë të padëshirueshme, prej të cilës vetë myslimanët do të kenë një dëm më të madh. Pikërisht drejt këtij përfundimi të shpirtërisht të sinqertë të këtij njeriu.

"E falënderoj Allahun që më dha mundësinë të korrigjohem. Këtë ua thashë dhe disa vëllezërve para ca ditësh në mesxhid. Pasha Allahun, mendoj se duhet ta përsëris Haxhin. E kam bërë tre herë, por mendoj se nuk e kam bërë në Islamin e drejtë (e kundërta e islamit të drejtë është të jesh mosbesimtar) edhe pse isha në Medinë."



# IZRAELI DHE ATENTATET...

## Vrojtim i mjeteve dhe qëllimeve

**Adnan Ebu AMIR/ Studiues palestinez për çështje izraelite.**

**P**ublikimi i ditëve të fundit, i bërë nga shteti izraelit lidhur me mundësinë e përdorimit të kësaj politike, sidomos me udhëheqësit politikë të kundërshtarëve të tyre, nuk është një gjë e re. Historia e përgjakshme e ushtrisë izraelite është e mbushur me raste të tilla; po ashtu, edhe listat e tyre janë të pafund me aksione vrasëse, që para themelimit të shtetit, në vitin 1948 e deri tani. Kujtesa palestineze, sikundërse edhe ajo arabe, vazhdon që t'i mbajë mend dhe t'i kujtojë ende emrat të sa e sa njerëzve të tyre; emrat e politikanëve,

Ushtria sioniste pretendon se, vijimi i politikës së atentateve politike është një prej gjërave më të mira, pasi i përgjigjet nevojës së sigurisë izraelite. Ngase kjo, sipas tyre, është mënyra më ndikuese në ndaljen e "bombës së kurdisur", siç e quajnë syresh. Duke vëzhguar disa aksione të tyre, të diktuar nga logjika e atentateve politike; duke mbledhur dëshmitë e atyre që kanë shpëtuar nga këto atentate, apo, duke vërejtur dhe zbuluar këto aksione nëpër mjetet e informimit, arrijmë në një përfundim, i cili mund të tingëllojë si përvijim i skenarit parapërgatitor, planit dhe kryerjes së këtyre atentateve.



**Aktuale**

dijetarëve, mendimtarëve dhe kryengritësve, të cilët u bënë viktimë të kësaj politike të përgjakshme, të zhvilluar me mënyra dhe rrugë të ndryshme.

### **Një: Dhoma e aksioneve... dhe vendimi vrasës.**

Ushtria sioniste pretendon se, vijimi i politikës së atentateve politike është një prej gjërave më të mira, pasi i përgjigjet nevojës së sigurisë izraelite. Ngase kjo, sipas tyre, është mënyra më ndikuese në ndaljen e "bombës së kurdisur", siç e quajnë syresh.

Duke vëzhguar disa aksione të tyre, të diktuar nga logjika e atentateve politike; duke mbledhur dëshmitë e atyre që kanë shpëtuar nga këto atentate, apo, duke vërejtur dhe zbuluar këto aksione nëpër mjetet e informimit, arrijmë në një përfundim, i cili mund të tingëllojë si përvijim i skenarit parapërgatitor, planit dhe kryerjes së këtyre atentateve. Radhitja e tyre bëhet në këtë mënyrë:

1- Vendos në listën e atentateve të saj politike dhjetëra emra të kryengritësve, kundër të cilëve, pas studimit të dokumenteve të çështjeve të sigurisë, ka shpallur dënimin me "vdekje". Në këtë rast, sigurimi luan rolin e paditësit, gjykatësit si dhe vënësit në jetë, apo zbatim-it, përmbushjes së aksionit.

2- Grumbullimi i të dhë-

nave në lidhje me kundërshtarin, veçanërisht vendbanimin dhe lëvizjet e tij, sidomos ato me qëllim kërcënimi.

3- Gjatë planit për atentate marrin pjesë disa njësite të sigurisë, njësitë ushtarake etj., në krye të tyre qëndron "njësiti i sigurisë së brendshme - Shabak". Ky aparat shtetëror mbështetet në radhë të parë të rrjeti i bashkëpunëtorëve të tij, të cilët mbledhin të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me personin e piketuar. Interesohen për shtëpinë e tij, numri i dhomave të saj, makinën me të cilën ai lëviz, rrugën nëpër të cilën kalon, orarin dhe vendin e punës. Dhoma e aksioneve pasi t'i plotësojë këto të dhëna, lidhet menjëherë me personin që është në vendngjarje. Ky i fundit është fillpërçuesi, ai që njofton se personi që kanë vënë "në shënjestër" ka dalë nga vendi i caktuar, ka lëvizur me makinë, duke përcjellë të dhëna për ngjyrën e makinës, si dhe për personat që e shoqërojnë.

4- Pastaj i vjen radha njësitit të sigurimit ushtarak "Eman", i pajisur me mjetet më të përparuara të teknologjisë së sotme. Detyra e tyre në aksionin është të plotësojnë kuadrin e përcjelljes dhe vëzhgimit të njeriut të vënë në shënjestër. Ndër këto mjete janë edhe

"Këto aksione nuk kanë bërë asgjë vetëm se kanë shtuar humbjet e Izraelit dhe janë shkak i shtimit edhe një herë më shumë të lëvizjeve të kundërshtarit. Për këtë, e shoh, se është e lejuar ta pranosh dhe ta thuash të vërtetën e cila është se: aksionet e spastrimit nuk e ruajnë gjakun e popullit, por, përkundrazi e shtojnë derdhjen e tij. Gjithashtu shkak i këtyre, aksioneve nuk është aspak çështja e sigurisë, por arsyet tjera si ato politike, psikologjike etj."

aeroplanët pa pilot, të cilët përcjellin pa ndërprerë fotografime ekzakte të shtëpisë a makinës me të cilën lëviz kundërshtari. Po ashtu, shfrytëzojnë mjetet e komunikimit, duke i përcjellë të dhënat e përthithura në forma të ndryshme, shpesh pa përdorur aparat telefonik.

5- Formojnë dhomë vëzhgimi nën kujdesin e "Shtatmadhorisë", të cilën e udhëheq drejtori i kësaj të dytës, që është nën vrotimin dhe varësinë e ministrit të mbrojtjes. Ky i fundit i paraqet regjistrat e kundërshtarëve te kryeministri.

6- Në bazë të të dhënave të shërbimit sekret, merret vendimi i formës së atentatit. Për këtë arsye, ndodh të përdoren edhe armë ajrore, të cilat kanë filluar të vërehen dukshëm në aksionet vrasëse me qëllime politike.

Pastaj, "Shabak" fillon studimin e vendit dhe kohës së përshtatshme, duke shfrytëzuar lëvizjet e pavërejtura, apo duke zbuluar planet e kundërshtarit përmes përgjimit të telefonave shtëpiakë apo atyre celularë. Të gjitha të dhënat i vendos në tavolinën e bordit të vogël të udhëheqësve të sigurisë. Në të, mjetet e vëzhgimit dhe të sigurisë vërtetojnë se aksioni është i gatshëm për t'u vënë në jetë dhe nuk pret përpos se marrjen e pëlqimit përfundimtar nga ana e politikës.

Mirëpo, kjo gjë nuk ka nevojë për shumë debate apo diskutime, ngase vendimi me vdekje vetëm se është marrë më herët, gjithashtu gjykimin përfundimtar e ka dhoma e aksioneve, e cila e merr në bazë të informacioneve të shërbimit sekret. Dhoma e aksionit i vjel të dhënat prej personit vëzhgues, i cili gjendet në terren, deri tek

helikopteri "apaç" apo tek aeroplani luftarak "f-16", i cili pastaj, me fotografitë e marra, lëshon raketën e tij drejt kundërshtarit të tyre të kërkuar.

### **Dy: Mënyrat ndryshojnë... por atentati mbetet gjithmonë i njëjtë!**

Te shërbimi sekret izraelit, mënyrat e atentateve politike ndryshojnë. Edhe pse shumica e tyre, zakonisht, është eksplozim i makinave të kryengritësit, apo telefonave të tyre apo i qendrave ku ata mblidhen. Këto mënyra zakonisht përdoren në pjesën perëndimore të Palestinës. Ndërsa në rripin e Gazës, mbështetje të plotë gjatë këtyre aksioneve kanë mjetet ajrore, si p.sh, helikopterët "apaç", aeroplanët luftarakë "f-16". Përdoren, po ashtu, edhe aeroplanët pa pilot, të cilët bartin fotografitë e makinës së armikut, cilësitë e saj etj. Përpos kësaj të fundit ndodh të zbulohet vendi i tij përmes telefonit, sidomos atij celular, apo duke vendosur antena dhe mjete përcjellëse nëpër makinat e kundërshtarëve përmes punëtorëve të posaçëm. Këto antena, përmes rrezeve, të cilat i zbulon "apaçi", përcaktojnë vendin e "gjahut" të tyre, të cilin pastaj edhe e sulmojnë për ta vrarë.

Është me rëndësi të ceket fakti se, njësitet që merren me atentatet politike janë: njësi i forcave speciale "komandos", që janë pjesë e njësitit të forcave ajrore, të njohura me emrin "Shildag", njësi i "Shtatmadhorisë 13" dhe njësi i policor për luftën kundër terrorizmit.

Mënyrat e atentateve politike të përdorura nga kjo ushtri mund të përmblidhen si vijon:

1- vendosja e eksplozivit në makinën e kundërshtarit. Kjo arrihet përmes dërgimit të njerëzve të posaçëm tek shtëpia e armikut, të cilët e vendosin këtë eksploziv te makina e tij. Ata bëjnë lidhje të rrymës së makinës me atë të bombës, e cila, porsa merr kontakt, shpërthen. Kjo mënyrë nuk ka nevojë për shumë kohë e as personi që e vë s'është e thënë të ketë njohuri të mëdha në lëmin e elektronikës; gjithçka i duhet janë njohuritë e përgjithshme rreth elektrikes në makinë e asgjë tjetër.

2- Shpërthimi i makinave nga distanca. Kjo mënyrë zakonisht përdoret për atentatet e njerëzve, ndaj të cilëve është e vështirë t'u afrosh. Një vepër e tillë është teknologji bashkëkohore, nuk ka rreziqe, as nuk merr kohë. Aksion zgjat vetëm disa sekonda.

3- Vrasja për së afërmi me armë. Këtë aksion e kryejnë forcat speciale, që vishen me rroba arabe dhe, porsa i afrohen gjahut, e sulmojnë me shpejtësi.

4- Sulmi në shtëpi. Ndodh që forcat sioniste ta sulmojnë shtëpinë e armikut të tyre, të cilin, pasi e kapin, e vrasin para familjes dhe fëmijëve të tij. Kjo mënyrë përdoret shumë shpesh në pjesën perëndimore të vendit, ngase aty lëvizin më lirë, çka vërtet tërheq vëmendjen.

5- Bombardimi me aeroplanë. - Është prej mënyrave më të përdorura për atentate të armikut, sidomos në rripin e Gazës. Përmes kësaj mënyre janë vrarë

me qindra kryengritës si dhe ndihmës të tyre.

6- Telefonat. Duke u përgjuar telefonat, e, sidomos ata celularë, arrijnë të përcaktojnë vendndodhjen e tyre. Duke e përcjellë përmes satelitëve të tyre thirrjen e tij telefonike e përcaktojnë largësinë dhe gjërat të cilat e rrethojnë atë. Këtu nuk duhet harruar se ndodh që kundërshtari të vërehet përmes tonit

apo valëve të zërit të tij gjatë thirrjeve telefonike përmes celularit.

Ka ndodhur që raketa izraelite ta sulmojë makinën e kundërshtarit dhe, pasi të ketë shpëtuar, menjëherë ka sulmuar e dyta, personi menjëherë ka vërejtur se është duke u përgjuar dhe e ka hedhë celularin nga xhepi i tij, e pastaj e ka sulmuar edhe e treta. Kjo tregon se raketa i pason valët elektro-magnetike të celularit edhe nëse ai është i mbyllur. Këtë gjë e ka pohuar një nga eprorët izraelitë gjatë

Ka ndodhur që raketa izraelite ta sulmojë makinën e kundërshtarit dhe, pasi të ketë shpëtuar, menjëherë ka sulmuar e dyta, personi menjëherë ka vërejtur se është duke u përgjuar dhe e ka hedhë celularin nga xhepi i tij, e pastaj e ka sulmuar edhe e treta.

një bisede të tij, ku ka treguar se përmes tyre arrihet deri tek vrasja e disa kundërshtarëve të tyre.

7- Makinat e mbushura me eksploziv si dhe me kamera të fshehta. Këto i përgatisin brenda shtetit të tyre Izraelit e pastaj i dërgojnë në rripin e Gazës të përziera me makina të tjera përmes firmave tregtare. Disa specialistë të fushës së eksplozimit kanë gjetur këso lloj makinash, në të cilat gjenden katër bazamente të kamerave të cilat incizojnë çdo gjë që ndodh përreth makinës. Në to ka mbi dhjetë sy të cilët

fotografojnë. Ato janë të vendosura nëpër vrima të vogla të makinës, rreth xhamit të parëm dhe atij të pasmë, tek dorezat, etj.

### **TRE: Suksesi në aksione... zotësi e okupatorit apo dështim i kundërshtarit?**

Duke u mbështetur në të dhënat e fundit, "të përafërta", para çmendurisë së fundit të ndërmarrë në këtë fushë, numri i atentateve më helikopter "apaç" arrin në 46. Ai me aeroplanë luftarakë "f-16" është mjaft i madh. Përmes rrethimeve dhe përleshjeve me armikun janë vrarë 59 kundërshtarë. Ajo e pusisë si dhe e ndërhyrjes së forcave speciale arrin në 35, kurse nëpër pika dhe kazerma ushtarake arrin 16.

Sa i përket vend atentateve, dihet se 86 prej tyre kanë ndodhur brenda shtëpive apo banesave të kundërshtarit. Ajo në makina dhe mjete tjera bartëse vjen në radhë të dytë me 74 raste. Vrasja nëpër rrugë arrin vendin e tretë me 27. Në vende të hapura dhe nëpër vende pune arrin në 22 atentate. Kurse ato afër kufijve vijnë në radhë të pestë me 1 rast.

Mirëpo, lind pyetja: cilat janë shkaqet që ndihmuan Izraelin të jetë i suksesshëm më këtë politikë të tijen?

1- mungesa e truprojave tek disa kundërshtarë të tyre.

2- mungesa e mjeteve të sigurisë si dhe e forcave palestineze që ta kenë situatën nën kontroll.

3- mungesa e njohurive të duhura si dhe mos mbajtja fshehtë e lëvizjeve të tyre tek disa prej kundërshtarëve të Izraelit.

4- përdorimi i mjeteve vrasëse nga ana Izraelite dhe përfitimi prej tyre, si

dhe prej teknologjisë bashkëkohore të cilën e disponojnë.

5- Dobësia e personelit të institucioneve të sigurisë tek palestinezët të cilët do të mund t'i zbulonin lëvizjet e armikut.

### **KATËR: Kuptimi i shkaqeve të atentateve politike si dhe vlerësimi i tyre.**

Sipas Amus Xhelbu ish-këshilltar për çështjet e sigurisë dhe ligjërues në qendrën "Hertezlia", Izraeli beson se aksionet e tij vrasëse me qëllime politike i shërbejnë për disa qëllime dhe realizojnë disa kuptime:

1- Pengesa e rritjes dhe zhvillimit të grupeve të armatosura, të cilat veprojnë ushtarakisht në terren kundër ushtrisë sioniste dhe popullatës përkatëse. Po ashtu, ata janë të mendimit se i ndalon përgatitësit e aksioneve dhe sulmeve. Për këtë shkak edhe merr vendime për atentate të udhëheqësve të këtyre grupeve. Po ashtu, këto atentate janë shkak për zvogëlimin e lëvizjeve apo tërheqje të këtyre udhëheqësve, lëvizje këto që rrezikojnë Izraelin.

2- Bindja e të tjerëve se Izraeli ka një fuqi, e cila është e aftë për të arritur çdo qëllim që i vë vetes. Po ashtu, bindja se ka një teknologji, e cila është e aftë ta ketë nën kontroll sigurinë e territorit izraelit, e cila shfaqet në përgjimin e çdo lëvizjeje të palestinezëve.

Manifestim i fuqisë për të arritur deri te çdo fshehtësi përmes përdorimit të bashkëpunëtorëve (hafijeve) të tij, mbledhjes së të dhënave logjistike, informata këto, të cilat konsiderohen shkaku numër një për arritjen e suksesve në këto aksione vrasëse.

3- Thyerja e moralit të palestinezëve. Forcë kjo në të cilën mbështeten palestinezët, e cila konsiderohet më e dobishmja kundër armikut të tyre, ngase në asnjë aspekt tjetër mjetet mes dy palëve nuk janë të barabarta.

4- Angazhimi i rezistencës me vetveten dhe sigurinë e tij, gjë që ndikon negativisht tek ata që të mos kenë kohë të mendojnë për organizim të aksioneve kundër armikut. Megjithatë, nëse njeriu vetëm pak mendon për politikën e tyre të atentateve, vëren qartë se është politikë e dështuar, ngase s'ka arritur asesi që t'i ndalë krejtësisht kundërshtarët. Për këtë që përmendëm, reporteri ushtarak izraelit Emir Bar Shalum thotë: "shpresat e gjeneralëve tanë lidhur me politikën e spastrimit dhe atentateve politike kanë humbur. Sepse, një gjë e tillë, udhëheqësve të lëvizjes "Hamass" vetëm se ua shton interesimin që ta ruajnë veten më shumë, gjë kjo e cila ndikon në mospasuesin të forcave tona gjatë këtyre aksioneve. Në të vërtetë, ata, duke menduar më shumë për vete, në fillim lanë anash sulmet kundër nesh, por, kur panë sulmet tona kundër tyre, vetëm se iu shtuan dëshirat dhe ëndrrat për t'u kundërvënë".

Në të njëjtën metodologji jep komentet e tij edhe komentatori Bi Mihail i cili, për mospasuesin e këtyre atentateve, ndër të tjera thotë: "Këto aksione nuk kanë bërë asgjë vetëm se kanë shtuar humbjet e Izraelit dhe janë shkak i shtimit edhe një herë më shumë të lëvizjeve të kundërshtarit. Për këtë, e shoh, se është e lejuar ta pranosh dhe ta thuash të vërtetën e cila është se: aksionet e spastrimit nuk e

ruajnë gjakun e popullit, por, përkundrazi e shtojnë derdhjen e tij. Gjithashtu shkak i këtyre, aksioneve nuk është aspak çështja e sigurisë, por arsyet tjera si ato politike, psikologjike etj."

Ndërsa Zeif Shif, njëri ndër njerëzit më të ditur lidhur me çështjet e ushtrisë izraelite thotë: "Atentatet i ngjajnë vërtetë benzines, e cila, më tepër sesa ta shuajë, e ndez edhe më shumë zjarrin e kundërshtarit dhe është shkak për shtimin e rrezikut të sulmeve të tij edhe pse udhëheqësit tanë ushtarak pretendojnë se kanë korur fitore të madhe kundër armikut të tyre. Fjalë kjo, e cila të kujton fjalën e mbretit Berus, i cili thotë: "Nëse na vjen edhe një herë kjo ndihmë do të vijë bashkë me shkatërrimin".

Kështu, rezistenca ka vërtetuar se politika e atentateve është politikë e pasuksesshme për shkatërrim të armikut. Gjë kjo, të cilën e vërtetoi edhe Xhedon Lifi me fjalën e tij: "Gjersa Izraeli vijon akoma politikën e vjetër të re, e cila beson në teorinë e "Ki vai" që t'i shtrëngojnë sa më shumë organizatorët e sulmeve kundër shtetit të tyre më qëllim që të ndalen nga këto aksione është politikë shterpë, sepse dobitë që arrin Izraeli nga kjo politikë janë plotësisht të kundërta. Atentatet e ashpra nxitin edhe më shumë rezistencën se sa kur të vijohet politika e ndaljeve të këtyre sulmeve në ndonjë mënyrë tjetër."

*Përktheu: Lulzim Susuri*

# Si ta dimë se vërtetë e duam Muhamedin paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të



**Përshtati: Ekrem B. AVDIU**

**Th**otë i Madhëruari: "Thuaj: Nëse e doni Allahun, më pasoni mua, do të ju dojë Allahu dhe do t'ua falë mëkatet..." (Alu Imran: 31)

Thotë i Dërguari paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të: "Nuk beson asnjëri prej jush derisa mos t'i bëhem

unë më i dashur se vetja, fëmijët, prindërit dhe të gjithë njerëzit."

## THANË PËR DASHURINË:

Ka thënë Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të: "I Dërguari i Allahut ishte më i dashur tek ne sesa pasuritë, fëmijët,

Artikuj

prindërit dhe se uji i ftohtë në etjen e madhe."

Ka thënë Zejd b. Detheneh, kur mekkasit e nxorën për të vrarë dhe e pyetën: A do të dëshiroje që Muhamedi të ishte tani në duart tona që ta vrasim ndërsa ti të ishe tek familja jote? Ai u përgjigj: "Vallahi, nuk do të dëshiroja që Muhamedi as në vendin ku është tani, të theret nga një ferrë, e unë përballë kësaj të rrija tek familja ime." Atëherë, udhëheqësi i tyre Ebu Sufjani tha: "Nuk kam parë asnjë njeri që e do dikë prej njerëzve ashtu si e duan Muhamedin shokët e tij."

Abdullah b. Zejd El-Ensari, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur i erdhi lajmi për vdekjen e të Dërguarit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "O Allahu im, ma merr shikimin që të mos shikoj askënd pas të dashurit tim, Muhamedit," dhe mbeti i verbër.

## SHENJAT E DASHURISË

Këto janë disa nga shenjat e dashurisë ndaj të zgjedhurit Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, që t'i kemi përpara dhe të shohim se sa është dashuria jonë ndaj tij, e ato janë:

1. Pasimi i tij, praktikimi i sunnetit të tij dhe ecja rrugës së tij. Udhëzimi sipas direktivave të tij dhe të respektuarit e asaj që ka definuar sheriati. Vetëm me këtë mund të arrijmë deri tek dashuria e Allahut: "**Thuaj: Nëse e doni Allahun, më pasoni mua, do t'ju dojë Allahu dhe do t'ua falë mëkatet...**" (Alu Imran: 31)

Ka thënë Atai: "Ai që e disiplinon veten me rregullat e sunnetit, Allahu

Imani i vërtetë realizohet me pranimin e gjykimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, për ty apo kundër teje, me fjalë dhe me vepër, me punë dhe lënie, me dashuri dhe urrejtje.

do t'ia ndriçojë zemrën me dritën e njohjes."

Ka thënë El-Xhunejdi: "Të gjitha rrugët janë të mbyllura përveç rrugës së atyre që i pasojnë gjurmët e të Dërguarit paqja, dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, sepse Allahu i Madhëruar thotë: "Pasha Madhërinë dhe Krenarinë Time, sikur të vinin njerëzit nga çdo rrugë dhe të kërkonin që tu hapej çdo derë, nuk do t'ua hapja derisa të mos hyjnë pas teje (o Muhamed).'" (Nga libri Tariku-l-hixhretejn, i Ibnu-l-Kajjimit, fq.19).

2. Të praktikuarit e dispozitave të shariatit dhe njëkohësisht ai që pretendon dashurinë mos të ndiejë ngushtësi në shpirtin e tij prej asaj që gjykon (vendos) Allahu dhe i Dërguari i Tij paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Allahu i Madhëruar thotë: "**Jo, pasha Zotin tënd, nuk kanë besuar përderisa të mos pranojnë ty si gjykatës për atë që nuk pajtohen ata, pastaj të mos ndiejnë ngushtësi për atë që ke gjykuar dhe të dorëzohen plotësisht.**"

Imani i vërtetë realizohet me pranimin e gjykimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, për ty apo kundër teje, me fjalë dhe me vepër, me



punë dhe lënie, me dashuri dhe urrejtje.

3. Të përkujtuarit e tij dhe të dërguarit salavat mbi të. Ai që do diçka, e përmend shumë atë gjë. Madje, Allahu e ka bërë shenjë të besimit dërgimin e salavatit mbi të: **"O ju që keni besuar, dërgoni salavat dhe përshëndetje mbi të."** Si mundet njeriu të mos lakmojë në dhjetë salavatet e Allahut, kur ky i dërgon një salavat të Dërguarit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të?!

4. Dashuria ndaj Kur'anit me të cilin ka ardhur i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dhe praktikimi i mësimave të tij, sepse, nëse dëshiron të dish se sa zë vend tek ti dashuria ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij, shiko sa zë vend dashuria ndaj Kur'anit në zemra.

Ka thënë Othmani, Allahu qoftë i kënaqur me të: "Sikur zemrat tona të ishin të pastra, kurrë nuk do të ngopeshim me fjalët e Allahut." Këtë e heton ai që e ka zemrën të butë, kur e dëgjon Librin e Allahut duke u lexuar. Allahu i Madhëruar thotë: **"Kur e dëgjojnë atë që i është shpallur të Dërguarit, i sheh sytë e tyre se si rrjedhin lot, për shkak të asaj që e njohin prej të vërtetës."**

5. Ndjenja e madhësisë së tij kur të përmendet emri i tij, sepse shumë prej sahabeve i kaplonte një ndjenjë e veçantë kur përmendej i Dërguari, disa, madje, edhe qanin.

6. Mallëngjimi i madh për ta takuar, sepse, çdonjëri që do dikë, e merr malli për ta takuar.

7. Dashuria ndaj sunnetit të

tij dhe leximi i haditheve të tij, ngase shpirti dhe zemra nuk gëzohet përveçse kur dëgjojnë fjalët e Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

8. Ndhimesa e fesë së tij me fjalë dhe vepra, mbrojtja e shariatit të tij, si dhe të pajisurit me moralin e tij si në bujari, altruizëm, mençuri, durim, përballim të vështirësive dhe, posaçërisht, për hir të fesë.

9. Ai që do, forcohet nga dashuria e tij dhe ngushëllohet me rastin e fatkeqësive dhe i përballon ato, madje, nuk i duken aq të rënda sa u duken të tjerëve.

10. Dashuria ndaj familjes së tij, pasardhësve dhe shokëve të tij. Ka thënë Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të: "Të mbaj lidhje me të afërmit e të Dërguarit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, është më e dashur për mua sesa të mbaj lidhje me të afërmit e mi."

Mirë ka thënë poeti:

O familje e të Dërguarit, dashuria ndaj jush

Është obligim nga Allahu në Kur'anin që e ka zbritur

Ju mjafton juve krenari se ju jeni ata që Ai që nuk dërgon salavat mbi ju, salavat nuk ka dërguar

Ndërsa dashuria ndaj shokëve (sahabeve) të tij është dashuri ndaj tij dhe respekti ndaj tyre është respekt ndaj tij. Besimtari i sinqertë nuk ua vë veshin transmetimeve të pasakta të historianëve dhe transmetuesve të paditur. Për atë që ka ndodhur mes tyre (mosmarrëveshjet) mundohet të gjejë arsyen më të mirë dhe asnjërin

"Nuk beson asnjëri prej jush derisa mos t'i bëhem unë më i dashur se vetja, fëmijët, prindërit dhe të gjithë njerëzit."

prej tyre nuk e përmend me të keq, ngase Allahu i ka lavdëruar ata në shumë ajete. Ka thënë i Madhëruari: "*Muhamedi është i Dërguari i Allahut. E ata që janë me të janë të ashpër kundër jobsimtarëve ndër-sa të mëshirshëm ndërmjet vete.*" (El-Fet'h:29)

Ndërsa i Dërguari, paqja dhe beki mi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Mos flisni keq për shokët e mi, sepse po që se ndonjëri prej jush shpenzon sa është kodra e Uhudit në flori, nuk do ta arrijë vlerën e një grushti që kanë shpenzuar ata, madje as gjysmën e saj." (Muslimi)

#### **O ti që dashuron:**

Shpenzoje kohën tënde në përlujtje ndaj Zotit tënd, i cili e ka blerë shpirtin tënd në kompensim për xhenetin e Tij: "*Vërtetë Allahu ka blerë prej besimtarëve shpirtrat dhe pasuritë e tyre në kompensim për xhenetin.*"

Dhe mos e shpenzo jetën tënde përveç se në rrugën e Tij dhe bëhu i sinqertë me fjalën dhe veprën tënde derisa i citon fjalët: "*Vërtet namazi im dhe sakrificat ime, jeta dhe vdekja ime, janë për Allahun, Zotin e botëve, i Cili nuk ka rival.*"

#### **Vëlla i nderuar:**

Këto ishin disa nga simptomat e dashurisë ndaj të Dërguarit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. E lusim Allahun të na e dhurojë dashurinë e Tij dhe dashurinë e atyre që e duanë Atë, si dhe dashurinë ndaj çdo vepre që na afron tek dashuria e Tij, Ai dëgjon dhe përgjigjet.

# Identiteti musliman i shqiptarëve dhe Evropa

**Shkruan: Ismail BARDHOSHI**

**A**llahu i Lartësuar ka thënë: "Ai ka urdhëruar për ju të njëjtën fe, që ta shpalli ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musanë dhe Isanë; të besoni dhe të zbatoni gjithçka që përmban feja e Allahut (njësimin e Tij, besimin në të, bindjen ndaj të Dërguarve të Tij dhe pranimin e ligjeve të Tij) dhe të mos përçaheni në të. Për idhujtarët është e rëndë ajo, në të cilën po i fton ti (si teuhidi dhe braktisja e idhujtarisë). Allahu zgjedh për këtë fe kë të dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me pendim e nënshtrim.



Idhujtarët nuk u përçanë në fe, bindje e grupe të ndryshme, veçse pasi u erdhi dija, për shkak të zilisë egoiste ndërmjet tyre. Dhe sikur të mos kishte paraprirë fjala e Zotit tënd për shtyrjen e dënimit deri në një afat të caktuar, atyre do t'u përshpejtohej dënimi. Nuk ka dyshim se ata (jehuditë dhe kristianët) që trashëguan librin (Teuratin dhe Inxhilin) prej të parëve të tyre, dyshojnë thellë për të (për Kur'anin). Andaj, fto për tek Allahu, qëndro i paepur në Islamin e pastër, ashtu siç je urdhëruar, mos i ndiq dëshirat e tyre dhe thuaj: Unë besoj çdo libër që e ka shpallur Allahu dhe jam urdhëruar që të gjykoj drejt midis jush" [Esh- Shura: 13-15].

Një rast konkret është reagimi i zhurmshëm ndaj deklaratës së presidentit amerikan, në vigjilje të vizitës së tij në Tiranë që, shqiptarët janë muslimanë paqësore. Ndonëse ky është një pohim që i shërben strategjisë të politikave amerikane në botë, reagimi i protagonistëve të mediave nxori në pah qëllimet dhe orientimin e tyre.

"Vërtetë, kjo është feja juaj - fe e vetme (e cila është feja e të gjithë pejgamberëve), e Unë jam Zoti juaj, andaj më adhuroni vetëm Mua!" [El-Enbija: 92].

Nga këto ajete arrijmë në përfundimin se muslimanët si umet kanë identitetin e tyre, të cilin duhet ta mbrojnë, sepse, mungesa e identitetit shpie në mungesën e umetit, çka s'mund të jetë absolute, por relative. Me fjalë të tjera, aty ku muslimanët nuk tregohen vigjilentë për mbrojtjen e identitetit të tyre, pikërisht aty mund ta humbasin. Identiteti i muslimanit është feja e tij, e cila përfshin besimin, ibadetin, sjelljen,

rendin, festat etj. Muslimanët dallojnë në besimin e tyre; konceptin e tyre për Krijuesin dhe krijesat, në ritualet fetare, në rendin shoqëror etj. Burimi i identitetit të muslimani është Kur'ani dhe suneti. Zanafilla e këtij identiteti është që kur Allahu krijoi Ademin, i mori besën atij dhe pasardhësve të tij dhe e mëkëmbi në tokë për përmbushjen e fjalës së dhënë. Në thelb, identiteti i muslimanit shpreh respektimin e marrëveshjes së lidhur me Allahun. Mëkëmbja e njeriut në tokë dhe lidhja e marrëveshjes me të nënkupton se ai është më i rëndësishëm se toka dhe çka gjendet në të. Rrjedhimisht, vlerat njerëzore, si besimi në Allahun dhe në botën e përtejme, respekti ndaj prindërve, bamirësia ndaj fafesisit, mbrojtja e mendjes, nderit dhe dinjitetit të njeriut, janë më të rëndësishme se vlerat materialiste, mjetet e prodhimit, apo prodhimi etj. Pikërisht ky është dallimi midis rendit shoqëror Islam dhe rendit materialist dhe, padyshim, kjo bazë ideologjike ka dhënë efektin e saj në mënyrën se si mendon, jeton dhe vepron secila shoqëri. Rregulli që ka vënë Allahu për krijesat e tij është që bota materiale në tërësinë e saj t'i shërbejë vlerave shpirtërore të njeriut, ndërsa njeriu duhet të adhurojë vetëm Allahun. Respektimi i këtij rregulli sjell lumturi, drejtësi, qetësi, mirësi e begati të gjithanshme për njeriun. Ndërsa, mjerimi, padrejtësia, kaosi,

trazirat dhe korrupsioni vijnë si pasojë e nëpërkëmbjes së këtij rregulli.

Mungesa e dijes së vërtetë të bazuar të Kur'ani dhe suneti, përhapja e koncepteve të gabuara dhe bidateve, të dhënit pas dynjasë dhe plotësimit të dëshirave shkaktoi shpërbërjen e hilafetit osman, ku shqiptarët bënë pjesë dhe ishin të përfshirë në të gjithë strukturat drejtuese. Kjo solli si pasojë copëtimin e trojeve shqiptare, mënjanimin e ligjit të Sheriatit në mënyrë graduale, pushtimin e Kosovës dhe shumë viseve shqiptare nga Jugosllavia, spastrimin etnik të muslimanëve shqiptarë në Çamëri, vendosjen e regjimit totalitar komunist në Shqipëri, që kulmoi me mbylljen e fesë në '67 dhe shembjen e xhamive. Këto pasoja patën në mënyrë të

Ndonëse në Shqipëri komunistët ia dolën që të shkëpusnin shumicën e popullsisë nga besimi në Ditën e Gjykimit dhe t'i brumosnin në materializëm në sajë të diktaturës dhe propagandës materialiste antifetare, ata nuk arritën të shuanin ndjenjat e përkatësisë në botën Islame të shumica e tyre.

qenë e madhe, por edhe rezistenca e shqiptarëve për ruajtjen e tij nuk ka qenë e vogël. Ndonëse në Shqipëri komunistët ia dolën që të shkëpusnin shumicën e popullsisë nga besimi në Ditën e Gjykimit dhe t'i brumosnin në materializëm në sajë të diktaturës dhe propagandës materialiste antifetare, ata nuk arritën të shuanin ndjenjat e përkatësisë në botën Islame të shumica e tyre, nuk arritën të pengonin shumë njerëz nga besimi dhe

ushtrimi i riteve fetare, nuk arritën të rrënonin vlerat fetaro-shoqërore si martesat, familja, lidhjet farefisnore etj. Me të rënë regjimi totalitar, zgjimi për të njohur fenë Islame dhe për ta praktikuar atë filloi kudo, sidomos në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, ku gjendja paraqitet më e mirë. Megjithëse regjimi Jugosllav u përpoq, duke përdorur mjete e mënyra të ndryshme për ndryshimin e bindjeve Islame dhe gjuhës shqipe, rezistenca e muslimanëve bëri që përpjekjet e tyre të dështojnë. Në përgjithësi, shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë i ruajnë bindjet Islame dhe i respektojnë ritet fetare. Kjo rezistencë që Zoti i Lartësuar u mundësoi shqiptarëve me mirësinë e Tij, pa dyshim është domethënëse dhe përgëzuese. Ajo duhet të ngjallë interesin e predikuesve të fesë Islame dhe të mbarë muslimanëve për më shumë vigjilencë ndaj identitetit të tyre. Muslimanët duhet të përfitojnë nga përvoja e fituar përgjatë rezistencës në dekadat e kaluara dhe ta pasurojnë atë. Nuk është e logjikshme të mendojmë se beteja me keqdashësit e identitetit tonë ka përfunduar. Përkundrazi, tashmë duhet të jemi edhe më syhapur ndaj çfarëdolloj përpjekje që synon lëkundjen e bindjeve Islame dhe rrënimin e vlerave njerëzore. Nuk do të ishte e papranueshme nëse do të thuhej që idetë që u serviren shqiptarëve nëpërmjet mjeteve të informacionit, institucioneve dhe teksteve arsimore, organizimeve dhe tubimeve të ndryshme, janë të fokusuar në zhveshjen e tyre nga identiteti Islam. Një rast konkret është regjimi i zhurmshëm ndaj deklaratës

së presidentit amerikan, në vigjilje të vizitës së tij në Tiranë që, shqiptarët janë muslimanë paqësorë. Ndonëse ky është një pohim që i shërben strategjisë të politikave amerikane në botë, reagimi i protagonistëve të mediave nxori në pah qëllimet dhe orientimin e tyre.

Rajoni ynë është në fazën e disa ndryshimeve të rëndësishme dhe përcaktuese. Në dhjetë qershor në Tiranë u shpall pavarësia e Kosovës dhe së shpejti ajo bëhet e pavarur nga Serbia, qoftë edhe formalisht, pasi realisht ka vite që nuk është pjesë e Serbisë. Vendet e rajonit tonë aderojnë në shumë organizata ndërkombëtare dhe ka gjasa që për pak vite të bëhen pjesë e Natos dhe e Bashkimit Evropian. Nga njëra anë, pavarësia e Kosovës nga Serbia dhe integrimi i vendeve të rajonit në BE u krijon mundësinë shqiptarëve që të shkëputen disi nga ndikimi i Serbisë dhe i Greqisë dhe kjo padyshim është në interes të tyre. Por, nga ana tjetër dihet që unione të tilla krijohen për qëllime ideologjike dhe ekonomike. E thënë ndryshe në këtë kohë, kjo është gjetur si një mënyrë për të diktuar shtetet e fuqishme ekonomikisht e ushtarakisht vullnetin

Identiteti i muslimanit është feja e tij, e cila përfshin besimin, ibadetin, sjelljen, rendin, festat etj. Muslimanët dallojnë në besimin e tyre; konceptin e tyre për Krijuesin dhe krijesat, në ritualet fetare, në rendin shoqëror etj. Burimi i identitetit të muslimanit është Kur'ani dhe suneti.

e tyre ndaj të tjerëve, për të rritur potencialin e tyre ekonomik e ushtarak, për të përhapur idetë dhe kulturën e tyre dhe për të zgjeruar ndikimin e tyre në arenën ndërkombëtare. Kështu që integrimi në strukturat euroatlantike përbën sfidën e radhës që duhet të përballen me të muslimanët shqiptarë. Pasi rendi shoqëror perëndimor bazohet në ideologjinë materialiste: i kushton rëndësi botës së këtushme dhe jo botës tjetër; i kushton më shumë rëndësi vlerave materiale se sa vlerave njerëzore, çka sjellë si pasojë denatyrimin e njeriut. Më konkretisht, përmes sloganeve; liri, demokraci, barazi, emancipim të femrës, të drejtat e gruas dhe fëmijës, segmente të caktuar atje kanë arritur të shpërlajnë mendjet e njerëzve dhe të nxjerrin në krye të tyre ata që realizojnë qëllimet e tyre, të përhapin veset e ulëta si homoseksualizmi, lizbizmi, imoraliteti; të përdorin femrën për degradimin e shoqërisë duke lejuar lidhjet seksuale pa ndonjë kriter, të nxjerrin fëmijët jashtë kontrollit familjar, të shkatërronjë familjen, të ndërpresin lidhjet farefisnore etj. Kjo nuk do të thotë se ide të tilla nuk ekzistojnë në vendin tonë, nuk kanë përkrahje dhe mund të importohen vetëm pas bashkimit me shoqëri të tilla. Përkundrazi, ato janë ekzistuese, për shkak se i stimulon ideologjia materialiste që mbizotëron në mendjet e politikanëve, analistëve, gazetarëve, intelektualëve, arsimtarëve etj. Përveç kësaj, qindra mijëra shqiptarë jetojnë në BE, mijëra shqiptarë arsimohen atje, shumë organizata dhe shoqata perëndimore veprojnë në vendet tona. Por në kushtet e një

bashkimi tërësor dhe të gjithanshëm, këto ide mund të jenë më të pranishme, kështu që rreziku për humbjen e identitetit bëhet edhe më i madh. Nuk është e udhës të mendohet se beteja për ruajtjen e identitetit quhet e fituar me shpëputjen nga ndikimi i Beogradit ose i Athinës, pasi globalizmi, drejt së cilit vendet tona ecin me shpejtësi nuk njih dallime feje, kombësie, gjuhe, përkundrazi ai i shkrin të gjitha në një dogmë të vetme, e cila do t'i bëjë njerëzit shërbëtorë të protagonistëve të saj. Duhet të dihet që zakonisht shoqëritë e prapambetura priren për të imituar ato që kanë bërë progres material. Ndaj, e shikoj të rëndësishme të përmend disa pika që duhet të kihet parasysh:


- Ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit për sfidat ekzistuese dhe të pritshme.
- Vënia e objektivave të qarta për përballimin e tyre.
- Përpilimi, ose përkthimi i një sërë librash për rendin shoqëror në Islam dhe për vënien në dukje të të metave dhe pasojave të rendit materialist.
- Shfrytëzimi i mundësive dhe lirive që mund të na jepen për predikimin e fesë Islame.
- Bashkërendimi dhe bashkëveprimi ndërrajonal për ngritjen e institucioneve tona mediatike dhe arsimore për përhapjen e mendimit dhe kulturës Islame.
- Përfitimi nga përvoja që kanë muslimanët në perëndim në ruajtjen e identitetit të tyre Islam.

# LIGJET E PANDRYSHUESHME NË GJITHËSI

Dr. Kha'fer Shejh IDRIS

**T**ë mençurit e çdo kohe dhe vendi, besojnë se gjërat nuk ndodhin rastësisht, pa ndonjë shkak. Besojnë se shkaqet e njëjta kanë pasoja të njëjta në botën e natyrës, në shoqëri dhe në botën shpirtërore. Po të mos ekzistonte vijueshmëria e pasojave pas shkaqeve të tyre, nuk do të ekzistonin shkencat e saktë, shkencat shoqërore dhe ato që kanë të bëjnë me shpirtin. Njerëzit nuk do të mundnin të përfitonin nga studimi i historisë e as të merrnin mësim nga përvoja e të tjerëve, nuk do të dinin si të bashkëvepronin me natyrën dhe me njerëzit përreth tyre. Si mundet që diçka të shpiket prej asgjëse ose shkakut i njëjtë të ketë pasoja të ndryshme, kundërtë dhe përjashtuese, në kohëra dhe vende të ndryshme. Si mundet që uji, i cili deri dje shuante zjarrin sot të shkakton rritjen e flakës?

Megjithatë, besimi te rregulli s'i



mbron njerëzit nga gabimi i mundshëm në zbatimin e tij dhe as garanton lidhjen e shkaqeve me pasojat në mënyrë të saktë. Ndodh që njeriu pasojat e ndryshme t'i lidhë me shkaqet e gabuara, me qëllim të mashtrimit, gjë kjo, e cila shumë njerëz i le të habitur: disa e pranojnë të vërtetën (saktësinë e rregullit) në një kohë që, disa tjerë e mohojnë. Të mençurit s'mjaftohen vetëm me pranimin e saktësisë së rregullit, ata shikojnë edhe në pretendimet për lidhshmëri mes shkaqeve të caktuara dhe pasojave. Këto pretendime, a

Artikuj

kanë vallë argumente për saktësinë e lidhshmërisë së krijuar? Po të mos analizohej kjo lidhshmëri, njerëzit do të besonin te fallxhorë, magjistarë dhe sihirbazë, nuk do të bënin dallim mes Pejgamberit dhe atij që pretendon të jetë Pejgamber. Sinqeriteti nuk mbron nga gabimi. Ka mundësi që njeriu i sinqertë të mendojë gabimisht se pas ndonjë shkakut, detyrimisht të vijon një pasojë e caktuar. Një gjë e tillë ndodh edhe në shkencat me rregulla më të përpikta si Fizika dhe Kimia, e si të mos ndodh në shkenca si Sociologjia, Psikologjia dhe Mjekësia?!

Islami, si fe që u drejtohet të mençurve, përdor argumente që i pranon ajo kategori e njerëzve. Në disa raste, ai i fton të pranojnë pasojat, kurse në raste të tjetra ua përkujton shkakun që përfundon me pasojë të caktuar. Ua mëson shkaqet që nuk i kanë ditur, përgënjeshtrojnë lidhshmërinë e gabuar mes disa shkaqeve dhe disa pasojave, duke i fuqizuar dhe përforcuar shkaqet e vërteta për pasojat në fjalë. Ja disa shembuj:

"... Pra ata nuk janë duke pritur tjetër vetëm gjurmët e të parëve, e në ligjin e Allahut kurrë nuk do të hasësh devijim." (El Fatir, 43)

"Përpara jush kanë kaluar popuj ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet, ndaj udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni si qe përfundimi i atyre që përgënjeshtrojnë." (Ali Imran, 137)

"Po nëse hipokritët dhe ata që kanë zemra të sëmura, dhe ata që përhapin gënjeshtër në Medinë, nuk ndalen, Ne do të bëjmë që ti të dominosh mbi ta e pastaj ata nuk do të jenë fqinj me ty në të, vetëm një kohë të


"E ata që nuk dinë (kurejshitet politeistë) thanë: "Përse të mos na flasë neve Allahu, ose të na vijë ndonjë argument"! Po kështu, thëniet e tyre në mënyrë të njëjtë i patën përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemrat e tyre. Ne tanimë i sqaruar argumentet për një popull që dëshiron të bindet."

shkurtër. (Do të jenë) Të mallkuar, kudo që të ndeshen do të kapen dhe do të mbyten. (Ky është) Ligji i Allahut edhe ndër ata që ishin më parë, e në ligjin e Allahut nuk mund të gjesh ndryshim." (Al Ahzab, 60-62)

"Edhe sikur ata që nuk besuan t'ju luftonin juve, ata do të munden dhe do të kthejnë prapa, pastaj nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës. (ky është) Ligji i Allahut që është i kahershëm edhe ndër të parët, në ligjin e Allahut nuk do të gjesh ndryshime." (El Fet'h 22-23)

Ligjet, të cilët Kur'ani i quan si të pandryshueshme dhe konstante, do t'i përkufizojmë si ligje shoqërore, sepse ligjet e natyrës Kur'ani nuk i ka përshkruar me këtë cilësi (të pandryshueshme). Këto ligje ka mundësi të thyhen, ligji i gravitacionit ka mundësi të thyhet (të asgjësohet ndikimi i tij), zjarri, i cili ka cilësi djegëse, nuk e dogji Ibrahimin, alejhi selam, deti u nda në dy para Musait, alejhi selam, hëna u çua për gjysmë dhe pastaj u bashkua për





të Dërguarin më të zgjedhur Muhamedin, sal-lallahu alejhi ve sellem. Megjithatë duke pasur parasysh se këto fenomene ndodhin rrallë, edhe ligjet e natyrës mundet t'i konsiderojmë deri diku konstante. Thyerja e ndonjë ligji është ndryshim në atë që zakonisht ndodh dhe assesi nuk është thyerje e ligjit të shkakësisë<sup>1</sup> (kauzalitetit) sepse ndryshimi në ligjin ndodhin për shkak të ndërhyrjes së shkaqeve që njerëzit nuk i perceptojnë. Në këto shembuj s'është përmendur termi ligj (السنة), por është nënkuptuar me përmendjen e shkaqeve që rezultojnë me pasoja të njëjta:

"A jobsimtarët tuaj janë më të vlefshëm se ata që u përmendën, apo ju keni ndonjë kontratë në librat e qiellit?" (El Kamer, 43)

"Ata i goditën të këqijat që i kishin punuar. Edhe prej këtyre, ata që bënë zullum do t'i godasin të këqijat e veprave të tyre dhe nuk mund t'i shpëtojnë asaj (goditjeje)." (Ez Zomer, 51)

Allahu, subhanehu ve te'ala, gjithashtu na përkujton ligjin e përsëritjes së pasojave në rast të përsëritjes së shkaqeve; në disa raste na njofton me shkaqe që s'i kemi ditur:

"E ata që nuk dinë (kurejshitët

<sup>1</sup>Lidhje objektive, e domosdoshme ndërmjet shkakut e pasojës; tërësia e lidhjeve shkakësore. Shih Fjalori i Shqipësisë së Sotme.

politeistë) thanë: "Përse të mos na flasë neve Allahu, ose të na vijë ndonjë argument"! Po kështu, thëniet e tyre në mënyrë të njëjtë i patën përsëritur edhe ata që ishin para tyre. Të njëjta janë zemrat e tyre. Ne tanimë i sqaruar argumentet për një popull që dëshiron të bindet." (El Bekare, 118)

Në këtë ajet gjejmë argumentin e lidhshmërisë shkakësore mes fjalëve të shqiptuara dhe gjendjes së zemrës. Kur ekziston ngjashmëri mes zemrave, si pasojë kemi edhe ngjashmërinë mes fjalëve. I mëvonshmi këtë cilësi s'e ka trashëguar, detyrimisht, nga ata që jetonin më parë:

"Ja, ashtu pra, edhe atyre që ishin më parë nuk u dërguar e që nuk i thanë: Është magjistar ose është i çmendur! A mos e porositën njëri-tjetrin me këtë? Jo, por ata janë popull renegat." (Edh Dharijat, 52-53)

Siç shihet, ata s'e kanë porositur njëri-tjetrin me këtë fjalë, sepse s'janë takuar, fjalët që i thanë janë pasojë e mohimit dhe rebelimit që ishin në zemrat e tyre. Për shkak të lidhshmërisë shkakësore mes zemrës dhe fjalëve është e pamundshme që hipokriti (mynafiku) të fshehtë dyfytërsinë e tij.

"E sikur të kishim dashur Ne, do t'i tregonim ty se kush janë ata, e do t'i

Po të mos analizohet kjo lidhshmëri, njerëzit do të besonin te fallxhorë, magjistarë dhe sihirbazë, nuk do të bënin dallim mes Pejgamberit dhe atij që pretendon të jetë Pejgamber. Sinqeriteti nuk mbron nga gabimi. Ka mundësi që njeriu i sinqertë të mendojë gabimisht se pas ndonjë shkakut, detyrimisht të vijon një pasojë e caktuar.

njihje konkret, po me siguri do t'i njohësh përmes mënyrës së fjalës së tyre, e Allahu i di veprat tuaja." (Muhammed, 30)

Kur'ani na tregon se lidhshmëria mes brendësisë dhe asaj që shfaqet në dukuri është ligj i përgjithshëm:

"E sikur të kishin dëshiruar ata të dalin, do të bënin për të (për luftë) ndonjë përgatitje, por Allahu nuk e pëlqeu ngritjen e tyre, andaj i zbrapsi, dhe u është thënë: "Rrini me të paafit (fëmijët, gratë e pleqtë)." (Et Tevbe, 46)

Ky ajet është argument për lidhshmërinë e domosdoshme mes vullnetit dhe veprimit. Ai që pretendon të ketë vullnet

për ndonjë vepër dhe, në të njëjtën kohë, është i aftë ta bëjë atë, në tërësi ose një pjesë prej saj, dhe pastaj nuk e vë në zbatim, është gënjeshtar në pretendimin tij.

Imam Shatibiu na tregon për lidhshmërinë e domosdoshme mes njohjes së fesë së vërtetë dhe qëndrueshmërisë së ligjeve të gjithësisë. Po të mos ishin ligjet e gjithësisë të qëndrueshme nuk do të ishte e mundshme njohja e fesë, e cila argumentohet me muxhize (mrekulli), që thyejnë ligjet e natyrës. Po të mos ekzistonte diçka që vazhdimisht ndodh në formë të caktuar, nuk do të ishte e arsyeshme që veprat që nuk janë brenda kornizës së normales dhe të

zakonshmes, t'i quajmë mrekulli.

Thotë Imam Shatibiu: Qëndrueshmëria e legjislacionit Islam ngrihet mbi pandryshueshmërinë e ligjeve të gjithësisë. Dua të them: Po të ishin njerëzit dhe gjithësia rreth tyre, në ndryshim të vazhdueshëm, nuk do të mundej që jeta të rregullohet me legjislacion konstant që nuk ndryshon. Mos ndryshimi i ligjeve të sheriatit me ndërrimin e kohës dhe vendit është argument për natyrën konstante të njerëzve dhe gjithësisë, për të cilët është zbritur kjo tërësi e ligjeve, edhe pse ka disa dallime që nuk ndikojnë...<sup>2</sup>

Mbetet edhe një pyetje, me të cilën do të donim ta përfundonim shkrimin rreth ligjeve të përgjithshme të gjithësisë: çfarë është lidhshmëria mes këtyre shkaqeve dhe Krijuesit, subhanehu ve te'ala?

Rreth kësaj pyetjeje, njerëzit janë ndarë në dy ekstreme kundërtëne dhe në ata që e qëlluan të vërtetën. Njëra prej palëve ekstreme u ndalën tek kufijtë e shkaqeve dhe menduan se shkaqet ndikojnë nga vetvetiu, dhe nuk kanë nevojë për Krijues. Ky grup neglizhoi të vërtetën që shihej qartë para tyre. Ajo është: Në botë nuk ka shkak që ndikon individualisht; nuk ka gjë që quhet shkak dhe që ndikon pa u mbështetur në shkaqe dhe kushte të tjera. Atëherë si mundet që shkaku të ndikojë individualisht?

Disa të tjerë gabuan e menduan se pranimi i shkaqeve materiale ndeshet

me pranimin e Allahut për Krijues. Menduan se pranimi i shkaqeve për ndonjë gjë, përjashton ndikimin e Allahut. Për ligjet e gjithësisë që nuk ndryshohen ata thanë: Allahu krijon brenda tyre dhe jo nëpërmjet tyre. Nëse e sheh ndonjë letër që digjet në zjarr mos thuaj e dogji zjarri por thuaj e dogji Allahu atëherë kur letra u bashkua me zjarrin.

Ata që e qëlluan të vërtetën thanë: Allahu është krijuesi i shkaqeve që kanë pasoja në gjithësi, ndikimi i tyre nuk është provë se ato ndikojnë pavarësisht nga vullneti i krijuesit të tyre e as që ndikojnë në krijimin e tyre prej Allahut. Allahu si zakonisht krijon nëpërmjet shkaqeve siç shihet në shumë ndodhi natyrore:

"Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë që të kultivohen kopshte e drithëra që korren." (Kaf, 9)

"Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxori bimën e çdo sendi dhe prej bimës gjelbërim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj..." (El En'am, 99)

Shumë ajete në Kur'an përdorin terme që flasin për krijimin e Allahut, subhanehu ve te'ala, nëpërmjet lidhjeve shkakësore mes shkakut dhe pasojës dhe ky tekst nuk është vend për t'u zgjëruar në atë çështje.

Biseda jonë rreth kritereve të mençurisë nuk ka përfunduar.

**Përktheu: Talha Kurtishi**

<sup>2</sup> Shih librin e tij "El Muvafekat" ne pjesën e librit me titull "Kitabul Mekasid". Këto fjalë ai ia përkshkruan Imam Raziut, Allahu e mëshiroftë.



# Kujdesi i peygamberëve për udhëzimin e njerëzve

Prof. Dr. Nasir el-OMER

**K**ur i erdhën melekët Ibrahimit alejhi selam, për ta përgëzuar për lindjen e Is'hakut, menjëherë e lajmëruan se do ta shkatërrojnë vendin, banorët e të cilit ishin mizorë. Këtë edhe më mirë e kuptojmë duke i lexuar fjalët e Allahut i Lartësuar në suren Ankebut, kur thotë:

"E kur të dërguarit tanë (engjëjt) i erdhën me lajmërim Ibrahimit, i thanë: "Ne jemi shkatërrues të banorëve të këtij qyteti, pse banorët e tij janë mizorë!"

Ai (Ibrahimi) tha: "Aty është Luti!" Ata i thanë: "Ne e dimë edhe më mirë se kush është aty, atë dhe familjen e tij do ta

shpëtojmë përveç gruas së tij, ajo do të mbetet me të zhdukurit". Ankebut 31,32.

Ibrahimi alejhi selam, deshi ta kohëzotë misionin e tij me shpresë se ai popull do të udhëzohet në rrugë të drejtë. Pra, ky ishte interesi i përgjithshëm, të cilin e kanë synuar të gjithë të dërguarit e Allahut: ta krijojnë personalitetin e njeriut në dobi të tjerëve, pa marrë parasysh nëse kishin apo jo me ta lidhje farefisnore.

Ibrahimi alejhi selam, ishte i informuar mirë se për çfarë qëllimi ishin dërguar peygamberët. Gjithashtu, e dinte mirë se

ata ishin njerëz fisnikë të Allahut, të cilët nuk bënin përpos se atë çka u kishte urdhëruar Allahu. Ai ishte i bindur se Allahu i ka dërguar ata dhe nuk ka hapësirë polemizimi apo kundërvënije ndaj caktimit të Allahut. Por, ai ishte ambicioz dhe kishte dëshirë që të shfrytëzonte momentin për të fituar shpërblimin. Ngase Allahu, duke i marrë parasysh shkaqet, ndonjëherë e anulon caktimin dhe urtësinë e atij anulimi e njeh vetëm Ai.

Po ashtu, kur i erdhi meleku i vdekjes t'i marrë shpirtin Musait alejhi selam, ai i mëshoi me grusht dhe ia verbëroi syrin, pastaj meleku u kthye tek Allahu i Lartësuar. Po ashtu Allahu i Lartësuar pat urdhëruar që edhe populli i Junusit alejhi selam, ta pësojë dënimin. Mirëpo, kur besuan, Allahu i shpëtoi siç e ka përmendur në Kur'anin famëlartë:

"Përse nuk pati ndonjë qytet, banorët e të cilit të besonin e t'u bënte dobi besimi i tyre, përveç popullit të Junusit? Kur ata besuan, Ne ua larguam dënimin e poshtërimin në jetën e kësaj bote dhe i lamë të kënaqeshin edhe njëfarë kohe". Junus 98.

Gjithashtu, kemi rastin kur Allahu i pat urdhëruar melekët që ta dënonin popullin e Lutit alejhi selam, por, Ibrahim alejhi selam, s'deshi që ai popull të dënohej. Kjo nuk bie në kundërshti me asnjë dispozitë të shariatit; sipas këtyre dispozitave, nuk është e ndaluar të prolongohet koha e zbatimit të dënimit, me shpresë se ai popull do të udhëzohet dhe do ta besojë Allahun. Ndërsa, vonimi mund të

Të shumtë janë të dërguarit që u ballafaquan me probleme të tilla. Por ata përsëritnin pandërprerë të njëjtën fjalë: "O populli im" vetëm e vetëm që të zbuten zemrat e tyre, të cilat ishin forcuar si gur dhe të ktheheshin kah e vërteta.

bëhet shkak i udhëzimit të tyre, ashtu siç veproi Musai alejhi selam, me Muhamedin alejhi selam, natën e Mi'raxhit për çështjen e namazit.

Ibrahimi alejhi selam, në këtë rast u përpoq të vinte në lëvizje vigjilencën dhe seriozitetin e tij duke thënë: "Aty është Luti". Ai nuk iu tha melekëve mos e dënoni këtë popull se ndoshta ata do të besojnë por u bëri me dije se aty është i dërguari i Allahut, d.m.th mos i

dënoni derisa të jetë aty i pranishëm i dërguari i Allahut. Por, caktimi Allahut i mbuloi të gjitha dhe ishte i shkruar në levhi mahfudh se ata do të shkatërrohen. Ishin ngritur lapsat dhe ishin tharë fletushkat, e përgjigja ishte: (engjëjt i thanë) O Ibrahim lëre këtë (dialog), urdhri i Zotit tënd tashmë ka zbritur, s'ka tjetër, ata do të përjetojnë dënim të pashmangshëm. Hud 6.

Pas këtij dialogu Ibrahimit alejhi selam, iu bë e qartë kjo gjë, dhe prej këtij momenti nuk kishte dialog apo kundërshtim në këtë çështje.

Këtë interesim të madh për udhëzimin e njerëzimit e kishin edhe pejgamberët tjerë, edhe pse njerëzit iu kundërviheshin dhe u shpallnin luftë, ata e pranonin me zemërgjerësi dhe nuk mendonin t'i u kundërviheshin në atë mënyrë.

Allahu i Lartësuar na ka treguar për Hudin alejhi selam, ku thotë: "Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin, e ai tha: "O populli im, adhurojeni (një Zot) Allahun, ju nuk keni zot pos Tij, a nuk po frikësoheni?!" Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: "Ne po të

shohim mendjelehtë dhe të konsiderojmë vërtet rrenacak!" Tha (Hudi): "O populli im, nuk jam mendjelehtë, por unë jam i dërguar prej Zotit të botëve". (Jam i dërguar) Që t'u komunikoj shpalljet e Zotit tim dhe unë jam këshillues besnik për ju". Hud 65-68 .

Po ashtu Muhamedit alejhi selam, i thoshin: "Dhe ata thanë: "O ti që t'u shpall përkujtimi (Kur'ani), me të vërtetë ti je i çmendur! Hixhr 6. Kurse të dërguarit tjetër i thoshin: Ai nuk është tjetër përpos se një njeri i sëmure mentalisht, andaj pritni (keni durim) edhe për një kohë. Mu'minun 25. Të shumtë janë të dërguarit që u ballafaquan me probleme të tilla. Por ata përsëritnin pandërprerë të njëjtën fjalë: "O populli im" vetëm e vetëm që të zbuten zemrat e tyre, të cilat ishin forcuar si gur dhe të ktheheshin kah e vërteta.

Pastaj Allahu i Lartësuar për Muhamedin alejhi selam, thotë: "Ju erdhi i dërguar nga mesi juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja. I brengosur për besimtarët, i butë dhe i mëshirshëm". et-Teube 108.

Në ajetin tjetër thotë: "A thua ti, do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kur'anit)? Kehf 6. Ndërsa në një ajet tjetër thotë: "Andaj ti (Muhamed) mos shkatërro veten me dëshpërim për ta, Allahu e di shumë mirë atë që bëjnë ata". Fatir 8.

Kurse në suren En'am thotë: "Të kishte dashur Allahu i kishte tubuar në rrugë të drejtë; po ti mos u bëj nga të padijshmit

(dhe mos u brengos)." En'am 35.

Në ajetin tjetër thotë : "A mos do të vrasësh veten (Muhamed) pse ata nuk bëhen besimtarë?!" es-Shuara'e 3 .

E megjithatë, të dërguarit e Allahut e dinin se detyrë e tyre ishte vetëm interpretimi, siç e ka përmendur Allahu i Lartësuar në Kur'anin famëlartë, ku thotë: "Dhe nuk jemi të obliguar për tjetër, përveç t'ju kumtojmë ashtu qartë". Jasin 17.

Në ajetin tjetër thotë: "O ti, i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën-risalen). Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve)". El-Maide 67.

Si dhe ajeti tjetër: "E ti thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë. El-Kehf 29. Mirëpo, ata prapë se prapë fokusoheshin në atë se ata janë udhëzuesit e popullit dhe duhet që t'i udhëzojnë kah e mira dhe realiteti dhe vetëm për atë synim punonin.

Kjo vlen edhe për ne, që ta trashëgojmë rrugën e tyre në këtë sferë, që t'i udhëzojmë njerëzit dhe t'u drejtohem me optimizëm që ata të pranojnë. E nëse e udhëzon një njeri në rrugë të drejtë, ndihesh më mirë sesa kur të jepen devetë e kuqe (devetë e kuqe janë të përmendura dhe kanë vlerë të veçantë tek arabët; ai që ka këtë lloj deveje, konsiderohet nga të tjerët si pasanik).

**Përktheu: Enver Azizi**

Këtë interesim të madh për udhëzimin e njerëzimit e kishin edhe pejgamberët tjerë, edhe pse njerëzit iu kundërviheshin dhe u shpallnin luftë, ata e pranonin me zemërgjerësi dhe nuk mendonin t'i u kundërviheshin në atë mënyrë.

# Kujto këto gjëra gjatë marrjes së pagës

**K**ur vjen koha për të marrë rrogën, më vijnë ndër mend disa gjëra, të cilat mendoj se janë të rëndësishme:

1- Rroga është e plotë, vallë është edhe puna gjithashtu e plotë? A nuk ka pasur mangësi dhe defekte? Si ta laj përgjegjësinë time, sepse ai që merr pagë, llogaritet para Allahut për punën e tij?

2- A i jam lutur Allahut të ma bëjë të bërëqetshme këtë rrogë, apo jam mjaftuar vetëm me buzëqeshjen dhe rehatinë e brendshme?

3- A kam falënderuar Allahun për këtë begati që më ka dhënë, në kohë kur shumë të tjerë janë të privuar nga kjo gjë?

4- A kam menduar të ndaj sadaka nga kjo rrogë dhe të ushqej ndonjë të varfër?

5- A kam menduar për ata borxhlinj, për të cilët kam marrë përsipër përgjegjësinë për t'ua larë borxhet para se ato t'u rriten dhe para se t'u vijë exheli. Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, nuk dëshiroi t'ia falë namazin e xhenazes atij njeriu që i kishin mbetur borxhe përderisa një as'hab nuk e mori përsipër larjen e borxhit të tij.

6- A kam mundësuar me këtë rrogë lumturi te prindërit, gruaja dhe fëmijët edhe me diç të vogël?

7- Po ti, a i ke menduar detyrat dhe obligimet tjera, të cilat nuk mund të



realizohen ndryshe përpos se me pasuri?

8- A ke menduar të ndihmosh organizata humanitare a të marrësh përsipër kujdesin për ndonjë jetim përmes një kontributi mujor?

9- A ke menduar të largohesh nga israfi (harxhimi i tepërt) në ushqim, pije, veshmbathje dhe gjërat shtesë?

10- A ke menduar që tërë këtë rrogë ta harxhosh në hallall dhe të largohesh nga harami dhe gjërat e dyshimta?

11- A ke menduar për të hartuar plane të studiuara dhe strategji precize për harxhimin e kësaj rroge në mënyrë të matur dhe të drejtë, jo me kaotizëm dhe menaxhim të keq?

Vëllai im! Mendo mirë këto gjëra kur ta marrësh rrogën, sepse i ke amanet për të cilat do të japësh llogari, andaj bëje gati përgjigjen e saktë të kësaj pyetje. Kam shumë shpresë se nuk do të mungojnë këto gjëra nga mendja jote, jo tani, por para se ta marrësh rrogën. Allahu të dhëntë suksese në jetë dhe bërëqet në pasurinë tënde.

**Përshtati: Bekir Halimi**



# Konflikti ideologjik mes të vërtetës dhe të pavërtetës (3/3)

**S**i rrjedhojë e dredhivë që përdornin, armiqtë e fesë shpesh shkaktonin fitne, ndiznin zjarrin e përçarjes, thellonin mospajtime midis muslimanëve, ngjallnin krenarinë për hir të prejardhjes dhe nxirrnin fjalë të shërbetosura për nacionalizmin.

Si rrjedhojë e dredhivë që përdornin kundër muslimanëve dhe Islamit, ishte nxjerrja e haditheve të trilluara, të sajuara, të cilat u përhapën si përralla nga çifutët dhe të tjerët në përgjithësi.

Enver el-Xhundi thotë: "Pjesa dërmuese e studiuësve mbështesin mendimin se shumica e haditheve të trilluara janë të bëra me qëllim, planifikim, armiçësi dhe dredhi. Ky është një faktor i rëndësishëm në konflikte ideologjike. Me këtë mjet u vërsulën fillimisht çifutët, e pastaj edhe



ekstremistët e grupimeve tjera të sajua. Të gjitha këto i përdornin me të gjitha metodat e punës fshehurazi, vazhdimësisë në të dhe maskimit, me qëllim të copëtimit të bashkimit dhe unitetit të muslimanëve, lajthitjen e tyre nga feja e drejtë dhe shkapërderdhjen nga rruga e vërtetë.

Disa studiues, këtë dukuri nuk e përshkruajnë ndryshe, përpos se si luftë reale kundër Librit të Allahut. Ata dëshirojnë që çdokush që lexon komentimin e drejtë të fjalëve të Allahut, ta braktisë atë lexim e të fillojë dëgjimin e përrallave, çudirave dhe tregimeve, me të cilat mashtrohen shumë njerëz të thjeshtë. E kur të nguliten thellë këto përralla në ata shpirtra, atëherë doemos do të kundërshtojnë thirrjen për të menduar shëndoshë".<sup>1</sup>

Nga ky lloj mashtrimi është edhe përkthimi i librave të filozofisë, librave të feve të shtrembëruara dhe politeiste, si dhe përkthimi i librave të etikës nga ata. B. Tejmije, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "...Allahu nga drita e peygamberisë nxori një diell, i cili mori dritën e të gjitha yjeve. Në atë dritë jetuan ato gjenerata për një kohë të caktuar e pastaj u fsheh një pjesë e asaj drite të peygamberisë. Gjatë pushtetit të abasidëve, u përkthyen disa libra të huaj, të filozofëve romakë, persianë dhe indianë. Në kohën e Me'munit u kërkuan të gjitha librat e tyre nga shteti romak dhe u përkthyen.

Njerëzit filluan të mësojnë nga ato libra dhe si rezultat, u përhapën ato bidate që u përhapën".<sup>2</sup>

Një pjesë e studiuesve bashkëkohorë përkrahin mendimin se përkthimi i filozofisë greke ishte një ndër faktorët e dobësimit të shtetit Islam dhe disfatës ushtarake përballë armiqve të fesë. Njëri nga ata thotë: "Unë dua të shtoj - si lexues dhe specialist në filozofinë Islame<sup>3</sup> - se përkthimi i filozofisë greke, e cila arriti të pushtojë kulmin e udhëheqësve në kohën e Me'munit<sup>4</sup>, është një ndër faktorët e disfatës kulturore, madje, edhe të disfatës ushtarake".

Kjo ndërlidhje midis përkthimit të filozofisë dhe disfatës kulturore e ushtarake është një realitet për të cilin nuk ka dyshim. Këtë e themi sepse jemi të bindur se sekreti i triumfit dhe përforcimit të Islamit në tokë ishte të përmbajturit në fenë e pastër dhe ndjenja e mospasjes nevojë për kulturat e padijes. Pastaj, pas atij përkthimi ndodhën edhe gjëra tjera - në të cilat aludoi B. Tejmije - sikurse bidatet<sup>5</sup>, që në garniturë me të vijnë edhe mospajtimi, përçarja dhe humbja e fuqisë. Kështu, u dobësua shkaku me të cilin triumfonin muslimanët dhe kjo ishte nga shkaqet më kryesore për të pësuar ushtarakisht.

Po ashtu, pranimi i këtyre filozofive dhe përdorimi i tyre për të shtjelluar çështjet e besimit ishte dëshmi se ato filozofi janë të shëndosha. Ky fakt, e rriste

<sup>1</sup> El-Islam ued daavatul heddame, Enver el-Xhundi, fq. 236

<sup>2</sup> Mexhmuul Fetava 2/84

<sup>3</sup> Shprehja e tij "filozofi Islame" nuk është e shëndoshë, sepse në Islam nuk ka filozofi, Islami është fe e zbritur dhe shpallje nga Allahu dhe që është e qartë plotësisht, ndërsa filozofia është lëmi për të cilën nuk ka nevojë askush përpos atyre që dëshirojnë komplikime, kontradikta dhe të ngjashme. Shprehja e shëndoshë do të ishte: "filozofia që i përshkruhet Islamit".

<sup>4</sup> Me'muni është një ndër halifët e shtetit abasit. Ai është Abdullah Me'muni biri i Harun Reshidit. U bë halif ps vrasjes së vëllait të tij Eminit në vitin 198 H. Në fund të qeverisjes së tij, ndezi kallën e pretendimit se Kur'ani është i krijuar. Ai vdiq në vitin 218 nga Hixhreti.

<sup>5</sup> Bidat gjuhësisht d.m.th. risi, ndërsa qëllimi është: shpikja e risive në çështjet e fesë, duke shtuar gjëra që nuk janë nga feja dhe duke i konsideruar ato si pjesë të Islamit. (sh.p.)

edhe më tepër çështjen e asaj filozofie dhe, ndërkohë, jepte të kuptohet se muslimanët kanë nevojë dhe janë të varfër për filozofi. Kjo ishte një disfatë kulturore, edhe pse Islami nuk ka aspak nevojë për atë lëmi. Nuk kanë nevojë për të dhe as për ndonjë tjetër lëmi për ta njohur fenë.

Sikur të ndalonin këto lëmi logjike në shpjegimin e kërkesave materiale, në industri, mjekësi etj., kjo do të ishte shumë e qëlluar.

Ndërsa pretendimi se ato lëmi janë metodë për njohjen e besimit dhe moralit është gabim i madh dhe shkak prej shkaqeve të dobësimit dhe pësimit të muslimanëve. Madje, disa publicistë perëndimorë përkrahin edhe mendimin se zhytja e filozofisë greke në këto çështje (besim, moral) ka qenë shkak për ngecjen e zhvillimit të vetë grekëve. Njëri nga ata thotë: "Filozofia, e cila zhytet në çështjet pasnatyrës dhe në çështjet e moralit, do të ketë pasoja, njëllloj siç e pengoi përparimin e zhvillimit të vjetër grek".<sup>6</sup>

Dredhite e ziliqarëve nuk ndaluan deri aty, ata bënë edhe një sulm kundër të

gjitha themeleve dhe parimeve Islame. Dëshiruan shkatërrimin e çështjeve të besimit, braktisjen e ligjeve fetare dhe çdo gjë që ishte në të mirën e Islamit.

Në pjesën e fundit të gjeneratës së sahabëve, u shfaq kundërshtimi i kaderive në çështjen e kaderit. Këtë mësim, Ma'bed el-Xhuheni<sup>7</sup> e mori nga i krishteri Susin<sup>8</sup>, i cili u shtir se është musliman e pastaj prapë u bë i krishterë. Nga Ma'bedi këtë mësim e trashëgoi Gajlan ed-Dimeshki<sup>9</sup> dhe Xha'd b. Dirhem<sup>10</sup>.

Pas tyre erdhi Xhehëm b. Safuan<sup>11</sup>, i cili fryu te disa njerëz idetë e shtrembëruara, të cilat relativisht, i përqaftuan shumë grupe që thirren se janë muslimanë.

Ai përhap idenë se krijesat nuk kanë mundësi zgjedhjeje (xhebër), se Allahu nuk është i cilësuar me cilësi përkatëse, përhap idenë e irxhasë<sup>12</sup>, duke thënë se iman (besim) është vetëm njohja e Allahut, ndërsa kufër (mosbesim) është mosnjohja e Allahut. Ai thoshte se Kur'ani është i krijuar<sup>13</sup>, si dhe shumë fjalë tjera të ndyta, që kanë shkaktuar polemika dhe përçarje, kanë rezultuar në spica dhe kalla brenda muslimanëve.

Pas tyre u përhap sekti i mu'tezilive

<sup>6</sup> Kissatul Hadare, Vol Devrant 7/194

<sup>7</sup> Ai quhet Ma'bed b. Abdullah el-Xhuheni, jetoi në Basra dhe është i pari që në kohën e sahabëve mohoi kaderin. Ky vdiq në vitin 90 H.

<sup>8</sup> Ky ishte një krishterë që shfaqoi Islamin dhe e përhapoi në mesin e muslimanëve mohimin e kaderit, e pastaj sërish u kthye në krishterizëm.

<sup>9</sup> Ai quhet Gajlan b. Muslim ed-Dimeshki. Është prej të parit që mohuan kaderin. Me të, debatoi dijetari el-Evzai por ky nuk e ndërroi mendimin e kotë, andaj el-Evzai dha fetva që të vritet ky person dhe kështu, Hisham b. Abdulmeliku dha urdhër që të vritet dhe u vra.

<sup>10</sup> Xha'd b. Dirhemi është i pari që shpiku mohimin se Allahu e ka mik (halil) Ibrahimin, alejhi selam, dhe mohimin se Allahu i ka folur Musait, alejhi selam. Prej tij, këtë mësim e mori Xhehëm b. Safuani, mësuesi i xhehmive. Xha'din e vrau udhëheqësi i Irakut, Halid b. Abdullah el-Kasri në vitin 124 H. Është nxënësi i Xha'd b. Dirhemit dhe është i pari, i cili publikisht pretendonte se Kur'ani është i krijuar dhe mohonte cilësitë e Allahut të Lartësuar. Imami i matur, Dhehebiu, për këtë njeri thotë: "I humburi, bidatxhiu dhe koka e xhehmive. Ngordhi kah fundi i gjeneratës së tabiinëve, nuk di të ketë transmetuar diç të mirë, por e di se ka mbjell sherr të madh". Krahas këtyre mendimeve, ai kapte

edhe armën dhe luftonte kundër udhëheqësit.

<sup>12</sup> "Irxha" gjuhësisht d.m.th. vonim. Këtu është për qëllim ndarja e veprës nga imani (besimi). Kjo ide pretendon se veprat e mira, qofshin fjalë apo vepra nuk bëjnë pjesë në të emërtuarën IMAN. Rezultati i këtij pretendimi është se imani nuk shtohet e as pakësohet. Përqaftuesit e "irxhasë" quhen murxhie, ata vetë janë shumë grupe. Prej tyre janë edhe xhehmitë, të cilët thonë se iman është vetëm njohja e Allahut, të tjerë thonë: iman është vetëm besimi me zemër, sikur bëjnë esh'arite, të tretët thonë: iman është vetëm shqiptimi me gojë, sikur bëjnë keramitë, po ashtu ka prej tyre të cilët thonë: iman është besimi me zemër dhe shqiptimi me gojë.

<sup>13</sup> Pretendimi se Kur'ani është i krijuar është besim i kotë. Xhehmitë janë protagonistët e këtij besimi, por këtë e përqaftuan edhe mu'tezilitë, dhe njashu ky është edhe besimi i esh'arive dhe maturidive. Ky besim vjen si rezultat i mohimit të cilësive të Allahut të madhëruar, gjeqjesisht mohimit se Allahu flet. Ndërsa, besimi në të cilin aludon Kur'an dhe që e kanë besuar gjenerata e para është: Allahu flet realisht me fjalë që fillojnë nga Ai, me shkronja dhe zë, të cilat dëgjohej kur do Ai dhe si do Ai. Pra, Kur'ani është fjalë e Allahut, e zbritur dhe jo e krijuar. Argumentet për këtë janë të shumta dhe dijetarët i kanë përmendur gjerësisht nëpër librat e sunetit, besimit dhe teuhidit.

nëpërmjet Vasil b. Ataut<sup>14</sup> dhe Amër b. Ubejdit, të cilët ishin të ndikuar nga mendimet e xehemive. Fillimisht, dëshironin kundërshtimin e xehemive, por nuk përdornin metodën e drejtë, ashtu edhe këta përqafuan disa mendime të tyre, siç janë: pretendimi se Kur'ani është i krijuar, mohimi i cilësive të Allahut etj, kështu që morën një pjesë mjaft të madhe nga xehemitë.

Më pas, u shfaqën maturiditë<sup>15</sup> dhe esh'arijtë<sup>16</sup>, të cilët pretendonin se janë mesatar midis metodologjisë së pasuesve të gjeneratave të para dhe mu'tezilive. Kështu që, me mu'tezilitë dhe xehemitë u pajtuan në disa çështje, por edhe me pasuesit e sunetit në disa çështje, por, morën një pjesë mjaft të madhe nga xehemitë.

Këto sekte përvetësuan - njëlloj si shiat dhe sufijetë - te'vilin (ndryshimin e kuptimit) për të shfuqizuar aludimet e teksteve të shpallura.

Ibnul Kajjim, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Pika e njëzet e pestë: Emërtimi i katër tagutëve nëpërmjet të cilëve, përdoruesit e te'vilit të gabuar shkatërruan fortesat e kësaj feje, e nëpërkëmbën shenjtërinë e Kur'anit dhe i eliminuan shenjat e imanit. Këto tagutë janë:

- mendimi i tyre se: fjala e Allahut dhe

Si rrjedhojë e dredhive që përdornin, armiqtë e fesë shpesh shkaktonin fitne, ndiznin zjarrin e përçarjes, thellonin mospajtime midis muslimanëve, ngjallnin krenarinë për hir të prejardhjes dhe nxirrnin fjalë të shërbetosura për nacionalizmin.

Si rrjedhojë e dredhive që përdornin kundër muslimanëve dhe Islamit, ishte nxjerrja e haditheve të trilluara, të sajuara, të cilat u përhapën si përralla nga çifutët dhe të tjerët në përgjithësi.

fjala e të Dërguarit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, janë argumente që nuk aludojnë në dije dhe prej tyre nuk mund të arrihet bindje.

- mendimi i tyre se: ajetet dhe hadithet që flasin për cilësitë e Allahut janë alegori dhe jo reale.

- mendimi i tyre se: lajmet dhe të dhënat që ka përcjellë Muhamedi salallahu alejhi ue selem, të cilat i kanë transmetuar njerëz të drejtë dhe besimtarët i kanë pranuar me zemërgjerësi, nuk aludojnë në dije. Më e madhja që përfitohet prej atyre fjalëve janë supozime.

- dhe mendimi i tyre: kur të bie ndesh logjika dhe argumentet e Shpalljes, ne pranojmë logjikën dhe nuk ia vëmë veshin Shpalljes.

Këto katër tagutë<sup>17</sup> të cilët i shkaktuan Islamit atë që i shkaktuan, të cilët i eliminuan shenjat e tij, i anuluan simbollet e tij, i shkatërruan themelet e tij, rrëzuan shenjtërinë e argumenteve nga zemrat dhe pasuan metodologjinë e akuzës, çdoherë, kur dikush iu argumenton atyre me argument nga Kur'ani dhe suneti, ata me nxitim kthehen te njëri nga këta tagutë, kapen për të dhe e përdorin si mburojë për të penguar nga rruga e Allahut.

Allahu me fuqinë e Tij, me mirësinë

<sup>14</sup>Vasili është i pari që përhap mendimi se kush bën mëkate të mëdha është mes xhenetit dhe xehenemit, po ashtu është njëri ndër mësuesit e mu'tezilive.

<sup>15</sup> Maturiditë janë pasuesit e Ebu Mensur Muhamed b. Mahmud el-Maturidi es-Semakandi (vdiq në 333 H). Nga bidatet e tyre janë: irxhaja, mohimi i disa cilësive të Allahut etj.

<sup>16</sup> Esh'arijtë janë pasuesit e Ebul Hasen b. Ismail el-Esh'ari, por pasi u largua nga mendimet e mu'tezilive dhe i përqafoi ato të kula-bijve. Në çështjen e imanit këta janë murxhie, mohues të disa cilësive po ashtu, në çështjen e kaderit janë xhebrij dhe kanë po ashtu bidate tjera.

<sup>17</sup>Tagut quhet çdo gjë që adhurohet pos Allahut, dhe ai i adhuroar është i kënaqur me të. (sh.p.)

dhe nderin e Tij i theu këta tagutë një nga një, nëpërmjet zëvendësve dhe trashëgimtarëve të pejgamberëve. Nuk kanë ndaluar ndihmësit e kësaj feje së qortuari këta njerëz anekënd botës, duke i gjuajtur me meteorët e Shpalljes dhe me argumentet e logjikës së shëndoshë".<sup>18</sup>

Me kalimin e kohës, këto sekte u ndanë edhe brenda për brenda, u shtuan ndarjet dhe shtrembërimet dhe ashtu u futën brenda shoqërisë Islame dhe fituan shumë pasues. Gjërat që i ndihmuan ishin:

1. Besimi i dobët dhe padituria e madhe, sepse imani i ngulitur fort, i ndërtuar mbi njësimin e pastër të Allahut dhe mbi diturinë e mbështetur në Kur'an dhe sunet është mburojë shumë e fortë, me të cilën Allahu i mbron besimtarët nga ideologjitë prishëse dhe të gjitha fitnet në përgjithësi.

2. Përhapësit e këtyre ideve shfaqeshin para njerëzve si asketë, të devotshëm, të emocionuar në fe, pretendonin se kujdesen shumë për Islam dhe merrnin përsipër shumë vështirësi dhe sakrifica. Gjëra të cilat, shumë njerëz i shtynë të mashtrohen dhe të bien në kurthet e tyre.

3. Pranimi i këtyre ideve nga disa njerëz to njohur me dije, të cilët i lëvdonin lëmit dhe përrallat e filozofëve.

4. Toleranca e disa udhëheqësve, kryetarëve dhe emirëve ndaj ephorëve dhe bidatxhive dhe jo vendosmëria në kundërshtimin e tyre. Madje, kishte të atillë që ndihmonin ato ide dhe i përhapnin me forcë.

5. Mbisundimi i disa udhëheqësve, të cilit ishin pjesëtarë të atyre sekteve, në disa vende të muslimanëve.

Këto faktorë - dhe të tjerë - ishin zbrazëtira nëpërmjet të cilave u futën

ideologjitë shkatërruese në shoqërinë Islame. Porsa hynë, gjetën veshë që i dëgjonin dhe zemra të hapura për ta. Kështu që, këto ide vluan dhe u përhapën kudo, njëlloj si zjarri në bar të thatë dhe shumë zemra e kapërdinë këtë fitne.

Por, Allahu bëri që te një pjesë e njerëzve të mbetet e vërteta; këta njerëz u kapën pas të vërtetës dhe braktisën trillet. Me tërë mundin çuan në vend këshillën për Allahun, të Dërguarin, udhëheqësit e muslimanëve e njerëzve në përgjithësi. Porse, edhe shtrembëta mori hov, bëri që patjetër të jetë e pranishme dhe mbisundoi shoqërinë. Por "Allahu ka kontroll dhe fuqi të plotë mbi çështjet e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë". (Jusuf 21) "Kur Allahu dëshiron ta lërë dikë në humbje, ti nuk mund të bësh asgjë për ta penguar Atë". (Maide 41).

Rreziku i ideologjive shkatërruese e sekteve të humbura vazhdoi të shtohet me kalimin e kohës. Qeverisja e mbisundimi i tyre i përfshiu muslimanët, derisa arriti kohën moderne, ndërsa padituria e lajthitja kanë kapluar besimin dhe ligjet fetare te muslimanët. Bidati gdhiu sunet, ndërsa suneti bidat. Kjo është bërë normale dhe njerëzit e mbrojnë këtë dhe braktisin çdo gjë tjetër edhe nëse ajo është e vërteta që buron nga Kur'ani.

Andaj, nuk është çudi - në këtë gjendje - të jenë të mbisunduar nga të krishterët apo nga çifutët, të cilët kolonizuan shumë vende të muslimanëve dhe prej aty filluan një luftë të re, Konfliktin Ideologjik terrorizues, me qëllim të shkuljes së Islamit nga rrënjët.

"Ata bëjnë kurthe, por edhe Allahu bën kurthe kundër tyre. Allahu është planifikuesi më i mirë". (Enfal 30).<sup>19</sup>

<sup>18</sup>Es-sauaik elmunezzele ale taifetil xhehmije uel muattile, nga Ibnul Kajjim 2/379,380. Botimi i Universiteti Islamik në Medinë.

<sup>19</sup>Tani erdhi koha të bisedojmë për konfliktin ideologjik bashkëkohor, por këtë do ta bëjmë në ndonjë zinxhir tjetër të shkrimeve në Albislam.

# A duhet të ngrihen duart gjatë tekbireve në namaz

Shkruan: **Alaudn ABAZI**

**E**kziston një polemikë e gjerë ndërmjet juristëve islamë (fukahave), si në kohët e hershme, por edhe tani, rreth çështjes së ngritjes së duarve gjatë tekbireve në namaz. Ky është edhe shkaku se pse reflektohet kjo polemikë edhe në praktikën e muslimanëve, që kohëve të fundit është e pranishme edhe në trojet tona. Qëllimi i këtij shkrimi nuk është të shtojmë përçarjen apo diçka tjetër negative, por dëshirojmë të bëjmë me dije se në Islam çdo mospajtim nuk është përçarje. Prandaj janë disa çështje, ku lejohet të ketë mospajtim apo ndryshim të mendimeve ndërmjet dijetarëve dhe ai ndryshim të mos bëhet shkak që muslimanët të largohen nga njëri tjetri, apo të përçahen dhe të krijojnë armiqësi ndërmjet tyre.

Kjo çështje është shumë pak e njohur te muslimanët në përgjithësi dhe mosdija ndaj saj është e vërejtur gjithashtu edhe në vendin tonë. Prandaj, synimet kryesore të këtij shkrimi mund të përmbled-



hen në këto pika:

1. Qartësimi se, mospajtimi në këtë çështje, së pari, është evident dhe nuk mund ta injorojmë dhe ta asgjësojmë; pastaj, ky mospajtim është i lejuar dhe i pranuar te të gjithë fukahatë, për këtë asesi nuk lejohet që të krijojnë përçarje dhe fitne, por duhet të trajtohet ashtu siç është trajtuar te dijetarët dhe te gjithas ne kemi dëgjuar për ta. Prandaj muslimanët kanë nevojë të fitojnë kulturë dhe edukatë, ta shohin këtë lloj të ndryshimit të mendimeve si të natyrshme dhe të pranuar.

2. Të shohim se shkak i mospajtit është numri i madh i transmetimeve që kanë ardhur nga i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, dhe sahabët e tij. Këto transmetime nuk janë përhapur te të gjithë muslimanët njësoj, kështu që,

posaçërisht në kohët e mëhershme, disa hadithe që kanë qenë të njohura në një vend dhe dijetarët e atij vendi, nuk kanë qenë të përhapura në vendin tjetër<sup>1</sup>. Duke ia bashkangjitur kësaj, se ato transmetime nuk kanë qenë të njëjtit rang të vërtetësisë dhe besueshmërisë, për shkak se, siç e dimë, ekzistojnë hadithe të sakta, të mira, të dobëta, të shpifura etj.

3. Është e njohur te të gjithë muslimanët se në botë sot ekzistojnë katër medhhebe të pranuar që pasohen dhe dijetarët shkruajnë rreth çështjeve të fikhut duke i pasur për bazë qëndrimet, mendimet, përfundimet e këtyre shkollave, por thuajse të gjithë puqen në mendimin se, nëse ndonjë çështje, për të cilën ai hulumton, arrin në përfundim se, mendimi më i qëlluar dhe më i argumentuar është ndonjë mendim që nuk është mendimi i medhhebit të cilën ai ndjek, ai duhet të marrë mendimin që ka vërtetuar se është më i saktë<sup>2</sup>.

Sa e rëndësishme është njohja e kësaj dispozite në Islam

Para se të fillojmë në shpjegimin e mendimit të dijetarëve, dëshirojmë të cekim një thënie të imam Neveviut si përgjigje ndaj atyre që thonë se kjo çështje është sunet dhe e thjeshtë, prandaj nuk lipset të humbasim kohë në qartësimin e saj, a të praktikohet apo jo.

Imam Neveviu thotë: "Dije se kjo çështje është me rëndësi të madhe, për shkak se çdo musliman ka nevojë për të gjatë ditës disa herë, posaçërisht kërkuesi i ahiretit, ai i cili fal namaze shumë, prandaj dijetarët i kanë kushtuar kujdes të veçantë kësaj çështje, derisa imam Buhariu shkroi një libër të tërë rreth

<sup>1</sup>Si p.sh.: hadithet që kanë qenë të përhapura dhe të njohura në Kufë, nga këto hadithe ka pasur që nuk kanë qenë të njohura tek dijetarët e Shamit apo Medinës dhe kështu me radhë.

<sup>2</sup>Kjo është porosia e katër dijetarëve më të mëdhenj të

kësaj çështjeje..."<sup>3</sup>.

Prandaj trajtimi i dispozitave islame, duke bërë klasifikimin e tyre ndërmjet thelbit dhe lëvozhgës, ashtu si disa e bëjnë, është shpërfillje e mësimave islame dhe porosive të shumta në të cilat ka thirrur Muhamedi, salallahu alejhi ve selem. Neve me këtë rast nuk dëshirojmë të nënvlerësojmë asnjë nga dispozitat e Allahut të Lartësuar apo edhe të stërmadhojmë ndonjë nga sunetet e Profetit, bekimi dhe paqja qofshin mbi të, aq më pak në llogari të ndonjë farzi. Por dëshirojmë të cekim se secila dispozitë Islame, pa marrë parasysh rëndësinë, e ka vendin dhe pozitën e përcaktuar nga Allahu i Lartësuar dhe Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, dhe ajo duhet ta mbajë atë vend. Kurse filozofia, e cila mbretëron te disa, që padyshim nuk cenohet qëllimi i mirë i tyre, se ne duhet t'i lirojmë muslimanët nga praktikimi i disa suneteve me qëllim të realizimit të objektivave më madhore në Islam nuk është aspak e qëndrueshme. Madje, është në kundërshtim me udhëzimin e Muhamedit (salallahu alejhi ve selem). Ai (salallahu alejhi ve selem) pothuajse të gjitha këto sunete, të cilat na janë përcjellur neve dhe që në syrin e dikujt mund të llogariten si lëvozhga të Islamit, ua ka mësuar sahabëve të tij në kohën kur Meka e shenjtë ishte e pushtuar nga mushrikët dhe kur Qabeja, kibla e muslimanve ishte e rrethuar me qindra idhuj që adhuroheshin.

Mendimet e dijetarëve në lidhje me këtë çështje

Të gjithë dijetarët janë të mendimit se ngritja e duarve gjatë tekbitit fillestar

medhhebeve dhe të gjithë dijetarët e mirëfilltë thërrasin dhe praktika e tyre aludon në këtë.

<sup>3</sup>"Mexhmu" Neveviu, vëll. III, f. 255. Vetë Imam Neveviu ia kushton disa faqe kësaj çështjeje, po ashtu edhe dijetarët të tjerë kur flasin i kushtojnë një kujdes të veçantë.

është sunet, prandaj edhe shumë nga ata rrëfejnë se për këtë çështje ka ixhma (konsensus)<sup>4</sup>.

Mospajtimi ndërmjet tyre është në ngritjen e duarve para shkuarjes në ruku, ngritjes nga rukuja dhe ngritjes nga ulja e parë për në rekatën e tretë, nëse është nga namazet tri rekatëshe apo katër rekatëshe<sup>5</sup>.

Në këtë çështje dijetarët kanë dy mendime:

Mendimi i parë: Sunet është mosngritja e duarve. Ky mendim njihet nga dijetarët hanefit, është një nga thëniet e imam Malikut dhe es`habu re`jit (është fjala për dijetarët e Kufës dhe vendeve tjera të Irakut).

Mendimi i dytë: Ngritja e duarve është sunet, në këto tri vende<sup>6</sup>. Ky mendim është i njohur nga shafijtë dhe disa dijetarëve të tjerë, të cilët do t'i përmendim më poshtë.

1. Mendimi i parë: Mosngritja duarve është sunet

Mendimin e parë e përmbajnë këta dijetarë:

Fukahatë, të cilët përfaqësojnë këtë mendim, thonë se kjo transmetohet të jetë thënie e Abdullah b. Mesudit, Ali b. Ebi Talibit, Ebu Hurejres dhe disa sahabëve të tjerë<sup>7</sup>.

Kurse nga dijetarët të tjerë të njohur: Imam Ebu Hanife së bashku me dy nxënësit e mëdhenj të tij Ebu Jusuf dhe

Ky mospajtim është i lejuar dhe i pranuar te të gjithë fukahatë, për këtë assesi nuk lejohet që të krijojë përçarje dhe fitne, por duhet të trajtohet ashtu siç është trajtuar te dijetarët dhe te gjithsa ne kemi dëgjuar për ta. Prandaj muslimanët kanë nevojë të fitojnë kulturë dhe edukatë.

Muhamed Haseni dhe të gjithë nxënësit e tjerë të tij, imam Maliku në njërin nga thëniet, Sufjan Theuri, Ibrahim Nehaiu, Bin Ebi Lejla dhe të gjithë dijetarët e Es`habu Rre`jit (me këtë term janë njohur dijetarët e Kufës dhe disa vendeve tjera të Irakut).

Argumentet e mendimit të parë:

1. Transmetohet nga Abdullah b. Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: "A dëshironi t'ua fal namazin e Resulullahit, salallahu ale-

jhi ue selem. Ai ua fali atyre dhe nuk i ngriti duart vetëm se herën e parë (në tekbirin fillestar)"<sup>8</sup>.

2. Transmetohet nga Bera b. Azib (sahabij i njohur) se i Dërguari, Bekimi dhe paqja qofshin mbi të, i ngrinte duart në fillim të namazit, pastaj nuk e përsëriste (ngritjen e tyre)<sup>9</sup>.

3. Nëse kemi kundërshtime ndërmjet haditheve të Profetit, bekimi dhe paqja qofshin mbi të, atëherë kanë thënë se të vepruarit me këto dy hadithe të sipërpërmendura (hadithi i Bin Mesudit dhe Bera Bin Azibit) kanë më shumë përparësi, sepse Bin Mesudi ka qenë transmetues i haditheve dhe dijetar (fakih), shoqërues i përpiktë me Profetin, bekimi dhe paqja qofshin mbi të, i dinte rastet e tij dhe gjendjet, prandaj transmetimet e tij kanë përparësi nga transmetimet e të tjerëve

<sup>4</sup>"Bedaiu sanai" Kasani vëll. II, f. 22 etj.

<sup>5</sup>Ekzistojnë edhe disa raste të tjera, për të cilët disa dijetarë kanë deklaruar se është sunet ngritja e duarve, por nga frika e zgjerimit nuk do t'i trajtojmë ato.

<sup>6</sup>Ngritja e duarve para shkuarjes në ruku, ngritjes nga rukuja dhe ngritja nga ulja e parë për në rekatën e tretë, nëse është nga namazet tri rekatëshe apo katër rekatëshe

<sup>7</sup>Për më gjerësisht: "Euxhezil Mesalik ila Muveta - Imam Malik", Muhamed Zekiria Kandehleviu, vëll. II, f. 49-53

<sup>8</sup> Shënon Ebu Davudi, Nesaiu, Imam Ahmedi në Musnedin e tij, gjithashtu e shënon edhe Tirmidhiu dhe thotë hadithi është hasen, kurse b. Hazmi thotë se hadithi është sahih.

<sup>9</sup> Shënon Ebu Davudi (dhe thotë se nuk është i vërtetë) dhe Imam Ahmedi.

(sahabëve) që nuk kanë qenë si ky.

4. Transmetohet nga Abdullah b. Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: "Jam falur pas Ebu Bekrit dhe Omerit dhe ata nuk i kanë ngritur duart, përveç se në fillim"<sup>10</sup>.

5. Transmetohet nga Ali b. Ebi Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i ngrinte duart në tekbirin fillestar, pastaj nuk i ngrinte në asnjë vend tjetër"<sup>11</sup>.

6. Transmetohet nga Xhabir b. Semure, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: I Dërguari thotë: "Pse jeni duke i ngritur duart si bishtat e kalit në diell? Qëndroni qetë në namaz"<sup>12</sup>.

7. Transmetohet nga Abdullah b. Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: "Mos i ngrini duart vetëm se në shtatë raste, në fillim të namazit, kur të kthehemi nga kibla, në Safa, në Merva, në Arafat,..."<sup>13</sup>.

8. Në librin "Euxhezil Mesalik ila Muveta - Imam Malik", Muhamed Zekiria Kandehleviu, përveç këtyre argumenteve të lartpërmendura, që i përmendin edhe dijetarët e tjerë në librat e tyre, përmend edhe dhjetëra transmetime nga Bin Abasi, Bin Mesudi, Ebu Hurejra, Bin Omeri, Aliu dhe nga dhjetë (sahabëve) të përgëzuar me xhenet, Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë, se nuk i ngrinin duart përveç se në fillim të namazit. Gjithashtu, të njëjtën e transmeton edhe nga disa tabiinë, që edhe ai pranon se në këto transmetime ka dobësi. Ai thotë se derisa me këto hadithe kanë punuar dijetarë si Ebu Hanife, dy nxënësit e tij dhe shumë dijetarë të Kufës dhe Imam Theuriu, ato tek unë janë të sakta<sup>14</sup>.

<sup>10</sup>Shënon Darekutniu dhe Bejhikiu, shih "Mexhmu" Neveviu, vëll. III, f. 255-258.

<sup>11</sup>Shënon Bejhakiu; shih "Mexhmu" Neveviu.

<sup>12</sup>Shënon Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu.

<sup>13</sup>Shënon Taberaniu

9. Namazi në fillim kur është bërë i obliguar ishin të lejuara disa sende si biseda, kthimi i selamit, ecja, lëvizjet e ndryshme, pastaj dalëngadalë janë ndaluar këto gjëra që u përmendën dhe çdoherë që kemi transmetime kontradiktore si lëvizja e duarve apo moslëvizja, duhet të marrim atë që është më e afërt, qetësisë dhe jolëvizshmërisë.

Ekzistojnë edhe disa argumente me të cilat argumentojnë dijetarët e mendimit të parë (mosngritjes së duarve), por kryesisht këto ishin më të qëndrueshmet.

Mendimi i dytë: Ngritja e duarve është sunet

Ky qëndrim vërtetohet me zinxhirë të transmetuesve nga këta sahabë: Abdullah b. Omeri, Abdullah b. Abasi, Xhabir b. Abdullahu, Ebu Hurejre, Abdullah b. Zubejri, Enes b. Maliku.

Përveç këtyre, transmetohet edhe nga Ali b. Ebi Talibi, Omeri, Uail b. Huxhur, Malik b. Huejrith, Sehl b. Sadi, Muhamed b. Mesleme, Ebu Musa, Xhabir b. Umej Lejthi dhe Ebu Seid Huderu.

Kurse nga tabiinët: Hasan Basriu, Atau, Tavusi, Muxhahidi, Salimi b. Abdullah, Said b. Xhubejri, Nafiu dhe të tjerë.

Dhe nga dijetarët: Abdullah b. Mubareku, imam Shafiu, Is'haku, imam Maliku në njëren nga thënie të tij, Imam Ahmedi, Lejth b. Sadi, Ebu Theuri, imam Buhariu, Muslimi, Neveviu, Bin Haxheri dhe shumë dijetarë të tjerë<sup>15</sup>.

Argumentet e mendimit të dytë:

1. Transmetohet nga Abdullah b. Omeri se ai ka thënë: "E kam parë Resulullahun, salallahu alejhi ue selem, kur falte namazin i ngrinte duart deri te

<sup>14</sup>"Euxhezil Mesalik ila Muveta - Imam Malik", Muhamed Zekiria Kandehleviu, vëll. II, f. 49-53

<sup>15</sup>"Mugni", B. Kudame, vëllimi II, f. 170-171, "Fet'hul bari" B. Haxher, vëll. III, f. 278-280; "Mexhmu", vëll. III, f. 252-254 etj.



supet, e bënte këtë kur bënte tekbirin për të shkuar në ruku, kur ngrihej nga rukuja dhe thoshte: 'Semiallahu limen hamideh', kurse kur shkonte në sexhde nuk i ngrinte (duart)<sup>16</sup>.

Buhariu thotë, pas citimit të hadithit, se ka thënë Ali Medini, i cili ka qenë më i dituri i kohës së tij: "Është e nevojshme për muslimanët t'i ngrënë duart e tyre, për shkak të këtij hadithi."

2. Transmeton Halidi nga Ebu Kilabe se e ka parë Malik b. Huejrithin (sahab i njohur) kur falej, në tekbirin fillestar ngrinte duart, kur shkonte në ruku i ngrinte duart, kur ngrihej nga rukuja i ngrinte duart. Ai tregoi se i Dërguari, bekimi dhe paqja qofshin mbi të, vepronte ashtu<sup>17</sup>.

3. Transmeton Nafiu se, Bin Omeri, kur hynte në namaz, bënte tekbirin dhe ngrinte duart, kur shkonte në ruku ngrinte duart, kur thoshte 'semiallahu limen hamide' ngrinte duart dhe kur ngrihej nga rekati i dytë (pas uljes së parë dhe fillonte rekatin e tretë) ngrinte duart, pastaj tregoi se kështu vepronte i Dërguari, bekimi dhe paqja qofshin mbi të<sup>18</sup>.

4. Transmeton Muhamed b. Amër b. Atau (ky ishte prej tabiinëve) derisa ishte ulur me një grup të sahabëve, u përmend namazi i Pejgamberit, pastaj tha Ebu Humejd Saidiu (ky është sahab) se ka thënë në prani të këtyre sahabëve - ndër ta (sahabët) ishte edhe Ebu Katade - do t'ua tregoj formën e namazit të Resulullahit, bekimi dhe paqja qofshin mbi të, ata thanë: na e trego: ... (hadithi

është i gjatë, në të përshkruhet forma e namazit e të Dërguarit dhe përmendet se i ka ngritur duart gjatë tekbirit fillestar, shkuarjes në ruku, ngritjes nga ajo dhe kur ngrihej për në rekatin e tretë). Ata sahabë që ishin të pranishëm ia vërtetuan këtë formë të namazit me ngritjen e duarve<sup>19</sup>.

5. Transmetohet nga Ali b. Ebi Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, kur falte namazin bënte tekbirin fillestar dhe i ngrinte duart deri te supet dhe vepronte ashtu kur përfundonte leximin e donte të shkonte në ruku, kur ngrihej nga rukuja, kurse nuk i ngrinte duart kur ishte ulur (në sexhde) dhe kur ngrihej për në rekatin e tretë vepronte ashtu (pra i ngrinte duart)<sup>20</sup>.

6. Nga Enes Bin Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, i ngrinte duart para se të shkonte në ruku, gjithashtu e njëjta transmetohet nga Ebu Hurejre<sup>21</sup>.

7. Transmetimet për ngritjen e duarve janë të shumta. Imam Buhariu e shkroi një libër ku përmend shumë transmetime nga sahabë, tabiinë dhe dijetarë për ngritjen e duarve. Aty përmend se këto transmetime arrijnë shkallën e mutevatirit<sup>22</sup>, gjithashtu edhe Imam Bejhaku përmbledh një numër të konsiderueshëm transmetimesh, kurse ne po mjaftohemi me këto argumente që i përmendëm.

*Vijon*

<sup>16</sup>Shënon Buhariu. Shih: "Fet'hul bari", Vëll. II, f. 279; Muslimi, Vëll II, f. 192. Që të dy (Buhariu dhe Muslimi) e shënojnë këtë hadith me disa transmetime të ndryshme. Gjithashtu hadithin e shënon Ebu Daudi, Tirmidhiu, Nesaiu, B. Maxheh, Darimiu, Maliku, Ahmedi.

<sup>17</sup>Shënon Buhariu. Shih: "Fethul bari", Vëll. II, f. 279.

<sup>18</sup>Këtë hadith imam Buhariu e shënon me disa zinxhirë te transmetimeve dhe të gjitha të sakta. Shih. "Fet'hul bari",

Vëll. II, f. 282.

<sup>19</sup>Shënon Buhariu, Ebu Daudi, B. Maxheh dhe Tirmidhiu, ky i fundit thotë se hadithi është hasen sahih.

<sup>20</sup>Shënon Ebu Daudi dhe Tirmidhiu e thotë hadithi është hasen sahih.

<sup>21</sup>Shënon Buhariu, por jo në koleksionin e tij por në librin me titull "Libri mbi ngritjen e duarve"

<sup>22</sup>Për më gjerësisht shih librin e Buhariut. "Kitabu reful jedejni fi salat" - "Libri mbi ngritjen e duarve në namaz".



# Jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme

**shkruan: Muhamed DËRMAKU**

## Allahu i Lartësuar thotë:

*"Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim, zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë thahet dhe befasi e sheh të zverdhur, dhe pastaj mbetet e thyer e llomitur. Në Ahiret ju pret vuajtje e rëndë ose falje e Allahut dhe kënaqësi e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme." (el-Hadidë, 20)*

Allahu i Lartësuar i drejtohet njerëzimit me këtë ajet Kur'anor duke ua rrumbullakuar tërë kuptimin e jetës së njeriut, në të gjitha etapat. Me shprehjen "jetë e njeriut", gjithherë duhet të kuptohet jeta e tij prej krijimit të shpirtit

tit e deri te strehimi i tij i përhershëm në Ahiret, përfshirë këtu lindjen dhe vdekjen e tij në këtë botë, ringjalljen etj.. Me këtë shprehje nuk duhet kuptuar assesi vetëm jeta e tij në këtë botë.

Dihet se njeriu si njeri, edhe pse i kishte dhënë Allahut besatimin që ta njohë për Zot, atëherë kur ishte shpirt<sup>1</sup>, ai kur u krijua me trup dhe erdhi në këtë botë, erdhi me brendinë e tij, që tani përbëhet edhe me epsh, lakmi, egoizëm etj., harroi atë besë të dhënë Allahut dhe shpeshherë e zëvendësoi Allahun me zota të tjerë, dhe varësisht prej nivelit të besimit ndaj tyre edhe i adhuron ose thënë më thjesht ua dedikon jetën. Është e ditur se për t'u

<sup>1</sup>Shiko më gjerësisht ajetin 172 të sures el-A'rafë!

dhënë pas bukurive të dynjasë stimulon ana e brendshme e njeriut, djalli nga xhinët dhe nga njerëzit etj., dhe shikuar sipërfaqësisht duket se është vështirë t'i kundërshtosh ato dhe t'ua kthesh shpinën. Mirëpo besimtari, falë pasqyrimin islam që i jep jetës së njeriut në përgjithësi, e ka të qartë të mirën, por nuk e ngatërron me më të mirën. E kupton se ka gjëra që ia do bota e tij e brendshme, por e di që të tilla mund të jenë në dëm të tij, kur është fjala te pasojat dhe reflektimet e tyre në jetën e njeriut, shikuar në vija të trasha. Kështu, njeriut i zgjohet ndjenja e shpresës së garantuar, me të cilën është në gjendje t'i përballet dëshirave të tij të përsheptuara dhe t'i refuzojë në mënyrë të prerë gjërat "e këndshme" në favor të asaj që është më e qëndrueshme dhe më cilësorja.

Allahu, subhanehu ve teala, me këtë ajet, i cili gjendet në suren el-Hadidë dhe radhitet fill pas ajetit, ku Allahu tregon se njerëzit janë në dy kategori kryesore; besimtarë të sinqertë, për të cilët është Xheneti dhe mosbesimtarë, që i refuzojnë dhe përgënjeshtrojnë argumentet e Allahut, të cilët do të jenë banorë të Xhehenemit, i drejtohet njerëzimit dhe u thotë:

### **Çfarë përmban Dynjaja?**

Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim, zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet

Vërtetë si shqiptari, ta zëmë shembull, që luan shah me serbin, dhe duke angazhuar mbret e mbretëreshë, oficerë e ushtarë, të tërë arsenalin ushtarak me topa e kuaj, ia del të shënoj fitore kundër serbit dhe gjen gëzim për fitoren e arritur. Por ky gëzim shumë shpejt kalon dhe ndoshta shndërrohet në dëshpërim kur e sheh se fitorja ka qenë vetëm në tabelë të shahut e jo edhe në realitet.

për më shumë pasuri dhe fëmijë!

E vështruar me kujdes, të gjitha veprat, përveç adhurimeve dhe riteve fetare, sillen rreth ndonjërit prej këtyre pesë boshteve kryesore. A thua vallë janë të ndaluara këto gjëra? Njeriu duhet të ketë gjithherë një gjë parasysh, në jetën e tij të përditshme, që të mos i ngatërrojë asnjëherë mjetet dhe qëllimet. Andaj këto të pesë gjërat, mund të jenë të lejuara, nganjëherë edhe të preferuara, por shpeshherë të ndaluara, varësisht nga qëllimi i përdorimit të tyre.

Disa komentues të Kur'anit këto gjëra i vlerësojnë kështu:

Kjo botë është lojë si ajo e fëmijëve, dëfrim si dëfrimi i të rinjve, zbukurim si zbukurimi i grave, mburrje e lavdërim siç mburren rivalët në dije, fuqi, eksperiencë etj. dhe rivalitet e garë ashtu siç garojnë tregtarët në pasuri.

Çfarë është dallimi në mes lojës dhe dëfrimit? Disa komentues kanë thënë se lojë **لَعِبٌ** (leib) është gjithçka që të bën ta duash Dynjanë, kurse dëfrim **لَهْوٌ** (lehv) është gjithçka që të mashtron nga Ahireti.

Sido që të jetë, edhe pse këto gjëra mund të jenë të këndshme dhe njeriu mund të lakmojë në to, dhe në shumë raste disa prej këtyre mund të jenë të lejuara, por kur kihet parasysh dinamika e kërkuar prej njeriut, që lipset ta përcaktojë statusin e tij për jetën e amshuar, dhënia e tepruar pas tyre

mbase mund ta largojë atë nga qëllimi i tij vigan, që është shpëtimi nga zjarri i Xhehenemit dhe banimi i përhershëm në Xhenet. Andaj këto gjëra, apo në përgjithësi kjo botë, kujt mund t'i përngjajë?

"Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë thahet dhe befasi e sheh të zverdhur, dhe pastaj mbetet e thyer e llomitur."

Çfarë krahasimi i lartë vije nga Allahu i Lartësuar! Allahu ekber!

Tërë kjo botë i ngjaka, një shiu të begatshëm, i cili bën të rritet bima apo kulturat bujqësore, arsye për të cilën gëzohen bujqit. Gëzohen bujqit ashtu siç gëzohen fëmijët kur triumfojnë në lojë dhe ashtu siç gëzohen të rinjtë kur dëfrehen. Ashtu siç gëzohen femrat kur zbukurohen dhe ashtu siç gëzohen tregtarët kur fitojnë më shumë se të tjerët. Të gjithë këta gëzohen për rezultatet e tyre, e më shumë të drejtë që të gëzohet nga këta ka bujku. Por e përbashkëta e tyre është se të gjithëve ky gëzim nuk u zyjat shumë, sepse është i përkohshëm. Pas pak e sheh se bima, për të cilën ishte gëzuar bujku ishte jetëshkurtër dhe befasisht e sheh të zverdhur e pastaj edhe të thyer e të llomitur. Vërtetë e tillë është praktikisht jeta në Dynja. Lodhje, rraskapitje, dërrmim, vrapim, angazhim, braktisje e shumë gjërave, shpeshherë edhe atyre pozitive, por ndodh edhe braktisje të obligimeve duke vrapuar pas Dynjasë, dhe në fund asnjë minutë jetë më shumë se aq sa ka caktuar Allahu. Pra s'ka shmangie prej vdekjes. Vërtetë si shqiptari, ta zëmë shembull, që luan shah me serbin, dhe duke angazhuar mbret e mbretëreshë, oficerë e ushtarë, të tërë arsenalin

ushtarak me topa e kuaj, ia del të shënoj fitore kundër serbit dhe gjen gëzim për fitoren e arritur. Por ky gëzim shumë shpejt kalon dhe ndoshta shndërrohet në dëshpërim kur e sheh se fitorja ka qenë vetëm në tabelë të shahut e jo edhe në realitet. I tillë ishte edhe gëzimi i bujku pas shiut, kur bima përfundon me llomitje.

Pra të tillë janë ata që mundohen ta përshpejtojnë gëzimin dhe dëfrimin në këtë botë. Mos të harrojnë të tillët se kjo botë nuk është botë karari!

Fjala bujq në këtë ajet përmendet si kuffarë الكفار shumësi i fjalës kafir الكافر. Komentuesit e Kur'anit kanë dy mendime në lidhje me domethënien e kësaj fjale në këtë kontekst të fjalisë:

**Mendimi i parë**, të cilin e përkrahin shumica e komentuesve, është se me fjalën el-kuffarë janë për qëllim bujqit, pasi fjala kufër në esencë ka kuptimin e mbulimit. Andaj edhe bujqit mund të quhen ashtu pasi ata e mbulojnë farën me dhe. Po ashtu konteksti i fjalisë ndihmon në këtë kuptim.

**Mendimi i dytë** përkitazi me fjalën el-kuffarë në këtë ajet, është se fjala ka për qëllim mosbesimtarët, ashtu siç përdoret në shumicën e vendeve në Kur'an. Dhe kjo sipas bartësve të këtij mendimi, nuk ndeshet me kontekstin e ajetit në përgjithësi, sepse, sipas tyre, mosbesimtarët janë ata që gëzohen shumë për të mirat materiale e në këtë rast, për shiun që bie në kohë kur bima ka nevojë dhe me zhvillimin e saj gëzohet mosbesimtari, pasi për të kjo është një arritje shumë e madhe.

Mendimi i parë duket të jetë më i saktë edhe për kah konteksti i fjalisë, por edhe në bazë të ajetit 29 të sures el-Fet-h, ku Allahu i lavdëron besim-

tarët dhe i paraqet si një farë që lëshon filiza e forcohet, e pastaj ngrihet e fortë me **كِرْعَلِينَ** e vet, **يُغِيبُ الزَّرْعَ لِيُغِيبَ بِهِمُ الْكُفَّارَ**

**...duke i gëzuar bujqit, (këtë shembull Allahu e sjell) për t'i zemëruar kështu mosbesimtarët.**

Pra, në këtë ajet Allahu e përdor fjalën zurr-rra' (shumës i fjalës zari' që ka kuptimin mbjellës-bujk) në vend të fjalës kuffarë në ajetin tonë, kur është fjala te gëzimi i tyre për bimën e mirë.

### **Çfarë përmban Ahireti?**

**"Në Ahiret ju pret vuajtje e rëndë ose falje e Allahut dhe kënaqësi e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."**

Dinamika, të cilën e përmenda më parë, se njeriu nuk ka shumë kohë që ta kalojë atë në lojë e dëfrim, sepse me një etapë jete të shkurtër siç është kjo e kësaj bote, duhet ta përfitoj jetën e amshueshme të Ahiretit, pikërisht këtu bëhet e qartë kur Allahu na kujton se në Ahiret ka dënim të vështirë. Kjo gjë nuk duhet të na lërë të qetë gjatë gjithë jetës në këtë botë. Hasan Basriu nuk qeshte fare, pa marrë parasysh rrethanat.

- Ishte pyetur përse nuk qesh kurrë?

- A e kam kaluar Urën e Siratit që të rehatohem e të qeshi? - ishte përgjigjur.

Pra atje ku jeta është e pafund, ndonëse ka begati të mëdha dhe rehati të papërshkrueshme, të cilat janë në Xhenet, ka mundësi që të jemi me status tjetër të kundërt nga ai i begative dhe pafundësia vlen edhe për aty pas-taj. Allahu na ruajt prej zjarrit!

Padyshim se rruga për në Xhenet,

Allahu na bëftë një prej banorëve të tij, kalon mbi buzët e zjarrit. Secili do të kalojë mbi atë Urë. Allahu thotë:

**"Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi). Kjo është vendosur prerazi nga Zoti yt. Pastaj do t'i shpëtojme ata që kanë qenë besimtarë dhe do t'i lëmë keqbërësit të gjunjëzuar në të."**<sup>2</sup>

Se do të jesh i sigurt në ecje mbi atë Urë apo jo, varet prej veprimtarisë sate në Dynja. Vallë a ka kohë për lojë, dëfrim ... dhe a ia vlen të bëhen prioritet në këtë interval të shkurtër?

Në Ahiret ekziston edhe opsioni tjetër dhe s'ka alternativë tjetër përpos tij. Është fjala për faljen e Allahut dhe kënaqësinë apo pajtueshmërinë e Tij. Ky privilegj është i papërshkrueshëm. Por edhe sakrifica për ta arritur, nuk ka qenë gjithaq e lehtë. Durimi dhe matura e njerëzve që dinë ta çmojnë vlerën dhe antivlerën, ta dallojnë të shpejtën e shkurtër me të ngadalshmen e gjatë. Që janë në gjendje ta sundojnë veten e tyre dhe t'i përmbahen besatimit të dhënë se Zoti i tyre ishte Allahu. Pra ishin të zotit e vetvetes e jo vetja e tyre zot i tyre. Pra e kuptojnë të vërtetën si të tillë dhe e pasojnë, të pavërtetën si të tillë dhe i shmangen asaj.

Nuk bën të mos e përmendim faktin se Allahu përmend dënimin së bashku me mbiemër, pra vuajtje e rëndë, por përmend nga ana tjetër edhe dy gjëra, faljen dhe kënaqësinë. Kjo i ngjason thënies së të Dërguarit, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, kur tha rreth surës el-Inshirah, se dy lehtësime peshojnë një vështirësi.<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Sureja Merjem, 71 dhe 72

Allahu na e mundësoftë këtë dhe na e mundësoftë pastaj faljen dhe kënaqësinë e Tij.

Andaj të mos harrojmë se:

**"jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme."**

### Mësimet nga ajeti

- Përshkrimi real dhe i thjeshtë i të dy botëve. Jo se nënçmohet Dynjaja, por i jepet vlera reale. Nuk mund të nënvlerësohet tej mase kjo botë, kur e ardhmja varet nga kjo. Punët që lidhen direkt me të si shuarja e epsheve, egove etj., ato janë që duhet përçmuar. Seid ibën Xhubejri ka thënë: Jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme, nëse ajo të shmang nga kërkimi i Ahiretit. Por nëse ajo të thirr për ta kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe për ta kërkuar Ahiretin, nuk ka mjet më të mirë se ajo.

- Të mos harrojmë se çështja e dënimit u përmend para faljes dhe pajtimit!

- Zhgënjimi i lojtarit, të riut..., bujkut do të jetë i shpejtë. Dikush nga ta do të ngopet për pak qaste, tjetri për pak ditë e bujku për pak muaj do të ngopet me bimën e tij. Kurse i habituri pas dynjasë, nëse nuk kujdeset për veten e tij duke i seleksionuar prioritetet e jetës së tij sa të jetë në këtë botë, zhgënjimin do ta ketë krejt në Ahiret. Por le ta dijë se atëherë do të jetë vonë.

- Disa dijetarë këtë ajet e kanë lexuar në këtë formë. Këto pesë gjëra i kanë nda në pesë etapa të jetës së muslimanit, duke i lënë afat 8 vite për çdo etapë. Kjo botë është lojë dhe praktikisht femijet deri në moshën tetë vjeçare merren

me lojë. Pastaj është dëfrim. I riu deri në moshën 16 vjeçare ka vullnet më të theksuar për të. Pastaj është faza e dëshirës për zbukurim dhe përmbyllet në moshën 24 vjeçare. Vijnë më pas etapa e katërt e lavdërimit dhe mburrjes me të arriturat, në arsimim, edukatë, forcë, martesë etj. dhe mbyllet kjo dëshirë në moshën 32 vjeçare. Më në fund vije dëshira për të garuar në pasuri dhe femijë dhe kjo përmbyllë moshën 40 vjeçare kur njeriu arrin pjekurinë e plotë. Pas kësaj moshe, konsiderojnë ata, është turp të merret muslimani, përveç se me ibadet. Bazuar në këtë ndarje të mrekullueshme, nuk ka hije 50 vjeçi të jetë aventurier e lëre më më i vjetër.

### Porosia e ajetit

- Mos u habitni o njerëz!
- Mos i ngatërroni gjërat!
- Mos e shitni të shtrenjtën për të lirën!
- Mos e lëni të përhershmen më të mirë për hir të të përkohshmes jo aq të mirë!
- Mos i lëni gjërat e rëndësishme edhe nëse janë të hidhura dhe të urryera shikuar nga jashtë, për hir të jetës komode të afatizuar!
- Mos iu qasni seriozisht Dynjasë dhe gëzimeve të saj duke rrezikuar kështu gëzimet dhe të mirat e Ahiretit!
- Mos e lëni thjesht Ahiretin për Dynja!

Dijeni se e tërë jeta e kësaj bote është lojë, dëfrim, zbukurim, mburrje-lavdërim dhe rivalitet e garë!

<sup>3</sup> Në ajetet 5 dhe 6 të surës el-Inshirah që duket se është një ajet i përsëritur, përmendet vështirësia në të shquar, pra dy herë, kurse lehtësimi në të pashquar, po ashtu dy herë. Rregullat gjuhësore tregojnë se kur një gjë është e panjohur, të parën herë përmendet në trajtën e pashquar dhe pastaj shquhet. E nëse përmendet përsëri e pashquar, atëherë kemi të bëjmë me dy gjëra të veçanta. Andaj kishte thënë i Dërguari se janë dy lehtësime.



# Çfarë vendosa të bëj para 18 viteve

**Shejh Ihsan UTEJBI**

**L**avdërimi i takon vetëm Allahut, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Tij...

Para tetëmbëdhjetë viteve, derisa jetoja në Aman të Jordanisë, me një rast më erdhi një vëlla në Islam dhe më tregoi se e kishte falur namazin e teravisë në xhaminë në të cilin ishte imam hoxxha Abdullah Azami, Allahu e mëshiroftë. Ai tregoi sa pas hoxhës faleshin një xhemat mjaft i madh i muslimanëve dhe nga gjërat që përmendi ishte edhe se atë natë kishte ndodhur një gjë e mirë gjatë faljes, por në të njëjtën kohë edhe jo e pëlqyeshme.

E mirë ishte për imamin, kurse jo e pëlqyeshme për të gjithë ne të tjerët, përveç fëmijëve të imamit.

Ndodhia ishte se kur hoxxha Abdullah Azami, gjatë leximit të Kur'anit ne teravi gabonte, fëmijët e tij të vegjël e korrigjonin, kurse ne të tjerët që ishim të pranishëm s'mund ta korrigjonim, pasi

nuk i dinim përmendësh pjesët e Kuranit që lexonte ai. Prandaj, kjo ishte gjë e mirë për hoxhën dhe jo e pëlqyeshme për ne!

-U magjepsa me këtë ndodhi të jashtëzakonshme që tregon shembullin e mirë në edukim të fëmijëve; mësimin e Kuranit përmendësh dhe më pas thellimi i tyre në kuptimin e tij dhe me lejen e Allahut edhe puna me të.

U aspirova aq shumë, sa shpresova të isha unë imami dhe fëmijët e mi të vegjël të më korrigjonin kur të gaboja edhe pse unë në atë kohë ende nuk isha i martuar.

E tërë kjo magjepsje dhe zili ishte duke u nisur nga fjala e Allahut: "E për shpërbllim të tillë le të garojnë ata që lakmojnë të mirën." (Mutafifin, 26) dhe nga thënia e të Dërguarit, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të: "Nuk ka zili përveç ndaj personit që Allahu ia dha librin (e mësoi Kuranin) dhe me të falet gjatë tërës natës. Dhe njeriut që Allahu i dha pasuri e ai jep

Gruaja dhe familja

prej saj çdo kohë, ditën dhe natën." (Buhariu dhe Muslimi).

Në ato kohëra, kur bisedoja me disa shokë, u flisja për këtë ambicie dhe u thosha se medresetë e sotme nuk arrijnë t'i edukojnë dhe t'i mësojnë fëmijët ashtu si kërkohet në Islam.

Sa për vete, vendosa që t'i hyja mundit, me aq sa do të kisha mundësi, që, nëse do të bëhesha me fëmijë, do t'ua mësoja atyre librin e Allahut (Kuranin) përmendësh dhe se kjo do të ishte përpjekja ime më e madhe në jetë.

-Pas një kohe u martova dhe Allahu më dhuroi fëmijë.

Menjëherë fillova me ta në realizimin e qëllimit që kisha vendosur që në kohën e rinisë sime; atëherë, kur pata dëgjuar për ngjarjen me hoxhën Abdullah Azam dhe fëmijët e tij.

Me fëmijët e mi, në edukimin dhe mësimin e tyre, vijova rrugën e të parëve tanë. Ishte vështirë pasi ishin të vegjël dhe nuk kisha ndihmës në këtë, pastaj, edhe rruga prej shtëpisë sonë deri te hoxha që i mësonte ishte e largët.

Prandaj, ishte e nevojshme që ata të banojnë në shtëpinë e hoxhës që i mësonte, ai jetonte larg nesh pesëdhjetë kilometra. Fëmijët mungonin gjatë javës pesë ditë, askush nuk e di çfarë ndieja në zemër kur i përcillja tek autobusi dhe i hipja në të duke i përshëndetur dhe lënë në ruajtje të Allahut.

Fëmijët e mi, që në vegjëli, u mësuan të udhëtojnë në vende të largëta, të vetmuar. U mësuan të rrinë me burra dhe rini, derisa arritën të njihen me njerëz më shumë se unë!

Gjatë kësaj kohe, ata kanë përjetuar ngjarje të këndshme me njerëz, që ndoshta ndonjëherë do të arrij t'i përcjell disa

Në fund them se, ai që është me Allahun nuk merakoset, ai që është i sinqertë me Allahun edhe Allahu do t'i ndihmojë atij, rruga e largët 1000 mile fillohet me një hap, prandaj kërko ndihmën e Allahut dhe mos u bë i pafuqishëm!

nga to. Mësuesi i tyre gjithashtu ishte një hoxhë që dinte Kura'nin përmendësh dhe ishte nga kërkuesit e dijes.

Pas tre viteve, fëmija i parë, Tariku dhe i dyti Davudi, u bënë nga hafizat e Kur'anit, kjo ishte dhunti nga Allahu i Lartësuar. Fëmija i dytë, Davudi, edhe pse kishte filluar të mësonte më vonë se Tariku për një kohë të gjatë dhe se ai është më i vogël një vit e tre muaj,

ata të dy e përfunduan hifzin së bashku.

Kur përfunduan hifzin, fëmija i parë Tariku kishte mbushur tetë vite e gjysmë, kurse Davudi ishte afërsisht shtatë vite. Mësuesi i tij, atëherë më pat thënë se Davudi mund të jetë hafizi më i vogël në vend.

Pas kësaj filluan të mësojnë përmbledhjen e haditheve "Umdetul Ahkam" dhe e përfunduan, pastaj librin "Bejkunije", "Tahavije" dhe "Axhirumije". Kurse tani janë duke mësuar "Rijadu Salihin" dhe kanë arritur në mësimin e 250 haditheve përmendësh, me falënderimin e Allahut..!

Dje, derisa ua falja njerëzve namazin e teravive, gabova gjatë leximit në dy vende. Ata që më korrigjonin ishin fëmijët e mi!!!

Kjo ma ktheu kujtimin e ndodhisë para 18 viteve, prandaj e falënderova Allahun që më dha sukses në këtë, e lus Atë të më shtojë nga begatit e Tij.

Në fund them se, ai që është me Allahun nuk merakoset, ai që është i sinqertë me Allahun edhe Allahu do t'i ndihmojë atij, rruga e largët 1000 mile fillohet me një hap, prandaj kërko ndihmën e Allahut dhe mos u bë i pafuqishëm!

**Përktheu: Alaudin Abazi**



# Më dëgjoni edhe pse jam i vogël



- Më keni fëmijë, më doni por mos më llastoni, sepse nuk mund të kem çdo gjë që kërkoj.

- Më edukoni që të jem i vendosur, sepse këtë e dua shumë, si dhe vetëm atëherë mund t'i shoh gjërat reale.

- Mos përdorni forcë mbi mua e as trysni, sepse kjo më mëson që të bëhem i tillë në jetë, madje edhe ndaj të pafajshmëve.

- Më udhëzoni me këshillë e butësi, bëhuni tolerant kur më mësoni, sepse jam i vogël.

- Mos më premtani atë që s'mund ta realizoni, sepse nga kërkesat e mia detyroheni të gënjeni, kurse unë mund ta mësoj si gjest normal.

- Unë jam i vogël, shpesh mund të flas fjalë për t'ju shqetësuar juve, por ju gjeni mënyrën dhe metodën që t'më ngadhënjoni e jo të bini pre e

provokimeve të mia, të cilat, nëse s'mi evitoni me kujdes, mund të më bëhen shumë të preferuara.

- Edhe pse jam shumë i vogël, mos më trajtoni bebe, sepse kurrë s'mund të më jepni edukatën e duhur.

- Si çdo fëmijë, edhe unë kam shprehur të mira e të liga, por ju mos u bëni të tepërt, që të më akuzoni e të më qortoni në çdo kohë e moment, sepse unë kam inat dhe pastaj bëj gabime me qëllim

- Ngaqë jam rritur pak, shumë gjëra di t'i bëj vet, më lejon t'i bëj e jo të m'i

Gabimet që bëj, m'i korrigjoni si prind i mirë, e jo të ma mbushësh kokën me fjalën mëkat, mëkat, mëkat, sepse unë jam njeri e jo engjëll, dua të mësohem nga ju që kur të gaboj apo mëkatoj, të di të pendohem.

bëni ju, sepse ma humbisni vetëbesimin e ma shtoni varësinë nga ju .

- Të gabosh është diçka normale, por të korrigjosh është humane, andaj, nëse unë gaboj, mos më korrigjoni në prani të tjerëve, sepse s'ka efekt. Do të jeni të suksesshëm nëse këtë e bëni me qetësi kur jemi vetëm.

- Nëse jam në ndonjë situatë jo të pëlqyeshme për ju, nëse më gjeni duke u grindur me shokët, mos më kritikoni në prani të tyre, sepse në ato momente më humb kontrollin e mund t'ju fyej edhe juve. Gjeni mënyrë të butë, më ndani nga ajo zjarrmi dhe pasi të qetësohem, më këshilloni dhe më kritikoni.

- Gabimet që bëj, m'i korrigjoni si prind i mirë, e jo të ma mbushësh kokën me fjalën mëkat, mëkat, mëkat, sepse unë jam njeri e jo engjëll, dua të mësohem nga ju që kur të gaboj apo mëkatoj, të di të pendohem.

- Nëse e teproni me kërkesat tuaja që të ju sqaroj pse kam gabuar, sidomos në ato gabime të cilat i kam bërë pa vetëdijen time, më bëni të jem i pasjellshëm dhe fyes edhe me qëllim, ndoshta edhe ndaj jush.

- Frika është pjesë e pandashme e njeriut, sidomos e fëmijës, edhe pse të jam i sinqertë gjithnjë, ndodh që ndonjëherë të gënjej, andaj mos gjykoni gjithmonë në bazë të sinqeritetit tim.

- Nëse gjithmonë vetëm më predikoni, do më bezdisni dhe, nga bezdia detyrohem t'i shpalos edhe të këqijat që di, e ti do çuditesh, madje,

edhe do dëshpërohesh .

- Nëse njeri më qorton, të mos më përkrahë tjetri, sepse unë krijoj bindje të gabuar për ju, mendoj që s'keni autoritet e dashuri të ndërsjellë në mes vetes.

- Kujdes kur jam në gjumë, mos flisni fjalë a shprehje të ulëta, sepse unë ka mundësi të jem zgjuar po ju nuk e dini.

- Unë i dua filmat, sidomos ata për fëmijë, por i urrej skenat e juaja si në film, kur ju grindeni në praninë time.

- Nëse ju hidhërojnë gjithëherë e mi, mos i fyesi në praninë time, as mos më thoni gjë keq për ta, e urrej këtë gjë sepse unë i dua.

- Nëse s'më edukoni të jem i kujdesshëm gjatë të ushqyerit, do t'ju turpëroj në çdo rast kur ne ushqehemi në prani të

tjerëve po edhe tuajën.

- Para gjumit, nëse s'më edukoni që t'i laj duart, këmbët, dhëmbët e të vishem me pizhame, unë do të shtrihem me rrobat që kam mbajtur dhe luajtur gjatë tërë ditës, këtë e bëj sepse s'kam njohuri që nuk duhet bërë.

- U lodha me kërkesa e dëshira o prindërit e mi, e tëra ka qëllimin që në mua të formoni identitet dhe personalitet me norma të qarta e të drejta ashtu siç e ka lënë të porositur Muhamedi alejhi salatu ue selam.

***Ju do shumë fëmija juaj!***

Mos më premtoni atë që s'mund ta realizoni, sepse nga kërkesat e mia detyroheni të gënjeni, kurse unë mund ta mësoj si gjest normal.

# Televizioni, kompjuteri dhe fëmija

**K**oha që po jetojmë dallohet për ndryshimet marramendëse të teknikës dhe teknologjisë, çka ka çuar në zhvillimin e shumë fushave të njerëzimit. Sipas statistikave më të fundit, shkalla e arsimimit sa vjen dhe po pëson rënie qoftë në sasi, qoftë në cilësi, çka shfaqet rrjedhojë e teknologjisë në raport me prodhimin, trafiku i komunikacionit (veprimtaritë shërbyese). Mirëpo, fëmijët në shtëpi dhe jashtë objekteve shkollore jetojnë në një rreth të pasur

teknologjik në pritje të ndryshimeve në arsim në përputhje me imperativin arsimor për shek XXI. Në këtë mënyrë, në arsim dalëngadalë po futet sistemi i përpunimit të të dhënave, sistemet multimediale, mësim në largësi, shkollat virtuale dhe teknologji të tjera, të cilat çojnë deri te përforcimi i aktivitetit të nxënësit, dituria e vlerësuar në mënyrë kualitative dhe përparimi i nxënësve në raport me aftësitë individuale dhe të paradituriës.



Gravaja dhe familja

"Shpërthimi" i diturive të reja është kthyer në karakteristikë e shoqërisë së epokës së informatikës, në të cilën arkivimi, përpunimi dhe bartja e informacionit janë të bazuara në teknologjitë bashkëkohore dhe metodat e informacioneve të kohës.

Është e qartë ajo çka na ofrojnë këto shpikje, mirëpo ne ndaj tyre jemi të dobët dhe/ose assesi nuk përgjigjemi! Mendojmë se mund t'i kemi lehtë nën kontroll, mirëpo në të vërtetë mbetemi të varur nga këto shpikje të kohës sonë!

Televizioni paraqet medium nga i cili "konsumojmë" në mënyrë të gatshme 24 orë! Shumica e njerëzve mendojnë se pa të, do të ishin tërësisht të izoluar nga bota në të cilën të gjithë - fqinjët, kolegët, të afërmit - shikojnë televizion. Buletinet informative televizive "Nuk duhet lëshuar... Informohuni rreth... qëndroni në rend të parë... na ndihmoni me thirrjen tuaj"... etj., sugjerojnë, "se pa TV. mund të humbisni ndonjë informacion të rëndësishëm, zbavitjen më të mirë". Pastaj nuk gëzojmë lirinë për të sjellë vendim për mosshikimin e TV-së.

Në një vështrim tjetër këto fjali janë të lidhura edhe me përdorimin e kompjuterit. Ky është medium që krijon qëndrime të reja shoqërore, duke nxjerrë në sipërfaqe mënyra të

ndryshme të të menduarit. Sot është shtëpi e shumë familjeve njëkohësisht, madje, edhe vendi i punës së tyre, sepse ajo që punohet në kompjuter mund të punohet në çdo vend.

Me varësi nuk nënkuptohet vetëm droga, alkooli, nikotina, kafeja, të varur mund të jemi në çdo gjë tjetër -

ritualet ditore, emocionet, po edhe në internet dhe videolojëra. Koha në të cilën industria e videolojërave në mënyrë drastike po rritet është kryesisht nga ata që ngelin rëndë të varur nga lojërat. Të fundosur në botët paralele, në të cilat mund të bëhet çdokush dhe gjithkush. Në lojëra mund të bëhesh ai që shtie me armë, lufta me egërsira, ndodhitë më të vërteta virtuale... Fëmijët janë të vendosur mirë nëpër karrige dhe të shkëputur nga bota reale, në mënyrë më ideale. Ai izolim i përzier, siguri dhe zbavitje rezultojnë në të ashtuquajturën "ekstreme", d.m.th. plotësisht i ndarë nga realiteti. Në këtë rast,

flasim për një shembull klasik të varësisë ndaj lojërave.

Kompjuteri e mbërthen fëmijën pas karriges, ia kufizon gjerësitë e jetës në një hapësirë ndërmjet ekranit (monitorit) dhe tastierës, paralizon gjitha ndjenjat tjera, shkëput kontaktet, shpirti i fëmijës kufizohet në kornizën e pyetjeve dhe përgjigjeve që sillen rreth programit dhe programimit.

Mos u bëni shumë kritik ndaj kureshtjeve fëmijërore - fëmija hulumton internetin dhe mund të përfundojë në ueb-faqet me përmbajtje problematike (pornografike, raciste); mos harroni se është e natyrshme të bëhesh kureshtar, kjo është një nga karakteristikat kryesore të fëmijës, është e nevojshme të bisedohet rreth këtyre çështjeve, duke vendosur rregulla të qarta.

Mes dy zgjedhjeve, mes TV-s apo kompjuterit, përparësi i jepet këtij të fundit. Ai gjatë aktivizimit pushton mendjen e fëmijës. Çka do të thotë se fëmija duhet të kalojë vetëm një orë në kompjuter. Me rëndësi është t'iu largohet kompjuteri në kombinacion me televizionin. Dalja e rrezatimit nga të dy ekranet sigurisht dëmton shikimin, fëmija vdes mentalisht dhe tërë ditën nuk bën asnjëfarë lëvizje përpos se klikon mausin dhe pultin e telekomandës.

Shkencëtarët mendojnë se fëmija duhet të rritet me kompjuteristikën, me qëllim që të mësohet dhe t'i përshatatet përdorimit të kësaj makine, e cila jep më tepër siguri në të ardhmen dhe, me fort gjasa, do të jetë gjëja më e përdorshme. Është e nevojshme që hapat e para në lojërat me kompjuter fëmija t'i bëjë me ndihmën e prindit. Është me rëndësi që prindi të jetë i pajisur me njohuritë bazë në lëmin e informatikës, që të ndikojë në këtë teknologji të fëmijëve.

Hulumtimet e bëra në SHBA të 2000 personave, me moshën ndërmjet 8-18 vjet kanë treguar se 83% prej tyre kanë në shtëpi së paku një videolojë, 31% kanë tre a më shumë (videolojë), 49% kanë videolojë në dhomën e fjetjes, në këtë hulumtim 21% kanë deklaruar se prindërit e tyre vendosin rregulla se cilat lojëra mund t'i luajnë, kurse 17% prindërit përcjellin "shenjat e agresivitetit", 12% luajnë lojëra për të cilat prindërit nuk japin pëlqimin e tyre. Të dhënat e shënuara janë marrë nga tregjet amerikane, ku janë shprehur qartë kufizimet dhe ligjet; mirëpo, megjithatë, arrihet të bëhen lëshime. Përderisa në vendet

tona nuk ka kurrfarë përkufizimi dhe rregull ligjor. Shumica e audio dhe video lexuesve (CD-të) rezulton prodhim joligjor, është produkt i të ashtuquajturës pirateri. D.m.th. askush nuk jep të dhëna se kush dhe në çfarë mënyre prodhohen videolojëra, se a janë vallë të përshtatura për fëmijë të moshave të ndryshme!

### **Arsyet që i detyrojnë fëmijët të luajnë më videolojëra**

- zbavitje;
- ndjenjat e kontrollit që ua mundësojnë lojërat;
- lirimi nga brengat;
- ikje nga monotonia;
- përvetësimi i aftësive për të luajtur;
- lindja e ndjenjës për të zotëruar.

### **Anët pozitive e të luajturit me videolojë**

- njohja e fëmijës me kompjuterin dhe aksesorët e tij;
- ushtrimi i aftësive në varësi nga llojet e lojërave, duke qenë se ato mund të jenë aftësitë e ardhshme;
- zgjidhja e problemeve dhe logjika për përvetësimin e aftësive motorike;
- mundësia për të luajtur së bashku prindi dhe fëmija;
- lojërat janë zbavitëse;

### **Anët negative e të luajturit me videolojëra**

- luajtja e tepërt me lojëra dërgon deri te izolimi shoqëror;
- lojërat me dhunë janë shumë më të dëmshme sesa shikimi pasiv i dhunës në TV;
- gratë zakonisht tregohen si figura të dobëta, të pandihmuara dhe seksualisht provokative;
- rrethi (hapësira) në lojëra zakon-

isht është rreth i përmbushur me sjellje të dhunës, agresivitet dhe provokime seksuale;

- shumë lojëra ofrojnë arenë të armëve, vrasjeve, dhe të shtënave;

- luajtja e lojërave me përmbajtje dhune shkakton sjellje të dhunshme, aq më tepër që fëmijëve që u ekspozohen, janë në vitet e hershme të jetës së tyre;

- shumë lojëra nuk ofrojnë aksione që kërkon pavarësi apo që mendon në mënyrë kreative;

- lojërat mund të shkaktojnë konflikt (huti) mes realitetit dhe fantazisë;

- në shumë lojëra të dhunës, lojtarët bëhen edhe më shumë të përdhunshëm, me qëllim që të dalin fitues; lojtarët që luajnë lojëra "në veten e parë" mund të jenë shumë më të zënë meqë e mendojnë lojën sikur ai vetë të jetë lojtari;

- aktivitetet shkollore mund të ngecin për shkak të humbjes së kohës në videolojëra.

Fëmijët janë imitues të shkëlqyeshëm. Ata mësojnë sjellje të atilla që shpërblehen, po edhe nëse është fjala për sjellje të dhunshme. Hulumtuesit kanë treguar se fëmijët janë agresivë përderisa u janë ekspozuar shikime të dhunës në TV, ose videolojëra. Dënimi duhet kryer

vetëm atëherë kur jemi të sigurt se masa ndëshkuese do të ndikojë pozitivisht dhe assesi në raste kur fëmijës i prishet personaliteti i tij fëmijëror. Edhe pse sjellja e dhunshme në një mënyrë duhet ndëshkuar, dhe atë në situata kur dëshirojmë që dikë ta dëmtojmë apo t'i shkaktojmë dëm.

Videolojërat të cilat promovojnë dhunën kanë efektin sikur të jenë skenar, ashtuqë fëmija kur të sillet në situata të tilla të shprehet agresiv. Në çdo lojë ekziston personi dominues, që është i fuqishëm, ngase vetëm në këtë mënyrë mund të fitojë armikun. Goditjet, të shtënat nga armët dhe vrasjet janë të përshkruara në çdo videolojë në formë pamjesh. Çdo lëvizje është planifikuar që më parë. Teknika e kohës bashkëkohore ka përparuar edhe në këtë fushë.

### Këshilla për prindërit

1. Argëtohuni së bashku me fëmijët - (është e dobishme që prindi dhe fëmija së bashku të hulumtojnë internetin); kështu që mund të ndërtoni besim të ndërsjellë mes njeri-tjetrit dhe do ta orientoni lehtë fëmijën tuaj në faqet e caktuara të internetit.

2. Bisedoni me fëmijën rreth internetit - gjatë bisedës do të pikasni lehtë se cilat ueb-faqe para-

Televizioni paraqet medium nga i cili "konsumojmë" në mënyrë të gatshme 24 orë! Shumica e njerëzve mendojnë se pa të, do të ishin tërësisht të izoluar nga bota në të cilën të gjithë - fqinjët, kolegët, të afërmit - shikojnë televizion. Buletinet informative televizive "Nuk duhet lëshuar... Informohuni rreth... qëndroni në rend të parë... na ndihmoni me thirrjen tuaj"... etj., sugjerojnë, "se pa TV mund të humbisni ndonjë informacion të rëndësishëm, zbatimjen më të mirë". Pastaj nuk gëzojmë lirinë për të sjellë vendim për mosshikimin e TV-së.

pëlqen fëmija yt, se çfarë shfaq interes për ta dhe çfarë e zbavit.

3. Zhvilloni bon ton të internetit - në komunikimin përmes internetit ekzistojnë rregulla të caktuara rreth sjelljeve të mira; mësoni fëmijët të sillen në atë mënyrë siç do të kishin dashur që të tjerët të silleshin ndaj tyre.

4. Bisedoni rreth përdorimit të internetit dhe kohëzgjatjen e lojës - cilat faqe duhet vizituar, si të komunikohet përmes postës elektronike. Kalimi i gjatë i kohës në internet duhet të jetë në suaza e parametra të logjikshme, kështu që fëmijës s'duhet t'i lëshohet në gjërat që janë me rëndësi.

5. Mësoni fëmijët të ruajnë informacionet personale - shumë ueb-faqe kërkojnë të dhëna personale; tregojini se si duhet vepruar; ato janë informacione për shkak të sigurisë; nevojitet të kërkohet që, në informacionet personale, mos të ketë kyçje pa lejen tuaj.

6. Mos lejoni të komunikojë me njerëz të panjohur në internet - interneti është vend i komunikimeve virtuale dhe fëmijët shpesh i vizitojnë ato, dhe kështu bëhen njohje të reja; për t'i ikur situatave të padëshirueshme dhe të rrezikshme, është me rëndësi që fëmijët t'i mësojmë të mos komunikojnë me njerëz të panjohur pa praninë e ndonjë anëtari të familjes.

7. Shpjegojini fëmijëve tuaj se informacionet në internet jo çdo herë janë

Në vendet tona nuk ka kurrfarë përkufizimi dhe rregull ligjor. Shumica e audio dhe video lexuesve (CD-të) rezulton prodhim joligjor, është produkt i të ashtuquajturës pirateri. D.m.th. askush nuk jep të dhëna se kush dhe në çfarë mënyre prodhohen videolojëra, se a janë vallë të përshtatura për fëmijë të moshave të ndryshme!

të vërteta - shpesh interneti përdoret për të zgjidhur detyra, për të mbledhur informacione të nevojshme për mësim, sasia e informacionit është e bollshme, andaj është me rëndësi të bëhet selektim i drejtë i përmbajtjeve.

8. Mos u bëni shumë kritik ndaj kureshtjeve fëmijërore - fëmija hulumton internetin dhe mund të përfundojë në ueb-faqet me përmbajtje problematike (porno-grafike, raciste); mos harroni se është e natyrshme të bëhesh kureshtar, kjo është një nga karakteristikat kryesore të fëmijës,

është e nevojshme të bisedohet rreth këtyre çështjeve, duke vendosur rregulla të qarta.

9. Zgjidhja teknike mund të ndihmon në përdorimin e internetit - përdorimi i disa mjeteve (soft-programeve) të caktuara për të loguar në browser (kërkuar në internet) mundëson pengimin e surfimit në ueb-faqet me përmbajtje të dyshimta.

10. Bisedoni rreth zgjedhjes së lojërave - lojërat kompjuteristike janë interesante për fëmijët; janë të llojeve të ndryshme: pedagogjike, aksione, të dobishme, po edhe të atilla me agresivitet dhe dhunë; është e nevojshme që prindi dhe fëmija të zgjedhin së bashku lojën që do ta ndihë këtë të fundit të zhvillojë ndjenjat motorike, aftësinë, dhe kujtesën.

# Rregullat e emërtimit të fëmijës

**Përgjigjet: Bekir HALIMI**

## Pyetjet:

Dëshiroj të emërtoj fëmijën tim, cilët janë rregullat islame në lidhje me këtë?

A ka emra të ndaluara fetarisht, me të cilat nuk lejohet emërtimi?

Kam nevojë për disa emra të mirë dhe të bukur për fëmijën tim?

A është problem nëse e emërtoj fëmijën tim Muhamed?

**Përgjigjja** e këtyre pyetjeve është si vijon:

Allahun e falënderojmë. Paqja dhe lavdërimi qofshin mbi Muhamedin, salAllahu alejhi ve selem...

Fillimisht duhet ta dimë se fëmijët janë dhuratë nga Allahu, subhanehu ve teala, me të cilën i ka begatuar prindërit dhe u ka caktuar karshi tyre detyra dhe obligime të mëdha, të cilat fillojnë me zgjedhjen e emrit të mirë.

S'ka dyshim se çështja e emërtimeve është me rëndësi në jetën e njerëzve, pasi që emri është titulli i atij që bartë emrin, udhërrëfyes për personalitetin e tij dhe domosdoshmëri për mirëkuptimin me të. Emri për atë që e bart është stoli dhe simbol me të cilin do të thirret në dynja dhe ahiret, aludon në fe, tregon fetarizmin e njeriut, kurse për njerëzit emri është sikurse petku, nëse është i gjatë është i shëmtuar dhe nëse është i shkurtër është i shëmtuar.

Për këtë prindërit duhet të zgjedhin emër të mirë për fëmijën e tyre, ky emër nuk duhet të jetë i huaj në mesin dhe shoqërinë ku jeton, sepse nëse emri është i huaj mund të bëhet kjo gjë shkak

A H S U S E J O N A H Y A S E  
G M T O A S O L O M O N R J O  
B W I E H D Y L L N A H E O M  
O E E R S D I E E U S O H H B  
A H U M I E T Z L I K S T N D  
Z T T A L A M E K E N E S E A  
H T H D E U M K R R H A E T V  
H A I A H A P I N I A C D N I  
N M H A I P E E S R C M A E D  
C I N P G M V L T O I O E R I  
N O A H E G E T O E M Z M J S  
U U S L O S A R I I R A O A A  
L S E S O M O H E A B E L M I  
N O S M A S N J T J M E A E A  
J M A R Y N T B O C A J S S H

për tu tallur me këtë emër apo me atë që e bart këtë emër, e ndoshta kompleksohet njeriu nga ky emër dhe i vjen turp ta përmendë emrin e vet para njerëzve.

Tek emrat dhe emërtimi çdo gjë është e lejuar përpos disa vërejtjeve fetare të cilat duhet t'i kemi parasysht:

a. Emrat mos të japin kuptim të robërimit të dikujt tjetër përpos Allahut, sikurse emrat: abduresul, rob i Resultit, abduhusjen, rob i Husjenit, Abdul-Uza, rob i Uzasë, Abdul-Kabe, rob i Qabes, etj. emra të cilat shfaqin adhurim të dikujt tjetër përpos Allahut. Këto emra duhet ndryshuar menjëherë, vet ai i cili i mban këto emra, apo ata që e kanë emërtuar.

Abdurahamn ibën Aafi, radijallahu anhu, na rrëfen dhe thotë:

"Emrin e kisha Abdu Amër, në një transmetim tjetër: Abdul-Kabe, e kur hyra në Islam, Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, më emërtoi



Abdurahman". (Transmeton Hakimi).

b. Emërtimi me emra të veçantë të Allahut, subhanehu ve teala, sikurse të emërtohet me El-Halik, Krijues, ose Er-Razik, Furnizues, ose El-Kudus, I Shenjtë, ose Er-Rab, Zot, apo Er-Rahman, Mëshirues dhe emra tjerë të veçantë të Allahut, apo me emra tjerë, përshkrimi me të cilat nuk i përkasin me të drejtë askujt tjetër përpos Allahut, tebareke ve teala, sikurse janë Melikul-Muluk, Mbret i mbretërve, El-Kahir, etj. Ndalohet emërtimi me këto emra dhe duhet ndryshuar ato.

Allahu, azze ve xhel-le, thotë:

"...A di për Të ndonjë emnak (adash)?" (Merjem: 65).

Imam ibën Kajimi, rahimehullah, prej emrave që janë të veçantë për Allahun i përmend këto: Allah, er-Rahman, El-Hakem, El-Ehad, Es-Samed, El-Halik, Er-Rezak, El-Xhebar, El-Mutekebir, El-Evel, El-Ahir, El-Batin, Al-lamul-Gujub.

Prej argumenteve që ndalojnë emërtimin me emra të veçantë të Allahut, sikurse është emri Melikul-Muluk, Mbret i mbretërve, është hadithi të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre, radijallahu anhu, se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë:

"Emri më i poshtër te Allahu në Ditën e Kiametit është njeriu që ka quajtur veten Mbret i mbretërve, melikul-Muluk". (Buhariu), kurse në transmetimin e Imam Muslimit qëndron:

Emri për atë që e bart është stoli dhe simbol me të cilin do të thirret në dynja dhe ahiret, aludon në fe, tregon fetarizmin e njeriut, kurse për njerëzit emri është sikurse petku, nëse është i gjatë është i shëmtuar dhe nëse është i shkurtër është i shëmtuar.

"Njeriu më i urreyer te Allahu në Ditën e Kiametit, njeriu më i prishur dhe më i urreyer është njeriu që quan veten Mbret i mbretërve, ndërkohë vetëm Allahu është mbret".

Kurse emërtimi me emra të përbashkët, të cilat i jepen Allahut dhe tjerëve, lejohet të emërtohen me to edhe njerëzit, sikurse është emri Alij, i Lartë, Latif, i Butë dhe Bedi, Shpikës.

Haskefiu, rahimehullah, thotë: "Domethënia e këtyre emrave dallon për ne në krahasim me atë që bartin për Allahun".

c. Emërtimi me emra të veçantë të qafirave, të cilat aludojnë vetëm në ta, sikurse është Adhurues i Jezusit, Adhurues i Palit, etj.

d. Emërtimi me emra të idhujve dhe statujave që adhurohen përpos Allahut, sikurse është emërtimi me shejtan, hanzeb, etj.

e. Emërtimi me emra që nuk i takojnë askujt tjetër përpos Pejgamberit, salAllahu alejhi ve sel-lem, sikurse është emri Sejidun-Nas, Zotëriu i mbarë njerëzimit, Sejidul-Kul, Zotëriu i të gjithëve, etj.

Krejt këto lloje të emërtimeve nuk lejohen dhe janë të ndaluara, kurse ai që ka këso emrash apo e kanë emërtuar kështu, duhet t'i ndryshojë.

### Emërtimet e urreyera

e. Emërtimi me emra që natyra e njeriut i urren domethënien për shkak se kanë domethënie të keqe apo tallje

dhe janë në kundërshtim me udhëzimin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ve selem, sikurse është emri Luftë, Automatik, Sëmundje, etj.

f. Emërtimi me emra që bartin domethënie të epshit apo dashurisë. Këto emra zakonisht i bartin femrat.

g. Emërtimi me emra të mëkatarëve dhe jobesimtarëve prej aktorëve, këngëtarëve etj. Nëse vetë emrat kanë kuptim të mirë, lejohet të emërtohet njeriu me to, mirëpo jo pse i bartin ata njerëz të caktuar, por për shkak të domethënies së tyre.

h. Emërtimi me emra që bartin domethënie të gabimit dhe mëkatit, sikurse Hajn, Zullumqar, Faraon, Karun, etj.

j. Emërtimi me emra të kafshëve që posedojnë cilësi të ulëta, sikurse janë emrat Gomar, Qen, Majmun, etj.

k. Emërtimi me çdo emër që i vishet Islamit dhe Fesë, sikurse është emri Nurudin, Shemsudin, Nurul-Islam etj, sepse me këto emërtime i jepet njeriut status më të lartë sesa e meriton. Edhe nofkat e këtilla i kanë urreyer dijetarët sikurse ka qenë rasti me Imam Neveviun, të cilin e kanë emërtuar Muhjidin, apo Ibën Tejmiun, të cilit i kanë dhënë nofkën Tekijudin.

l. Emërtimi me emrat e melekëve, apo me emrat e sureve të kuranit, sikurse Jasin, apo Taha. Këto emra janë shkronja të shkurtuara e jo emra të Pejgamberit, salAllahu alejhi ve selem.

m. Emërtimi me emra që bartin lavdërim apo shfajësim, sikurse është emri i devotshëm, bamirës, adhures, etj. Shiko "Tesmijetul-Meulud", Bekër

Ebu Zejd, fq. 20- 21.

Emrat e urreyer nuk duhet t'i emërtojmë fëmijët me to, kurse nëse një njeri ka emër të këtyllë, është rritur me këto emra dhe e ka vështirë ta ndryshojë, ai nuk e ka obligim ndryshimin e tyre.

### Kategoritë e emrave

Grada e parë: Emri Abdullah dhe Abdurrahman. Sepse Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Emrat më të dashur tek Allahu janë: Abdullah dhe Abdurrahman". (Muslimi).

Grada e dytë: Emrat tjera që fillojnë me abd, që domethënë rob dhe përfundojnë me ndonjë emër të Allahut, sikurse Abdul-Aziz, Abdur-Rahim, Abdul-Melik, Abdul-Ilah, etj.

Grada e tretë: emrat e pejgambereve, alejhimusselam. Ska dyshim se më i miri në mesin e tyre është Muhamedi, salAllahu alejhi ve selem, kurse prej emrave të tij është edhe emri Ahmed, pastaj emrat e pesë pejgamberëve të dalluar, Ibrahim, Musa, Isa dhe Nuh, alejhimusselam, e pastaj pejgamberët tjerë.

Grada e katër: Emrat e njerëzve të devotshëm, në krye të të cilëve janë sahabët e nderuar, andaj është vepër e pëlqyeshme të bartim emrat e tyre në shenjë pasimi të tyre dhe duke kërkuar fitim të gradave të larta.

Grada e pestë: Çdo emër i mirë dhe që ka kuptim të saktë dhe të bukur.

*(vazhdon në numrin e ardhshëm...).*

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në [albislam@gmail.com](mailto:albislam@gmail.com)



# Besimi në kader 2/2

shkruan: Agim BEKIRI

## 8. Të pajtuarit me caktimin e Allahut:

Duhet të pajtohemi më kaderin e Allahut, sepse kjo ka të bëjë me pranimin e pushtetit të gjithmbarshëm të Allahut, azze ve xhel. Nga ana tjetër, veprimi i Allahut, është drejtësi i tëri dhe urtësi. Kush bindet se ajo që i ka ndodhur s'ka pasur mundësi të mos i ndodhë dhe ajo çka s'e ka arritur s'ka pasur mundësi ta arrijë, shpëton nga mëdyshjet dhe konfuzionet e ndryshme. Dëshpërimi dhe parregullsia largohen nga jeta e tij. Ai bëhet njeriu më i lumtur dhe më i qetë. Kush e di se e ka jetën të kufizuar, të caktuar me afat, sikundërse edhe furnizimin e tij; kushdo që kupton se frika nuk ia shton jetën dhe as koprracia pasurinë, dhe se çdo gjë është e shkruar, një njeri i tillë bën durim në gjërat që i ndodhin, kërkon falje për gabimet, pajtohet me caktimin

e Allahut, e në këtë mënyrë bashkon respektimin e urdhrave dhe durimin në fatkeqësi. Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Çfarëdo e keqe që ndodh (godet), nuk mund të jetë ndryshe, vetëm sipas caktimit të Allahut, e kush i beson Allahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij; Allahu është i gjithëdijshëm për çdo send." (Tegabun, 11) Poashtu thotë: "Ti bën durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë, kërko falje për mëkatin tënd, lartësoje me falënderim Zotin tënd mbremje e mëngjes." (Gafir, 55)

## 9. Udhëzimi është dy lloje:

Lloji i parë: udhëzimi që nënkupton orientimin kah e vërteta. Ky lloj udhëzimi është për të gjitha krijesat dhe është në mundësinë e pejgamberëve dhe pasuesve të tyre. Allahu, subhanehu ve

teala, thotë: "Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugën e drejtë." (Shura, 52)

Lloji i dytë: udhëzimi që nënkupton pranimin dhe bindjen në të vërtetën. Ky lloj udhëzimi është në dorë të Allahut, është udhëzimi me të cilin Ai nderon robërit e tij të devotshëm. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit." (Kasas 56)

#### 10. Vullneti i Allahut është dy lloje:

Lloji i parë: vullneti kosmologjik, që përfshin çdo ekzistencë. Ajo që Allahu ka dashur ka ndodhur, ajo që s'ka dashur s'ka ndodhur. Ky vullnet patjetëron ekzistencën e asaj që Allahu dëshiron mirëpo s'është e thënë që ta dojë atë. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë." (En'an, 125)

Lloji i dytë: vullneti legjislativ, që nënkupton dashurinë ndaj asaj që Allahu e ka dëshiruar. Kjo nuk do të thotë që patjetër të ndodhë përpos nëse ka të bëjë me vullnetin kosmologjik. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju." (Bekare,

"Besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se besimtari i dobët edhe pse në çdonjërin ka hair. Kujdesu për atë që të bën dobi, kërko ndihmë prej Allahut dhe mos humb durimin. Nëse të godet diçka mos thuaj: sikur të veproja kështu do të ishte ashtu, mirëpo thuaj: e ka caktuar Allahu, Ai bën ç'të dojë, sepse fjala "sikur" i hap dyert e shejtanit."

185)

Vullneti kosmologjik është më i gjerë sesa ai legjislativ, sepse çdo vullnet legjislativ që ka ndodhur është edhe vullnet kosmologjik. Nga ana tjetër, çdo vullnet kosmologjik që ndodh nuk do të thotë se është edhe legjislativ. Imani i Ebu Bekrit, për shembull, është realizim i dy vullneteve, kurse kufri i Ebu Xhehlit është realizim vetëm i vullnetit kosmologjik. Pra, shembull për mosrealizimin e vullnetit kosmologjik edhe pse është legjislativ është imani i Ebu Xhehlit.

Edhe pse vullneti i Allahut ishte që të ketë mëkate, ai këto nuk i do, nuk i pëlqen

dhe nuk urdhëron në to, porse i urren, i ndalon dhe i kërcënohet vepruesit të tyre. E gjithë kjo është kaderi i Tij. Imani dhe veprat e mira janë të urdhëruara nga Allahu, subhanehu ve teala. Ai i do, urdhëron në to dhe vepruesit të tyre i premton shpërbllim dhe xhennet. Allahu, subhanehu ve teala, nuk kundërshtohet edhe përkundër vullnetit të Tij sepse nuk mund të ndodhë pos asaj që Ai e dëshiron. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet" (Zumer, 7), "E Allahu nuk e do çrregullimin (fesadin)". (Bekare 205)

#### 11. Shkaqet e ndryshimit të kaderit:

Allahu, subhanehu ve teala, bëri që caktimet e Tij të ndryshohen me lutje, lëshoshë, barna, kujdes, vendosmëri,

ngase të gjitha këto në fakt janë caktime të Allahut, madje, edhe paaftësia dhe zotësia.

## 12. Kaderi është fshehtësia e Allahut te krijesat e Tij:

Thënia se kaderi është fshehtësia e Allahut te krijesat e tij kufizohet vetëm në aspektin e fshehtë të kaderit. Gjerat në esencën e tyre nuk i njeh kush përpos Allahut, subhanehu ve teala. Njerëzit këtë nuk mund të perceptojnë siç është devijimi i ndonjërit, udhëzimi i tjetrit, vdekja, dhënia e jetës, privimi, dhënia e tjerë. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "kur të përmendet kaderi heshtni" (Muslimi)

Sa i takon aspekteve tjera, urtësive të mëdha të kaderit, gradat e tij, gjurmët dhe efektet, të gjitha këto lejohet të sqarohen dhe të studiohen, ngase kaderi është një prej shtyllave të imanit, që obligohemi ta mësojmë siç tha Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, kur ia përmendi Xhibrilit shtyllat e imanit: "erdhi t'ua mësojë fenë tuaj."

## 13. Arsyetimi me kader:

Dija se ç'do të ndodhë në të ardhmen është e fshehur dhe nuk e di askush përpos Allahut, subhanehu ve teala. Asnjëri nuk mund të arsyetojë me të ashtu siç nuk mund të lihen veprat për shkak se gjithçka është caktuar. Kaderi nuk është argument për asnjë krijesë kundër Allahut, në të kundërtën, asnjë kriminel s'do të dënohej, asnjë ligj s'do të aplikohet dhe shkatërrimi s'do të pengohet.

Atij që arsyeton me kader i themi: ti nuk e di nëse do të jesh prej banorëve të Xhennetit apo xhehnemit. Sikur ta dije, nuk do të të ngarkonim me obligime, për këtë puno se ndoshta Allahu do të udhëzojë që të jesh prej banorëve të

xhennetit. Disa as-hab, kur dëgjuan hadithet e kaderit thanë: tani edhe më shumë do të përpiqem të punoj.

Kur Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u pyet për arsyetimin me kader tha: "punoni se çdonjërit i lehtësohet ajo për të cilën është krijuar. Kush është me grupin e të lumturve do t'i lehtësohen veprat e të lumturve e kush është me grupin e të dëshpëruarve do t'i lehtësohen veprat e të dëshpëruarve, pastaj lexoi: "E, sa i përket atij që jep dhe ruhet, Dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatitim atë për më të lehtë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti), Dhe që përgënjeshton atë më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën." (Lejl 5-10)

## 14. Veprimi i shkaqeve:

Gjërat që mund t'i ndodhin njeriut janë dy lloje: gjëra që mund t'iu ikë dhe nuk është i paaftë para tyre, dhe gjëra që s'mund t'iu ikë dhe duhet bërë durim. Allahu, subhanehu ve teala, i di fatkeqësitë para se të ndodhin ato. Fakti që Ai i di ato nuk do të thotë që fatkeqin e ka determinuar në atë pozitë porse gjërat ndodhin për shkak parakushteve të caktuara. Nëse ato ndodhin për shkak lëshimeve të njeriut, atëherë ai qortohet. Nëse nuk ka fuqi për t'iu kundërvënë këtyre shkaqeve atëherë nuk qortohet.

Veprimi i shkaqeve nuk bie ndesh me kaderin dhe tevekulin (mbështetjen në Allahun), madje është pjesë e besimit në kader, mirëpo kur të ndodh kaderi atëherë obligohemi të pajtohemi dhe të dorëzohemi, t'i kthehemi fjalës: "e ka caktuar Allahu, Ai bën ç'të dojë". Në anën tjetër, para se të ndodhë kaderi

obligohemi t'i veprojmë shkaqet e ligjësuara. Pejgamberët i kanë vepruar shkaqet për t'u mbrojtur nga armiku edhe pse ata kanë pasur përkrahjen e Allahut. Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, i vepronte shkaqet edhe pse kishte mbështetje të fuqishme në Allahun, azze ve xhel. Allahu, azze ve xhel, thotë: "E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhetojnë) e me të, (me përgatitje), ta frikësoni armikun e

Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata. Çkado që shpenzoni për rrugë të Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë." (Enfal, 60) "Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, meqë vetëm te Ai është e ardhmja." (Mulk, 15)

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "besimtari i fuqishëm është më i mirë dhe më i dashur tek Allahu se besimtari i dobët edhe pse në çdonjërin ka hair. Kujdesu për atë që të bën dobi, kërko ndihmë prej Allahut dhe mos humb durimin. Nëse të godet diçka mos thuaj: sikur të vepra kështu do të ishte ashtu, mirëpo thuaj: e ka caktuar Allahu, Ai bën ç'të dojë, sepse fjala "sikur" i hap dyert e shejtanit." (Muslimi)

### 15. Vendimi i shariatit për atë që e mohon kaderin:

Ai që mohon kaderin ka mohuar një themel të rëndësishëm të shariatit dhe

. Gjerat në esencën e tyre nuk i njeh kush përpos Allahut, subhanehu ve teala.

Njerëzit këtë nuk mund të perceptojnë siç është devijimi i ndonjërit, udhëzimi i tjetrit, vdekja, dhënia e jetës, privimi, dhënia e tjerë.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, thotë: "kur të përmendet kaderi heshtni"

me këtë ka bërë kufër. Disa prej selefit kanë thënë: dabatoni me kadirijtë rreth diturisë së Allahut, nëse e mohojnë, bëjnë kufër, nëse e pranojnë e humbin debatin.

### 16. Frytet e besimit në kader:

Besimi në kader jep fryte të rëndësishme për tërë popullin apo individin, prej tyre:

a) rezulton me adhurime të ndryshme dhe virtyte të larta siç

janë: sinqeriteti në Allahun, mbështetja në Të, frika, shpresa, mendimi i mirë, durimi, luftimi i dëshpërimit, pajtimi që Allahu të jetë Zot, falënderimi, modestia për hir të Tij, lënia e mendjemadhësisë, shpenzimi në rrugë të Allahut, trimërinë, kënaqja me atë që posedon, ambicie të larta, serioziteti në punë, mesataria në skamje dhe bollëk, shpëtimi nga hasedi, qetësia e shpirtit dhe zemrës e tjerë.

b) Ai që beson në kader është mesatar në jetën e tij, nuk e mashtron pasuria, nuk e dëshpëron skamja. Është i bindur se fatkeqësia që e ka goditur me caktimin e Allahut është sprovë, nuk e humbë durimin përkundrazi shpreson të shpërblehet.

c) Mbrohet nga devijimi dhe përfundimi i keq sepse vazhdimisht përpiqet për të qenë në rrugë të drejtë.


d) E bën besimtarin të fuqishëm në përballimin e fatkeqësive dhe vështirësive të kësaj bote.

# Prezantim i librit "Kushtet e fesë"

**Shkruan: Ahmed KALAJA**

**F**alënderimet i takojnë Allahut, Krijuesit, Furnizuesit, të Gjithëpushtetshmit, Mbajtësit të qiejve dhe tokës, Zotit të dynjasë dhe ahiretit e ç'ndodhet mes tyre. Mëshira e Tij, mirësitë dhe lëvdatat qofshin mbi të dashurin e tij Muhamedin dhe mbi të gjithë ata që ndjekin dhe pasojnë rrugën dhe udhëzimin e skicuar nga Ai për mbarë njerëzimin deri në ditën e Gjyqit të madh.

I delirë nga çdo e metë është Allahu, i Cili për çdo kohë ka sjellë prej njerëzve kolosë që kanë përtërirë fenë e Allahut, duke përjetuar kështu ymeti herë pas here mrekullinë e zbatimit të profecisë së Muhamedit, salallahu alejhi ue selem, kur na lajmëron për përtëritësit e fesë, të cilët Allahu i dërgon çdo shekull në këtë ymet. Pa më të voglin dyshimin, një prej tyre ka qenë dhe dijetari ynë i madh, shembulli jetik i Islamit të munguar, njeriu i aspi-



ratave të larta, i karakterit të përsosur, i njeriut aktiv, mendimtarit në çështjet e fesë, njohësit të situatave, menaxhuesit të përkryer të rasteve tipike, mësuesi ynë prindi Muhamed b. Salih el Uthejmin, Allahu e mëshiroftë, që me largimin e tij nga kjo botë preku zemrat dhe lagu sytë.

Nuk mund të rri pa folur pak për jetën e shejhut, e këtij dijetari, përpara se të futem në detajet e shqyrtimit të librit. Duke u mbështetur në referenca që trajtojnë jetën e tij, por dhe diçka nga jeta në mësimet e tij, që i kam përjetuar vetë .

Thirrej Ebu Abdullah, ndërsa emri i tij ishte Muhamed, i lindur më 27/Ramazan/1348 h, në Unejzeh, qytezë e Kasimit, krahinë e njohur në Arabinë Saudite. Qyshse në vegjëlinë e tij u dallua për mençuri, mprehtësi dhe vullnet të lartë. Mësoi Kur'anin përmendësh qysh i vogël, dhe shumë tekste bazë në

lëmi të ndryshme ashtu siç thoshte dhe vetë "Kush mëson tekste bazë di të arrijë majat e larta" si vetë ai. Në vitin 1360 h filloi të ulej në tubimet e dijetarëve, siç ishte ajo me dijetarin e madh B. Sa'din pesë vitet e fundit të jetës së tij dhe, padyshim, kjo ka qenë një prej shkaqeve kryesore në formimin e shejhut, si dhe një prej gjërave të bukura që ky ka jetuar, pasi kjo ka qenë me insistimin e vetë shejh Sa'dit; duke qenë se i ati deshi ta ndalojë nga kërkimi i dijes për efekt punësh në të mbjella, vetë profesori i madh Sa'di flet me të atin ta lërë të lirë, se pati vënë re tek ai cilësi që nuk i gëzonin të tjerët.

### **Virtytet e shejhut .**

Sinqeriteti, çiltërsia, refuzimi i dynjasë mund të jetë përmbledhja e cilësive të tij. Urdhërues për të mirë, ndalues për të keqen, këshillues, i çelur në fytyrë, kënaqej me fëmijët, harrohej kur u jepte ose i jepnin muhabet. Modestia dhe thjeshtësia ishin rrobat e tij, ja një nga shumë rastet; kur po kthehej një ditë nga xhamia pa një rreth të madh sigurie, policie rreth shtëpisë së tij; kur deshi të afrohej i thanë: "Larg! Larg se mbreti ka ardhur të vizitojë shejh Utthejminin". "E po mirë atëherë, më lini të futem". "Jo, jo, e pamundur". "Po unë jam". S'ju besua atyre të ishte shejhu jashtë ndërkohë që mbreti po e priste në shtëpi se shejhu kishte shkuar të falej. Kur u bindën dhe njëkohësisht u habitën e lejuan me gojë hapur. Ndihamonte nevojtarët. Sigurohej kur i vinte ndonjë lajm pastaj gjykonte.

Prej mirësive të Allahut mbi kombin tonë ka qenë dhe përkthimi i këtij libri elegant të titulluar ne arabisht: "Fetava Erkanil Islam" - "Kushtet e fesë pyetje përgjigje", i përshtatur nga vëllezërit tanë të nderuar të shtëpisë botuese "Nun" me titullin "Kushtet e fesë", Allahu i shpërbleftë me të mira!

Arsyetonte me njerëzit, madje, edhe kur ishin ndryshe prej tij në gjykime; mbaj mend sesi në mësim thoshte p.sh: "Përrjashto rastin nëse ulematë (dijetarët) e vendit të tij i kanë dhënë fetva, se kjo gjë bëhet kështu atëherë le të gjykojë siç i kanë dhënë feta (gjykimin fetar) dijetarët e vendit të tij". E çuditshme, në kohën kur njerëzit futeshin tek ai, thoshte: keni kaq kohë në dispozicion siç ndodhi me ne njëherë në ramazan te vitit 1996, që kur mori vesh se ishim shqiptarë nga vendi i shejh

Albanit, vend që sapo kishte dalë nga monizmi, pas takimit na ftoi për iftar dhe padyshim ka qenë iftari më i mirë i jetës për ne, Allahu e mëshiroftë. Ishte dhe njeri i batutës dhe shakasë me karar, ai që ndiqte mësimet e tij e dëshmon këtë. Ringjallës i traditës së humbur Profetike. Respektues i ulemave të tjerë edhe pse ishin më poshtë tij në dije. Mikpritës dhe i dashur, që mos të harroj me një zë të bukur kumbues dhe të qartë.

Kujdesi në fe dhe dhënien e fesë ka qenë veçori e tij. E pyesin në një nga mësimet e tij për përdorimin e serumeve me glukozë dhe u përgjigj, mirëpo dikush ndërhyri dhe foli për të gjëra që kanë të bëjnë me shkencën dhe mjekësinë dhe shejhu tha: "Unë po tërhiqem sa të konsultohem me shejh Bin Bazin" dhe të nesërmen ju sjell gjykimin për të.

Besimi i tij ishte besimi i ehli Sunetit dhe gjatë gjithë jetës së tij ngulmonte ne metodologjinë e selefëve (gjeneratave të para) për çdo zhanër. Urrente të fletej për



njerëz me emra në mexhliet e tij dhe ndalonte provokimin e njerëzve për emra ose me emra. Prej profesorëve të tij ishin edhe shejh Bin Bazi, esh Shenkitj etj... Librat e tij janë mbi 100. Kaloi sëmundje të rëndë para vdekjes, çastet e fundit të jetës përsëriste ajetin e gjashtë dhe të shtatë të sures el Inshikak. Ka ndërruar jetë më 15/10/ 1421 h ose më 10/01/2001 në moshën 74 vjeçare. Xhenazja e tij është falur pas një dite në haremin e Qabes në prezencë të një numri të pallogaritshëm besimtarësh nga e gjithë bota, është varrosur pranë shejhut të tij Bin Baz. Allahu i mëshiroftë dijetarët e vdekur e i ruajtë ata që janë gjallë. E na bashkoftë me ata në botën tjetër në xhenetet e tij. Amin.

Ndoshta pak si gjatë, po jemi prekur më shumë se me të tjerët prej dijetarëve sepse me të kemi pat njohje dhe e kemi takuar, Allahu e mëshiroftë !

Prej mirësive të Allahut mbi kombin tonë ka qenë dhe përkthimi i këtij libri elegant të titulluar ne arabisht: "Fetava Erkanil Islam" - "Kushtet e fesë pyetje përgjigje", i përshtatur nga vëllezërit tanë të nderuar të shtëpisë botuese "Nun" me titullin "Kushtet e fesë", Allahu i shpërbleftë me të mira!

Autori i këtij vëllimi ose thënë më mirë kësaj përmbledhjeje Fehd b.Nasir es Sulejman është prej nxënësve të dijes dhe prej njerëzve të besueshëm të shejh Bin Uthejminut dhe ky është fakt

tepër i rëndësishëm në përcjelljen e fesë. Vihet re kjo në lejen e dhënë nga vetë shejh Muhamedi në fillim të librit me emër për të që mban firmën e shejhut dhe datën e lëshimit 1419 h ose më 1999.

Autori me pak fjalë në fillim të librit sqaron shkaku dhe shkrimin dhe përmbledhjes dhe njëkohësisht gatishmërinë e shejhut kur ka marrë vesh qëllimin e autorit.

Për rëndësinë e këtij libri mjafton titulli i tij, kushtet e Islamit - gjërat esenciale që duhet të dijet nga feja e tij çdo musliman. Rëndësia e këtij libri shfaqet në faktin se, një prej pyetjeve në varr do të jetë "Kush është feja jote". Të jesh i sigurt se, nëse ti nuk e ke ditur fenë në dynja, nuk ke për tu përgjigjur as në varr, sepse rregulla e pa kontestueshme fetarisht dhe logjikisht thotë "Shpërblimi është sipas sojit të punës".

Duke pasur parasysh literaturën e përkthyer deri më sot në gjuhën amtare, mbetet sado sado e varfër, them se ky libër duhet të jetë patjetër në qytyphanet (bibliotekat) tona. Dua të shtoj pa ngurrimin më të vogël se ky është një libër që i drejtohet të gjithëve. Prej të veçantave të këtij libri është thjeshtësia e shprehjeve dhe kjo është veçoria e të shkruarit të dijetarëve të ehli sunetit (pasuesve ). Gjithashtu ngopja me argumente për çdo detaj, elhamdulilah për mirësinë e udhëzimit në të drejtë. Në këtë libër do të gjejmë të shkoqitur të qartë çdo gjë që të nevojitet në fenë tënde.

Libri është i ndërtuar në

E çuditshme, në kohën kur njerëzit futeshin tek ai, thoshte: keni kaq kohë në dispozicion siç ndodhi me ne njëherë në ramazan të vitit 1996, që kur mori vesh se ishim shqiptarë nga vendi i shejh Albanit, vend që sapo kishte dalë nga monizmi, pas takimit na ftoi për iftar dhe padyshim ka qenë iftari më i mirë i jetës për ne, Allahu e mëshiroftë. Ishte dhe njeri i batutës dhe shakasë me karar, ai që ndiqte mësimet e tij e dëshmon këtë.

pesë kapituj.

Kapitulli i besimit - aty do të gjesh çdo gjë që të intereson për çështjet e besimit, më të rëndësishmet madje dhe detajet e vogla për dilema që ne i hasim në trojet tona, sikur shejhu të ketë jetuar në Shqipëri!

Kapitulli i dytë - namazi, e ku e di ti ç'është namazi?! Shtylla e fesë mbi të cilën pas teuhidit (njësimit të Allahut) ndërtohet feja e njeriut. Po sa paqartësi ka njeriu për këtë adhurim të shtrenjtë qysh nga pastrimi e deri te selami?! Këtu do të jetosh sikur të jesh duke e parë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem. Jo vetëm kaq, po dhe detaje të tjera për llojet e namazeve, gjendjet e falësve, statuset e tyre e kështu me radhë, për xhenazen etj... Madje aty shejhu është përgjigjur për disa çështje që ndoshta mund të ketë pasur probleme në vendet tona e gjen përgjigjen nga shejhu me qetësinë më të madhe dhe ngazëlluese, po kur gabon si duhet të veprojë aty do të gjesh përgjigje të detajuar.

Pasohet ky kapitull me një kapitull tjetër pikërisht atë të Zekatit që me të drejtë është cilësuar si shtylla më e panjohur e Islamit. Kur, ku, si, sa dhe pse, si bëhen llogaritë, në ç'sasi obligohet, po në vlef tën e sotme monetare si bëhen llogaritë, kujt i jepet, a ka detyrime, ku mund të harxhohet?! Po gjykimi mbi zekatin e fitrit, dispozitat e tij?! Aty do të gjesh përgjigjet, mjafton të shfletosh lib-

rin.

Vijon me kapitullin mbi agjërimin, që nis qysh me fillimin e tij: kur detyrohet, si agjërohet, kur prishet, çfarë nuk e prish, si veprojnë njerëzit me status të veçantë, gabimet në agjërim, si të shfrytëzohet më mirë, po itikafi çfarë dispozitash ka?!

Mbyllet libri me kapitullin e haxhit, trajtim i mjaftueshëm, i gjerë për çdo detaj të haxhit dhe të umres. Gabimet, shpagimet, kompensimet, radha e veprimeve e çdo gjë që ka të bëjë me to. E mua s'më mbetet vetëm se lutem për shejhun e them: O Allahu im, o Zot i Gjithësisë fale dhe mëshiroje shejhun tonë e ngrija gradët lart, me të lartët e na bashko me të ne xhenetet e tua në Firdeusin e lartë, me Profetët, shehidët, njerëzit e mirë me të sinqertët!

O Allah shpërbleji dhe vëllezërit tanë që janë lodhur për të na e ofruar këtë gurrë dije në vatrat tona, për të cilët besojmë se kanë çuar ne vend përgjegjësinë që patën marrë përsipër, si përkthyesi hoxha dhe vëllai i nderuar Omer Berisha dhe të tjerët, reçensuezi vëllai dhe hoxha i nderuar Bekiri, redaktuesi vëllai dhe hoxha Talha, lektori i nderuar Fatmiri dhe botuesi që me të vërtetë ia ka dhënë hakun sa më mirë kësaj veprë të rëndë dhe tepër me peshë fetare.

Allahun e Madhëruar e lus qe t'i shpërbleje të gjithë kontribuuesit qe kjo vlerë te arrije më në fund në duart e shqiptarëve. Allahume Sali ala Muhamedin ue ala ali Muhamed.

### Sqarim:

*Në një nga forumet e internetit, ku shkruan kush të mundet, dikush rreth librit "Kushtet e fesë" ka thënë se nuk është i përkthyer komplet, sidomos një "fetva rreth xhihadit në Palestinë". Unë e përkujtoj atë person se libri është i përkthyer tërësisht dhe i botuar, përveç një fetvaje rreth rrotullimit të diellit, e që nuk ka lidhje me xhihadin në Palestinë. Mirë ama, si duket, p a r a g j y k i m e t , supozimet e liga dhe mosnjohja e arabishtes janë shkak që dikush të flet në atë mënyrë.*


(Omer B.)

# Me ne... Islami më afër jush!



STUDIO D&K d.o.o.e.l Shkup +389 (0)2 26-26-952 [www.studiodk.net](http://www.studiodk.net) [studiodk@mol.com.mk](mailto:studiodk@mol.com.mk)

## libra te reja nga sh.b. NuN



**1.** **LUTJET E SHËRIMIT**  
Autor: Ahmed ibën Abdul Aziz El-Hudajri



**2.** **MËKATET E MËDHA**  
Autor: Imam Dhehebi



**Hapësirë për  
reklamën tuaj**